



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government


*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/
Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVO CADASTRAL AGENCY



RAPORTI VJETOR I AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS 2019

DHE PLANI I PUNËS 2020



WWW.KCA-KS.ORG
[HTTP://GEOPORTAL.RKS-GOV.NET](http://GEOPORTAL.RKS-GOV.NET)





PËRMBAJTJA

04

FJALA E KRYESHEFIT

06

PËRMBLEDHJE
EKZEKUTIVE

08

AVANCIMI I
KORNIZËS LIGJORE

13

PROJEKTET
KAPITALE

37

KOORDINIMI
INSTITUCIONAL I
ADMINISTRIMIT TË TOKËS

40

KOORDINIMI I
PROJEKTEVE,
BASHKËPUNIMI
NDËRKOMBËTAR

45

MEMORANDUME
BASHKËPUNIMI PËR
PERIUDHËN RAPORTUESE

50

ADMINISTRIM DHE
PËRKRAHJE
TEKONLOGJIKE

53

SHËRBIMET DHE OFRIMI I
TË DHËNAVE

61

BUXHET DHE FINANCA

64

PJESËMARRJE NË
KONFERENCA, PUNËTORI
DHE VIZITA STUDIMORE

67

TRAJNIMET E
OFRUARA

70

MARRËDHËNIE ME
PUBLIK DHE
GJITHËPËRFSHIRJE

72

KALENDARI ME
NGJARJE TË
RËNDËSISHME

76

PLANI I PUNËS PËR VITIN
2020 - REFORMAT DHE
PROJEKTET

SHKURTESA

AKK - AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

IKIH- INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONEVE HAPËSINORE

ZKK - ZYRAT KADASTRALE KOMUNALE

MMPH - MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

RIK - RINDËRTIMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE

UA - UDHËZIMET ADMINISTRATIVE

DRC -QENDRA PËR RIMËKËMBJE NË RAST FATKEQËSISH, ANG. DISASTER RECOVERY CENTER

DTM - MODELI DIGJITAL I TERRENIT, ANG. DIGITAL TERRAIN MODEL

DSM - MODELI DIGJITAL I SIPËRFAQEVE, ANG. DIGITAL SURFACE MODEL

DEM - MODELI DIGJITAL I LARTËSIVE, ANG. DIGITAL ELEVATION MODEL

SOA - ARKITEKTURË E ORIENTUAR NË SHËRBIME, ANG. SERVICES OREINTED ARCHITECTURE

SIKTK - SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË

SIKTK-HK - SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË -HARTA KADASTRALE

SIKTK-T - SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË - TEKSTUALE

ARIS- SISTEMI I INFORMACIONEVE PËR REGJISTRIN E ADRESAVE

SUUSHK - SISTEMI I UNIFIKUAR I UEB SHËRBIMEVE KADASTRALE

KOPOS - SITEMI I POZICIONIMIT SATELITORË NË KOSOVË

AKKVP - AGJENCINË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

GG - PLATFORMA E INTEROPERABILITETIT, ANG. GOVERNEMENT GATEWAY

ZQP - ZONA E QARKULLIMIT PUBLIK

REGIP-PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS DHE INFRASTRUKTURË GJEHAPËSINORE, ANG. REAL ESTATE CADASTRE & GEOSPATIAL INFRASTRUCTURE

PI/GG - PLATFORMA E INTEROPERABILITETIT, GOVERNEMENT GATEWAY

GIS - SISTEMI I INFORMACIONEVE GJEOGRAFIK

ASHI - AGJENCIA PËR SHOQËRI TË INFORMACIONIT

1.FJALA E KRYESHEFIT



Agjencia Kadastrale e Kosovës po e përmbyll një vit të suksesshëm falë implementimit të aktiviteteve të synuara, duke na mbetur “peng” për vitin e ardhshëm vetëm edhe përfundimi i disa iniciativave, kryesisht ligjore të cilat kërkojnë gjithpërfshirje dhe përkrahje më të madhe politike dhe profesionale, me kryesoret mes tyre Ligjin e ri për Kadastër dhe Ligjin për IKIH. Që në fillim dua të përmend faktin se me angazhimin tim si Drejtor Ekzekutiv i AKK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë një

buxhet prej 2,819,540.00 euro ndërsa realizimi i këtij buxheti ka arritur në kuotën prej 98%. Që nga themelimi, kjo është buxheti më i lartë i ndarë ndonjëherë për AKK-në e po ashtu është edhe realizimi i buxhetit më i lartë i arritur ndonjëherë. Reformës së paralajmëruar nga ana ime me rastin e marrjes së pozitës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës i ka prirë nxjerrja e 11 Udhëzimeve Administrative të cilat avancojnë të drejtat pronësore, rregullojnë kadastrën dhe sistemin e adresave dhe fuqizojnë rolin e gjeodetit në shoqëri. Falë gjithpërfshirjes profesionale, politike e shoqërore përfitimet nga këto Udhëzime Administrative ishin të menjëhershme si për qytetarët po ashtu edhe për institucionet e Republikës së Kosovës. Pos kësaj, këtë vit i kemi kompletuar dhe i kemi proceduar për aprovim edhe dy ligje, ligjin e integruar për kadastër dhe ligjin për IKIH, aprovimi i të cilëve do të hapte një kapitull tjetër për administrimin e tokës në përgjithësi dhe për kadastrën dhe të drejtat pronësore në veçanti. Po ashtu gjatë vitit 2019 kemi avancuar edhe në ngritjen e kualitetit të të dhënave dhe në hapjen e tyre. Për të lehtësuar shfrytëzimin e të dhënave, gjatë vitit 2019 kam nënshkruar mbi dhjetë Memorandume Bashkëpunimi me institucione vendore e ndërkombëtare përmes të cilave kemi ndihmuar edhe institucione të ndryshme që të u ofrojnë qytetarëve shërbime kualitative e me kohë. Gjeoportali Shtetëror i cili administrohet nga AKK tani më ka rreth 70 të dhëna gjeohapësinore të qasshme për kërkim e shikim në çdo kohë. Zhvillimet teknologjike në AKK janë duke u avancuar dhe këtë vit kemi shënuar për herë të parë shkëmbimin e të dhënave përmes ueb serviseve. Kjo nënkupton se po ofrojmë të dhëna të sigurta e të sakta, përmes uebit, në kohë reale. Gjatë implementimit të projekteve kemi biseduar me shumë qytetarë, sa në zyre po aq edhe në terren. Gjatë bisedave me ta kemi identifikuar edhe kërkesat e nevojat e tyre si dhe kemi kërkuar nga ta pjesëmarrje aktive dhe përfshirje në projektet e implementuara nga AKK sepse përfitues më të mëdhenj janë vetë qytetarët. Kam trajtuar me interes të veçantë edhe grupet shoqërore potencialisht të marginalizuara, përfshi gratë dhe pakicat etnike që po ballafaqohen me pengesa në shfrytëzim të të drejtave pronësore. Në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore këtë vit kemi vazhduar masën e afirmative për regjistrim të pronës në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë, ndërsa kam intensifikuar edhe takimet me institucionet publike të Republikës së Kosovës me qëllim të implementimit të sistemit zyrtar kadastral të Republikës së Kosovës edhe në Komunitat Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq me qëllim që banorët e atyre komunave të pranojnë shërbime zyrtare konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Pos sukseseve të arritura, gjatë vitit ka pasur edhe sfida të ndryshme që kryesisht kanë të bëjnë me mospërputhjen mes numrit të madh të projekteve dhe mungesës së stafit profesional për implementimin e tyre. Këto sfida do të jenë ekzistuese edhe gjatë vitit 2020, sidomos nëse merret parasysh buxheti i alokuar dhe numri i madh i projekteve që pritet të realizohen. Kjo sfida do të ishte më lehtë e tejkalueshme në rast se kalon ligji i ri për kadastër i cili do të vertikalizonte administrimin kadastral, respektivisht do

të fuste Zyrat Kadastrale Komunale nën ombrellën e AKK-së dhe do të mundësonte vetëfinancimin e AKK-së, rrjedhimisht angazhimi i stafit profesional, ngritja e numrit të produkteve dhe shërbimeve paralel me ngritjen e kualitetit të tyre do të ishte lehtë e arritshme. Sidoqoftë, edhe në këtë fazë tranzicioni e reformash, jemi të bindur se me përkrahjen financiare të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të donatorëve të jashtëm, me bashkëpunim me palë të ndryshme të interesit, AKK do ia del të arrijë objektivat e parapara për vitin 2020, të cilat janë më komplekse dhe më të avancuara. Për fund, u falënderoj për bashkëpunimin me shpresë se i njëjti do të vazhdojë edhe në të ardhmen, dhe në vijim ua prezantoj raportin mbi aktivitetet tona të implementuara gjatë vitit 2019.

Avni Ahmeti

Drejtor Ekzekutiv

Agjencia Kadastrale e Kosovës


Realizimi i planit legjislativ

100%

Realizimi i buxhetit

98%

Buxheti i AKK-së ndër vite



2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE


2.1 MANDATI DHE PËRGJEGJËSITË

Agjencia Kadastrale e Kosovës (në vijim të tekstit AKK) është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore (në vijim të tekstit, IKIH) dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave. Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve dhe kornizave të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, është përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale (tutje në tekst ZKK) për operim në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës (më tutje në tekst SIKTK) dhe për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete për kryerjen e matjeve kadastrale. Duke u bazuar në Ligjin për Kadastër AKK ka deleguar tek ZKK detyrat për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave në SIKTK. ZKK-të ofrojnë shërbime për persona fizik dhe juridik si dhe për institucionet publike në 35 nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, ndërsa në tre Komuna, respektivisht në Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan edhe krahas përpjekjeve të AKK-së administrimi i kadastrës nuk po bëhet konform legjislacionit të Republikës së Kosovës. Si rezultat i kësaj dhe me qëllimin e ofrimit të shërbimeve kadastrale për qytetarët e tri komunave veriore, AKK duke u bazuar në Ligjin për kadastër ka vendosur që të pranojë kërkesat e qytetarëve të tri komunave veriore, dhe për të njëjtat të lëshohen dokumente kadastrale dhe pronësore, si dhe të bëhet mirëmbajtja e Regjistrit të të Drejtave mbi Pronat të Paluajtshme. Të drejtat, përgjegjësitë dhe në përgjithësi mandati i AKK-së është i rregulluar me Ligjin për Kadastër dhe me akte të tjera nënligjore, të gjitha të qasshme përmes linkut <http://www.kca-ks.org/legjislacioni>.

2.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE

Gjatë vitit 2017 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka aprovuar rregulloren me Nr. 05/2017 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, ku është e përfshirë edhe Agjencia Kadastrale e Kosovës në kapitullin 5, neni 69. Struktura organizative e AKK-së është e paraparë me tri drejtorate dhe nëntë sektorë. Në bazë të kësaj është bërë shkëputje e dy drejtorive dhe 5 sektorëve nga AKK. Në bazë të nenit 88, me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, ishte paraparë shfuqizimi i Rregullores (QRK) Nr. 20/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. AKK ka kërkuar të pezullohet dhe të mos zbatohet rregullorja në fjalë, sepse me shkëputjen e dy drejtorateve dhe pesë sektorëve AKK e humb rëndësinë nacionale, si dhe është e padobishme në arritjen e objektivave të saja kah administrimi i suksesshëm i tokës. Pas miratimit të Rregullores (QRK) nr. 05/2017, me datë 23/05/2017, Ministria e MMPH anulon rregulloren Nr. 05/2017 me qëllim të rivlerësimit dhe rishqyrtimit të procesit të riorganizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në MMPH dhe rrjedhimisht Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron në bazë të Rregullores me Nr. 20/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKK, e aprovuar me datë 08.12.2014. Bazuar në këtë rregullore AKK në strukturën e saj organizative ka gjithsej 5 Drejtorate, respektivisht Drejtorati i Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme, Drejtorati për Gjeoinformacion, Drejtorati për menaxhimin e Sistemit të Teknologjisë së Informacionit Kadastral, Drejtorati Ligjor dhe Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme. Po ashtu në kuadër të AKK-së vepron

edhe Njësia për Implementimin e Projekteve. Numri i të punësuarve të aprovuar nga Buxheti për vitin 2019 është 56 punëtorë, ndërsa janë edhe 11 punëtor të angazhuar me projekte.



Organogrammi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës

3.AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE

Në kuadër të reformave të parapara në kadastrë dhe për tu ballafaquar me kërkesat në rritje të qytetarëve dhe institucioneve për produkte dhe shërbime sa më kualitative, sa më të sigurta dhe në kohë sa më të shpejtë AKK ka ndërmarrë iniciativën për azhurnimin e kornizës ligjore respektivisht nxjerrjen e gjashtë Udhëzimeve Administrative nga fusha e kadastrës dhe regjistrimit të pronës dhe pesë Udhëzimeve Administrative nga fusha e sistemit të unifikuar të adresave si vijon:

3.1 UDHËZIMET ADMINISTRATIVE NGA FUSHA E KADASTRËS DHE REGJISTRIMIT TË PRONËS:

1. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR TARIFAT E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE TË AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS,
2. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR NDARJEN E ZONAVE KADASTRALE,
3. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR MATJET KADASTRALE PËR REGJISTRIM NË KADASTËR,
4. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR NDARJEN E NDËRTESES DHE TË PJESËS SË NDËRTESES,
5. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR NDARJEN DHE REGJISTRIMIN E PARCELËS,
6. UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH NR.13/2019 PËR LICENCIMIN E KOMPANIVE GJEODETE DHE TË GJEODETËVE.



Foto: Moment nga nënshkrimi i Udhëzimeve Administrative për kadastrë

Përmes këtyre Udhëzimeve Administrative është arritur thjeshtim i procedurave për krijimin e bashkëpronësisë dhe krijimin e bazës ligjore për ndarjen e bashkëpronësisë në rastet kur qytetarët janë obliguar të hyjnë në bashkëpronësi. Është eliminuar pengesa për ndarjen dhe bashkimin e parcelave në zonat urbane. Një gjë e tillë më parë është realizuar vetëm përmes marrjes së pëlqimit nga Urbanizmi, gjë që ka komplikuar procedurat dhe u ka shkaktuar probleme të mëdha qytetarëve në ndarjen e pronësisë. U është ndaluar puna në terren për bashkim dhe për ndarje të parcelave zyrtarëve të Zyrtarëve Kadastrale Komunale, përveç rasteve të cilat janë në interes të komunës, e gjithë kjo me qëllim që të njëjtit të jenë më efikas në realizimin e kërkesave të palëve në zyrë. Aktivitetet e sipër përmendura do të mbulohen vetëm nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara gjeodete. Janë standardizuar çmimet për produkte dhe shërbime të cilat i ofrojnë Zyrtarët Kadastrale Komunale dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës. Po ashtu me këto udhëzime janë harmonizuar edhe çmimet për shërbimet e ofruara nga gjeodetët e licencuar dhe kompanitë e licencuara gjeodete. Kriteret për licencim të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete janë ngritur, paralel me to është ngritur edhe kualiteti i shërbimeve ndaj qytetarëve. Secili gjeodet dhe secila kompani gjeodete ka të deleguar përgjegjësi shtetërore në fushën e kadastrës dhe gjeodezisë. Është krijuar baza ligjore për ofrimin e produkteve kadastrale online. Për qëllime studimore dhe shkencore, mundësohet ofrimi i të dhënave pa pagesë deri në 100 euro për një vit akademik.

3.2 UDHËZIMET ADMINISTRATIVE NGA FUSHA E SISTEMIT TË UNIFIKUAR TË ADRESAVE:

1. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR RENDITJEN E ELEMENTEVE TË ADRESAVE DHE ÇAKTIMIN E FORMATIT TË SHKRONJAVE, NUMRAVE DHE TË TABELAVE TË ADRESAVE,
2. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR ÇAKTIMIN E EMËRTIMIT DHE NUMËRTIMIT TË ADRESAVE PËR ZONA TË QARKULLIMIT PUBLIK, NDËRTESA, SHTËPI, OBJEKTE DHE PARCELA KADASTRALE TË LIRA,
3. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E LISTËS ALFABETIKE PËR EMËRTIME, LISTËS REZERVË DHE VENDOSJEN E TYRE NË REGJISTRIN KOMUNAL TË ADRESAVE,
4. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR PROCEDURAT E KRIJIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT KOMUNAL TË ADRESAVE DHE REGJISTRIT SHTETËROR TË ADRESAVE,
5. UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR VENDOSJEN FIZIKE TË TABELAVE TË ADRESAVE NË ZONA TË QARKULLIMIT PUBLIK, NDËRTESA, SHTËPI, OBJEKTE DHE PARCELA KADASTRALE TË LIRA.






Foto: Moment nga nënshkrimi i Udhëzimeve Administrative për adresa

Udhëzimet administrative të adresave rregullojnë Sistemin e Adresave në dy nivele, nivelin qendror (AKK) dhe atë lokal (Drejtoritë e urbanizmit). Me këto udhëzime rregullohet çështja e riemërtimit të Zonave të Qarkullimit Publik (më tutje në tekst ZQP). Duke pasur parasysh ndryshimin e shpeshtë të emrave të ZQP-ve dhe për arsye të qëndrueshmërisë së sistemit është ndaluar riemërtimi i ZQP-ve për një periudhë kohore prej 10 vjet, përpos në disa raste të veçanta. Gjithashtu obligohen institucionet që të shfrytëzojnë adresat zyrtare, rregullohen çështjet e dëshmisë për adresën zyrtare nga qytetarët tek institucionet e ndryshme, çështja e barazisë gjinore me rastin e emërtimit të ZQP, çështja e formatit unik të tabelave të emrave të ZQP-ve dhe numrave të adresave, kufizimi i karaktereve të emrave të ZQP-ve si dhe kriteret për formimin e rrugëve të reja, kriteret e numërimit të objekteve duke përfshirë edhe adresimin e brendshëm të njësive banesore, procedurat e mirëmbajtjes së Regjistrit të Adresave duke obliguar komunat që të bëjnë përditësimin e të dhënave të adresave së paku një herë në vit përpos përditësimit të vazhdueshëm të të dhënave me rastin e lëshimit të lejes ndërtimore. Po ashtu rregullohen çështjet bazë për vendosjen fizike të tabelave të emrave të ZQP-ve, konkretisht në vendosjen e tabelave njëanësore që vendosen në mure dhe numrave të adresave, detyrat dhe përgjegjësit e drejtorive komunale përgjegjëse që kanë të bëjnë me llogaritjen e numrit të tabelave të emrave që duhet të vendosen në një ZQP si dhe tabelave për numrat e hyrjeve, formës dhe dimensioneve të tyre, mënyrës së vendosjes, instalimit në terren, përcaktimin e llojit të materialit, mënyrës së organizimit të punëve në terren, përcakton detyrat edhe përgjegjësit e palëve të kyçur në këtë proces si AKK dhe drejtorive komunale përgjegjëse në aspektin e planifikimit, kontrollit të kualitetit dhe aprovimit të punëve gjatë vendosjes fizike të tabelave të adresave. Gjithashtu janë përcaktuar edhe rregullat për inspektimin dhe mirëmbajtjen e tabelave të adresave në vazhdimësi nga drejtoria komunale përgjegjëse.

3.3 PLANI I BIZNESIT

Qëllimi i Planit të Biznesit është të zhvillohet dhe të prezantohet një Plan i azhurnuar i qartë për periudhën 5 vjeçare, 2020-2024 për qëndrueshmërinë afatgjatë të AKK-së me përfshirjen aktive të menaxhimit të brendshëm dhe palëve të jashtme të interesit për të siguruar që objektivat janë mbështetur dhe arritur plotësisht. Plan i Biznesit do të përfshijë një përmbledhje të shkurtër të sfidave dhe pengesave aktuale të ZKK-ve dhe institucioneve të tjera të administrimit të tokës, dhe mënyrat se si ato do të adresohen në politikat e AKK-së. Plan i Biznesit do të sigurojë një plan të qartë zbatimi të reformave institucionale dhe organizative për sistemin kadastral dhe regjistrimin e pronës së paluajtshme në Republikën e Kosovës (AKK dhe ZKK). Gjithashtu do të identifikojë produktet dhe shërbimet e reja të vlerës së shtuar nga të dhënat e tregut të pronës, të cilat do të bëjnë ndikimin më të madh në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, ku do të përcaktohen prioritetet në përputhje me rrethanat aktuale. Gjithashtu ky dokument do të adresojë nevojat për ndryshime në ligje dhe rregullore bazuar në Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Pronës, dhe do të krahasojë produktet dhe shërbimet e ofruara nga AKK, me produktet dhe shërbimet e agjencive më të përparuara kadastrale dhe hartografike në Evropë. Plan i Biznesit do të përcaktojë qartë funksionet dhe përgjegjësitë e AKK-së dhe Zyrave Kadastrale Komunale, përfshirë shpërndarjen e funksioneve specifike midis tyre. Për më tepër, do të shtjellojë zhvillimin institucional dhe forcimin e burimeve njerëzore brenda AKK-së dhe ZKK-ve.

3.4 DORACAKË PROFESIONAL



Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është rishikimi dhe azhurnimi i udhëzimeve dhe manualeve të punës ekzistuese të cilat trajtojnë proceset e Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale, Kadastrit të Ndërtesave, aktiviteteve të matjeve gjeodezike dhe kadastrale, regjistrimit të pronave etj. Deri tani janë zhvilluar dy aktivitete të parapara me projekt, aprovimi i raportit fillestar dhe planit dinamik si dhe mbajtja e punëtorisë së parë. Bazuar në kërkesat dhe specifikat teknike si dhe raportin fillestar për këtë projekt, OE në punëtorinë e mbajtur në AKK ka prezantuar aktivitetin e analizave dhe studimit të hollësishëm të dokumentacionit i cili ishte subjekt i kësaj kontrate, rekomandimet bazike të cilat do të shërbejnë në hartimin e draft udhëzuesve, rekomandimet të cilat derivojnë si kërkesë për përmirësimin dhe azhurnimin e udhëzuesve ekzistues si dhe rekomandimet të cilat kanë të bëjnë me udhëzuesit e ri të punës të cilat derivojnë si kërkesa nga Udhëzimet

Administrative të aprovuara në Nëntor të vitit 2019. Në punëtori kanë marrë pjesë 19 ekspertë nga grupet kryesore të interesit si përfaqësueses të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Zyrave Kadastrale Komunale, Shoqatës së Gjeodetëve si dhe gjeodetë të licencuar. Në punëtori është konkluduar që të gjithë udhëzuesit e punës të jenë pjesë e një dokumenti të vetëm i cili do të jetë si bazë udhëzuese për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me matje, krijim të njësive kadastrale, standardizim të të gjitha aspekteve teknike dhe procedurale për krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale etj. Bazuar në rekomandimet e prezantuara dhe diskutimet e bëra gjatë punëtorisë, gjithashtu është konkluduar që OE të vazhdojë me hartimin e udhëzuesve të diskutuar në mënyrë të detajuar nga aspekti teknik dhe ato të dorëzohen në AKK për shqyrtim në Janar të vitit 2020, në mënyrë që komentet dhe sugjerimet e bëra nga AKK dhe grupet e interesit të inkorporohen nga OE në draft versionet finale të cilat do të prezantohen më gjerësisht në punëtorinë e dytë (2-3 ditore). Diskutimet, sugjerimet dhe rekomandimet e dala nga punëtorinë e dytë do të inkorporohen në versionet përfundimtare të dokumenteve-udhëzuesve në mënyrë që AKK të bëjë aprovimin e tyre dhe sa më parë të fillojë përdorimi i tyre e në veçanti aktivitetet të cilat do të trajtohen në udhëzuesit e rinj të punës që derivojnë si kërkesa nga Udhëzimet Administrative.

3.5 KORNIZA PUNE

Në kuadër të plotësim-ndryshimeve të Udhëzimeve Administrative si dhe pas analizave, diskutimeve dhe kontrollit të kualitetit të të dhënave nga terreni, ekspertët kadastral dhe ligjor të Agjencisë Kadastrale të Kosovës kanë ardhur në përfundim se duhet bërë avancimi edhe i kornizave të punës të AKK-së, me qëllim të plotësimin të nevojave teknike, ligjore e profesionale për regjistrimin e pronës në kadashtë. Rrjedhimisht, me qëllim të avancimit të kryerjes së punëve kadastrale nga Zyrat Kadastrale Komunale, nga gjeodetët e licencuar dhe kompanitë e licencuara gjeodete, ekspertët e AKK-së kanë përpiluar Kornizën e re për punë Nr. AKK 2019/01 e cila rregullon standardizimin e matjeve kadastrale për krijimin e pronave të paluajtshme. Ndërsa e njëjta Kornizë pune e nënshkruan nga kreu i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti me datë 29 Mars, 2019 ka hyrë në fuqi menjëherë, duke zëvendësuar kështu Kornizën e punës Nr. AKK 2013/02 për standardizimin e matjeve dhe rilevimeve kadastrale.

4. PROJEKTET KAPITALE

4.1 RINDËRTIMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE NË 15 ZONA KADASTRALE

Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur në terren, të cilat nuk janë të paraqitura dhe mirëmbajtura me elaborat kadastral në kadastër, paraqesin mos-harmonizim të gjendjes faktike në terren me atë të regjistruar në kadastër. Ky mos-harmonizim përveç arsyes së mosmirëmbajtjes së rregullt të kadastrit, mos paraqitjes së kërkesave për ndryshim nga qytetarët vjen edhe si pasojë e vjedhjes së dokumentacionit nga Serbia gjatë luftës në Kosovë. Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale (më tutje në tekst, RIK) nënkupton krijimin e njësive kadastrale dhe rindërtimin e të drejtave pronësore për njësitë kadastrale dhe regjistrimin e tyre në RDPP-SIKTK. Projekti realizohet sipas Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër, UA nr.02/2012 për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, UA nr.03/2012 për punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi pronën e Paluajtshme, UA nr. 04/2012 për Fushatën e Sensibilizimit për publikun gjatë RIK, si dhe akteve tjera në fuqi. Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me Zyrat Kadastrale Komunale ka bërë përzgjedhjen e zonave kadastrale të cilat do të rindërtohen. Qëllimi primar i projektit është harmonizimi i gjendjes faktike të terrenit me atë në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë dhe ngritja e vetëdijes kolektive për rëndësinë që ka regjistrimi i pronës në emër të pronarit faktik. Ky qëllim tentohet të arrihet përmes objektivave si: matja e gjendjes faktike në terren dhe zyrtarizimi i saj, bartjes së pronësisë përmes dhuratëdhënies apo shitblerjes, procesin e ndarjes, bashkimit apo identifikimit të parcelave në terren etj. Për të arritur qëllimin dhe realizuar objektivat e parapara, projekti është ndarë në disa faza të realizimit të tij. Projekti i Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale në 15 Zona Kadastrale ka filluar në vitin 2018, gjatë të cilit është realizuar faza e parë që ka të bëjë me informimin publik të qytetarëve për rëndësinë që ka Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale. Ndërsa fazat tjera si fushata e matjeve, shikimi publik dhe futja e të dhënave të rindërtuara në sistem është realizuar gjatë vitit 2019. Para secilës nga fazat nëpër të cilat kalon projekti është realizuar fushatë e informimit për qytetarët.



Foto: Moment nga tubimet informuese me qytetarë

FUSHATA E MATJEVE

Fushata e matjeve në terren ka filluar qysh në muajin Shkurt të vitit 2019 dhe ka vazhduar deri në fazën e hapjes së shikimit publik. Gjithsesi në mënyrë që të ofrohet shërbim për qytetarët, matje në terren janë realizuar edhe gjatë fazës së shikimit publik me kërkesa të veçanta të banorëve. Para fillimit të fushatës së matjeve, banorët janë ftuar që të bëjnë shenjëzimin e pikave kufitare të parcelave të tyre. Matja e kufijve të parcelave është realizuar vetëm në gjendje faktike dhe në prani të pronarëve apo shfrytëzuesve të parcelave. Gjatë fushatës së matjeve deri në hapje të shikimit publik, janë matur gjithsejtë 46.008 pika të parcelave, nga të cilat janë krijuar 7.984 parcela nga gjendja faktike e fituar prej këtyre matjeve. Në vijim janë paraqitur numri i pikave të matura dhe parcelave të krijuara nga matjet për secilën zonë kadastrale në kuadër të RIK:

Nr.	Komuna	Zona Kadastrale	Pika të matura	Parcela të krijuara
1	GLLOGOC	Arllat	8319	1296
2		Shtuticë	2355	374
3	KAMENICË	Berivojcë	1920	348
4		Kopernicë	2825	361
5		Hodonoc	1624	719
6		Rogaqicë	4085	572
7		Muqivercë	3062	463
8	VITI	Zhiti	1624	238
9		Pozharan	4192	820
10		Sadovinë e Jerlive	2057	479
11		Sllatinë	2758	739
12	SKËNDERAJ	Baks	2482	444
13		Dashevc	754	129
14		Çirez	4956	603
15		Kosterc	2995	399

Gjatë realizimit të fushatës së matjeve, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka realizuar kontrollin e kualitetit duke bërë matje kontrolluese në secilën zonë kadastrale. Matjet kontrolluese janë fokusuar në kufi të shenjëzuar të parcelave. Gjatë matjeve në terren për kontroll të kualitetit ka qenë prezent edhe anëtari i Komisionit për RIK si përfaqësues i banorëve të Zonës Kadastrale. Gjithashtu matje kontrolluese kanë realizuar edhe zyrtarët e ZKK-ve. Përveç matjeve kontrolluese, zyrtarët e AKK-së janë takuar edhe me banorë të zonave kadastrale me të cilët është biseduar përgjithësisht për projektin me theks të veçantë për fushatën e matjeve.

AKK PAJISËT ME TOTAL STACION TË RI

Agjencia Kadastrale e Kosovës me qëllim të ngritjes së kualitetit të kontrollit të matjeve kadastrale, ka blerë instrument i ri gjeodezik "Total Station" robotik nga prodhuesi TOPCON i modelit të ri GT 1002. Ky instrument do të ndikoj në ngritjen e cilësisë së matjeve në terren për nevoja të projekteve të cilat realizohen në AKK, për kontrollin e kualitetit të të dhënave nga projektet si Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale, krijimi i modelit digjital të terrenit (DTM), etj.



Foto: Moment nga fushata e matjeve

SHIKIMI PUBLIK

Pas përfundimit të fushatës së matjeve në terren, operatori ekonomik ka dorëzuar të dhënat në AKK së bashku me raportin e brendshëm të kontrollit të kualitetit. Të gjitha këto të dhëna janë kontrolluar edhe nga ekspertët e AKK-së, ku raportet me të gjitha vërejtjet dhe komentet u janë dorëzuar OE për korrigjim. Pasi që janë korrigjuar të gjitha vërejtjet e dorëzuar nga ekspertët e AKK-së, Komisioni për RIK në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr: 03/2012 për punën e Komisionit për RIK, ka marr vendim që të dhënat për zonat kadastrale të dalin në shikim publik.

Në vijim në formë tabelare janë paraqitur datat e hapjes dhe mbylljes së shikimit publik.

Nr.	Komuna	Zona Kadastrale	Shikimi publik	
			Fillimi	Përfundimi
1	GLLOGOC	Arllat	24.06.2019	22.08.2019
2		Shtuticë		
3	KAMENICË	Berivojcë	29.07.2019	26.09.2019
4		Kopernicë		
5		Hodonoc		
6		Rogaqicë		
7		Muqivercë		
8	VITI	Zhiti	29.07.2019	26.09.2019
9		Pozharan		
10		Sadovinë e Jerlive		
11		Sllatinë		
12	SKËNDERAJ	Baks	24.06.2019	22.08.2019
13		Dashevc		
14		Çirez		
15		Kosterc		

Tre (3) ditë para fillimit të shikimit publik janë vendosur posterë dhe janë shpërndarë fletëpalosje në vendet publike në territorin e Zonës Kadastrale subjekt i rindërtimit dhe është bërë informimi në radio lokale. Në objektet e zyrave kadastrale komunale përkatëse gjithashtu janë vendosur posterë të hapjes së shikimit publik krahas atyre të vendosur më herët për fillimin e projektit RIK. Në posterë dhe fletëpalosje është shënuar data e fillimit dhe e përfundimit të shikimit publik, si dhe vendi ku paraqiten të dhënat për shikim publik. Përmes të njëjtave banorët janë informuar edhe mbi të drejtën për të parashtruar kërkesa për sqarime. Në tabelën në vijim janë paraqitur lokacionet e zyrave në të cilat janë paraqitur të dhënat nga shikimi publik dhe vërejtjet eventuale nga të dhënat e rindërtuara.

Nr.	Komuna	Zona Kadastrale	Adresa e mbajtjes së shikimi publik
1	GLLOGOC	Arllat	Rruga "Sami Gashi"
2		Shtuticë	Rruga "Martirët e Shtuticës"
3	KAMENICË	Berivojcë	Rruga "Adem Jashari"
4		Kopernicë	Rruga "Rahim Beqiri"
5		Hodonoc	Rruga "Brigada 128 Sali Saramati"
6		Rogaqicë	Rruga e Dijes
7		Muqivercë	Rruga "Pranvera 81"
8	VITI	Zhiti	Rruga "Nezir Ukë Zhitia"-
9		Pozharan	Rruga "Sylejman Aga"
10		Sadovinë e Jerlive	Rruga "Dushku"
11		Sllatinë	Rruga "Adem Imeri"

12	SKËNDERAJ	Baks	Rruga "Rexhep Rexhepi"-Çirez
13		Dashevc	Rruga "Martirët e Dashecit
14		Çirez	Rruga "Rexhep Rexhepi"-Çirez
15		Kosterc	Rruga "Ajet Beqiri"-Runik

Gjatë fazës së shikimit publik, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka bërë kontrollin e kualitetit duke monitoruar zyrat ku është mbajtur shikimi publik dhe duke biseduar me qytetarët në terren. Monitorimi i një zone kadastrale është realizuar në bazë javore dhe të gjeturat janë pasqyruar në raport, përfshi numrin e vizitorëve në zyrë, emrat, mbiemrat dhe numrat e telefonave të disa prej banorëve të cilët i kanë takuar në terren. Bazuar në këto monitorime, Komisioni për RIK, ka vlerësuar që duhet të bëhet informim shtesë dhe ka marr vendim që të mbahet edhe një takim informues me banorët e 15 zonave kadastrale në proces të RIK. Takimet shtesë informuese janë mbajtur me datat e paraqitura në tabelën në vijim:

Nr.	Komuna	Zona Kadastrale	Takimet shtesë informuese me banorë
1	GLLOGOC	Arllat	31.07.2019
2		Shtuticë	31.07.2019
3	KAMENICË	Berivojcë	15.08.2019
4		Kopernicë	09.08.2019
5		Hodonoc	15.08.2019
6		Rogaqicë	16.08.2019
7		Muqivercë	09.08.2019
8	VITI	Zhiti	21.08.2019
9		Pozharan	21.08.2019
10		Sadovinë e Jerlive	20.08.2019
11		Sllatinë	20.08.2019
12	SKËNDERAJ	Baks	30.07.2019
13		Dashevc	30.07.2019
14		Çirez	30.07.2019
15		Kosterc	01.08.2019

Shpërndarja e fletushkave derë më derë nga OE, monitorimet nga AKK dhe takimet informuese shtesë me banorë ndikuan në ngritjen e interesimit dhe përfitimit të banorëve nga projekti RIK. Deri në përfundim të shikimit publik numri i banorëve që kanë vizituar zyrat ka qenë 1286 banorë.

Në tabelën e mëposhtme ky numër është specifikuar sipas zonave kadastrale.

Nr.	Komuna	Zona Kadastrale	Numri i vizitorëve në zyrë
1	GLLOGOC	Arllat	122
2		Shtuticë	30
3	KAMENICË	Berivojcë	103
4		Kopernicë	82
5		Hodonoc	34
6		Rogaqicë	198
7		Muqivercë	85
8	VITI	Zhiti	40
9		Pozharan	150
10		Sadovinë e Jerlive	44
11		Sllatinë	237
12	SKENDERAJ	Baks	23
13		Dashevc	29
14		Çirez	70
15		Kostërc	39
Numri i përgjithshëm			1286

Gjatë fazës së matjeve dhe shikimit publik, në prezencë të palëve, janë hartuar dhe nënshkruar procesverbalet dhe dokumentet tjera për zyrtarizimin e të gjitha aktiviteteve të përfshira në RIK të paraqitura në tabelën me statistika të përgjithshme.



Foto: Prezantim i gjendjes faktike të pronave në kuadër të RIK

APROVIMI FINAL I TË DHËNAVE TË RINDËRTUARA DHE ZYRTARIZIMI I TYRE NË SIKTK

Futjes së të dhënave në sistem i ka paraprirë një filtër tjetër në kontroll të kualitetit, ku ekspertët nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, kanë kontrolluar në aspektin teknik dhe juridik të gjitha procesverbalet e hartuara. Të gjitha komentet në procesverbale janë dërguar për korrigjim tek OE dhe pas korrigjimit të gabimeve, komisioni për RIK ka nxjerrë vendimin final për aprovim të procesverbalit. Zyrtarizimi i të dhënave në SIKTK i ka paraprirë trajnimi dhe testimi i ekspertëve të Operatorit Ekonomik nga AKK, për përdorimin e modulit për futjen e të dhënave në sistem. OE ka skanuar gjithë dokumentacionin relevant për të gjitha lëndët, ku më pas të njëjtat i ka bashkangjitur në modul për RIK në procese të veçanta. Në këtë modul ekspertët e AKK-së kanë realizuar kontroll shtesë të kualitetit, duke aprovuar proceset.

APROVIMI I PROJEKTIT DHE DORËZIMI I TË DHËNAVE FINALE

Pas përfundimit me sukses të të gjitha fazave të projektit të RIK, duke filluar që nga Informimi publik, matjet, kontrolli i kualitetit, shikimi publik, zyrtarizimi i të dhënave në sistem, Komisioni për RIK ka bërë aprovimin e Projektit, në bazë të kompetencave të përcaktuara me Neni 7, paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme. Në fund vlen të ceket se të gjitha kopjet fizike të dokumentacionit dorëzohen tek Zyrtar Kadastrale Komunale përkatëse ku është zhvilluar projekti.

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KOSOVSKA KATASTRARSKA AGENCIJA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Bazuar në nenin 29, paragrafi 5 i Ligjit nr. 04/-L-013 për Kadastër, Neni 7, paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, merre këtë:

Nr. 12/19
Datë: 13. 12. 2019

VENDIM

Aprovohet Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale në Zonën kadastrale Sadovin e Jerlive, Komuna Viti.

ARSYETIM

Pas realizimit të fazave të projektit nga Operatori Ekonomik "Lorenzo & Co Sh.P.K dhe Urban Metropol Sh.P.K", sipas specifikave teknike (ST) dhe kushteve të kontratës me nr. Protokollin 01/2626/18, të datës 16.11.2018. Kontrollime të bëra nga ana e kontrollit të kualitetit nga ekspertët e AKK dhe raporti përfundimtar nga menaxheri i projektit, si dhe gjatë fazës së Shikimit Publik nuk ka pasur ankesa nga qytetarët. Komisioni ka bërë shqyrtimin e 61 lëndëve, ku janë rindërtuar 142 parcela në këtë ZK.

Aprovimin e Projektit e bënë Komisioni për rindërtimin e informacioneve kadastrale në bazë të kompetencave të përcaktuara me Neni 7, paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

KOMISIONI PËR RIK

1. Bashkim Shaqiri – Kryesues (AKK)	2. Hasim Pacolli – Anëtar (AKK)
Nënshkrimi	Nënshkrimi
3. Sabrije Rama – Anëtar (MMPH)	4. Feat Shaqiri – Anëtar (ZKK)
Nënshkrimi	Nënshkrimi
5. Basri Fetahaj – Anëtar (ZK)	
Nënshkrimi	

Adresa: Agjencia Kadastrale e Kosovës, Rr. "Arbënor e Astrit Dehari", nr. 25,
10 000 Prishtinë. Tel: + 383(0) 38 512-353

Foto: Shembull i vendimit për aprovimin e RIK

SFIDAT QË KANË PËRCJELL PROJEKTIN

Përfitimet nga projekti RIK kanë qenë të mëdha që nga informimi dhe sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të tyre, pastaj trashëgimia dhe të drejtat e barabarta në pronë për të dy gjinitë e deri tek ndikimi i RIK në vlerën e pronave në tregun e paluajtshmërive, ku me regjistrim të pronës në emër të pronarit faktik është rritur siguria e pronës, pastaj vlera e saj si dhe mundësia më e lehtë për shitblerje, hipotekim apo transaksion tjetër. Gjithsesi si projekt ka pasur edhe sfidat, të cilat janë paraqitur në vazhdim:

1. Një prej sfidave kryesore ka qenë pamundësia e banorëve për realizimin e procesit të trashëgimisë. Arsytet e mosrealizimit kanë qenë më të ndryshmet duke filluar nga pamundësia e tubimit të gjithë trungut të trashëgimisë për paraqitje tek noteri apo në gjykatë e deri tek mungesa financiare për realizimin e këtij akti.
2. Sfidat e dytë që vlen për tu theksuar, janë transaksionet e realizuara vite më parë përmes "marrëveshjeve me shtrëngim duarsh" pa kontrata valide, mes palëve kryesisht mes pronarëve të etnive të ndryshme. Shfrytëzuesit aktual të pronave apo "blerësit" nuk kanë pasur mundësi që të sigurojnë palën tjetër që të paraqiten para komisionit për RIK dhe të nënshkruajnë procesverbalet për kalim pronësie.
3. Sfidë tjetër ka qenë edhe shpërngulja e banorëve nga fshati në qytet apo edhe jashtë vendit.


Për tejkalim të këtyre sfidave në projektet e ardhshme të Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale dhe përfitim shumë më të madh për qytetarët, bizneset dhe tërë shtetin e Kosovës, duhet që Komisioni për RIK të ketë kompetenca shtesë në mënyrë që të trajtojë dhe të vendosë edhe për ndërrimet e pronësisë të realizuara më herët pa akte juridike. Shtimi i kompetencave të komisionit të RIK është paraparë edhe me projektligjin e ri për kadastrë.

4.2 MATJET RELATIVE GRAVIMETRIKE

AKK si institucion qendror për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave gjeodezike ka ndërmarrë edhe aktivitetet e zhvillimit të rrjetit gravimetrik për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Meqenëse niveli i parë (Pikat Absolute Gravimetrike) dhe niveli i dytë (Rrjeti Gravimetrik i Rendit të Parë) si dhe një pjesë e nivelit të tretë (Zona Pilot e Rrjetit Gravimetrik e Rendit të Dytë) kanë përfunduar, është synuar përfundimi i matjeve të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të dytë me qëllim të përcaktimit të Gjeoidit të saktësisë dhe besueshmërisë së lartë për territorin e Kosovës. Përcaktimi i një gjeoidi gravimetrik të saktësisë së lartë për Kosovën është një mjet thelbësor për transformimin e lartësive elipsoidale të marra nga matjet GNSS në lartësitë ortometrike. Me qëllim të finalizimit të specifikave teknike për këtë projekt si dhe për grumbullimin të sa më shumë informacioneve profesionale në lëmin e gravimetrisë, shkëmbimit të informacioneve mes ekspertëve, prezantimin e sfidave eventuale dhe identifikimin e mjeteve për tejkalimin e këtyre fushave, ekspertë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës kanë qëndruar në Oslo, me ftesë të përfaqësuesve të Autoritetit Norvegjez për Kadastrë "Statens Kartverk". Duke u bazuar në takimet dhe konsultimet e bëra me ekspertët Norvegjezë,

është konkluduar që dendësia e pikave garvimetrike të rendit të dytë të jetë 2x2 km, në mënyrë që të sigurohet që saktësia dhe besueshmëria e gjeoidit të jetë shumë e lartë. Andaj, duke u bazuar edhe në pikat e rrjetit gravimetrik të matura në vitin 2018, është planifikuar që në kuadër të këtij projekti të realizohen matjet gravimetrike në 2442 pika:

- 2289 pika të reja
- 153 pika të reja, dendësim dhe plotësim i rrjetit nga matjet e realizuara në vitin 2018,




Pas përfundimit të specifikave teknike, të cilat specifika janë trajtuar edhe me ekspertët norvegjez gjatë vizitës në Oslo dhe pas dhe përfundimit të procedurave të prokurimit AKK në maj të vitit 2019, ka nënshkruar kontrata dy vjeçare për realizimin e matjeve relative gravimetrike për tërë territorin e Kosovës. Pikat e rendit të dytë që janë matur, janë të projektuara dhe gjatë fushatës së matjes është tentuar që matjet të kryhen brenda maksimum 300 metra nga pika e projektuar (tampon zona rreth pikës është 300 metra). Kriteri më i rëndësishëm për pika të rendit të dytë është mbulimi i hapësirës me të dhëna gravimetrike, andaj duhet synuar të realizohen matjet gravimetrike në zonat e parashikuara.


METODOLOGJIA E MATJEVE GRAVIMETRIKE RELATIVE DHE PËRCAKTIMI I KOORDINATAVE

Matjet e rrjetit gravimetrik të rendit të dytë janë realizuar nga katër ekipe të pavarura. Çdo "ditë gravimetrike" ka filluar me matjet në pikën e rendit të parë ose pikën e ekscentrike dhe kanë vazhduar me matjet në pikat e rendit të dytë. Pavarësisht se sa pika janë matur gjatë një dite nga një ekipë, në rrugën prapa është ri-matur përsëri një pikë e rendit të dytë dhe kanë përfunduar ditën me matjen në pikën e njëjtë të rendit të

parë. Në çdo "ditë të ardhshme gravimetrike", është ri- matur një pikë e rendit të dytë nga dita e mëparshme gravimetrike. Mostra e matjeve profil është treguar në figurat më poshtë:



Një ditë gravimetrike



Dita e ardhshme gravimetrike

Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë fushatës së matjeve ka bërë kontrole të punëve në terren.

Saktësia e përcaktimit të vlerës së përsheptimit gravitacional për pikat e rendit të dytë është:

- 6 matjet në pikë janë $\leq \pm 15 \mu\text{Gal}$.
- përsëritja e matjes në të njëjtën ditë (pika e rendit të parë dhe një pikë të dytë rendit) është $\leq \pm 30 \mu\text{Gal}$
- përsëritja e matjes në ditën e ardhshme (një pikë e rendit të dytë) është $\leq \pm 100 \mu\text{Gal}$

Pasi që projekti është dy vjeçar, në vitin 2019 janë realizuar matjet në 1795 pika të parapara, derisa në vitin 2020 parashihet të maten edhe rreth 647 pika dhe të përfundohet kompletimi i rrjetit gravimetric për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

SFIDAT E PROJEKTIT

Sfidë e këtij projekti mund të jetë realizimi i matjeve në Komunat veriore rreth 250 pika, si dhe rreth 40 pika në lokacionet malore, në veçanti përgjatë kufirit të cilat janë shumë vështirë të arritshme.

4.3 KRIJIMI I MODELIT DIGJITAL TË TERRENIT (DTM), MODELIT DIGJITAL TË SIPËRFAQES (DSM), MODELI 3D I QYTETIT DHE VEKTORIZIMI I OBJEKTEVE

Realizimi i këtij projekti është bërë duke pasur parasysh se AKK për territorin e Republikës së Kosovës kishte vetëm Modelin Digjital të Terrenit (më tutje në tekst DTM) të prodhuar nga rilevimi aerofotogrametrik i vitit 2004. Andaj, qëllimi i projektit është mbulimi me DTM të tërë territorit të Republikës së Kosovës, dhe krijimi i modelit 3D dhe vektorizimi i objekteve për qytetin e Ferizajt dhe një pjese të Prizrenit, duke u bazuar në të dhënat nga rilevimi aerofotogrametrik i vitit 2018. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura sipërfaqet sipas zonave dhe kategorive të të dhënave për prodhimin e Modelit Digjital të Sipërfaqes (më tutje në tekst DSM), Modeli Digjital i Lartësive (më tutje në tekst DEM), Modeli 3D i qytetit dhe vektorizimi i objekteve.

Nr	Kategoria	Sip (km2)	Rjeti [m.]
DSM			
1	Urbane	921.20	0.08
2	Rurale	5937.00	0.20
3	Malore	2234.35	0.25
4	Imazhe nga AKK	1957.75	0.25
DEM			
1	Urbane	921.20	0.08
2	Rurale	5937.00	0.20
3	Malore	2234.35	0.25
4	Imazhe nga AKK	1957.75	0.25
Modeli 3D i qytetit dhe vektorizimi i objekteve			
1	Prizren	5.00	NA
2	Ferizaj	9.50	NA

Sipërfaqet sipas kategorive

Në vijim janë disa ilustrime të: modelit digjital të terrenit (DTM), modelit digjital të sipërfaqes (DSM), modeli 3D i qytetit dhe vektorizimi i objekteve.

MODELI DIGJITAL I SIPËRFAQES - DSM

Modeli Digjital i Sipërfaqes është prodhuar për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në foton e mëposhtme shihet DSM i një pjese të bllokut urban të Prishtinës ku ilustrohen lartësitë të cilat mund të lexohen në çdo pozicion. DSM është prodhuar në formatin "laz", format i cili mund të lexohet përmes aplikacioneve standarde, p.sh. në figurën e mëposhtme përmes GlobalMapper. Dendësia e pikave të të dhënave DSM sipas kategorive është: në blloqet urbane 8 cm, në blloqet rurale 20 cm dhe në blloqet malore 25 cm.




FOTO: DSM URBANE 8 CM

MODELI DIGJITAL I LARTËSIVE DEM

Gjithashtu edhe DEM (Modeli Digjital i Lartësive) është prodhuar për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në fotot e mëposhtme ilustrohet krahasimi i DSM dhe DEM i një pjese të bllokut urban si dhe harta në të cilën paraqitet komplet DEM. Dendësia e pikave të të dhënave DEM sipas kategorive është: në blloqet urbane 8 cm, në blloqet rurale 20 cm dhe në blloqet malore 25 cm. DEM është prodhuar në formatet: "laz", "xyz" dhe Geotiff.




FOTO: MODELI DIGJITAL I LARTËSIVE

MODELI 3D DHE VEKTORIZIMI I OBJEKTEVE

Në kuadër të projektit është realizuar edhe krijimi i modelit 3D dhe vektorizimit të objekteve për qytetin e Ferizajt dhe një pjesë të Prizrenit. Në ilustrimet e mëposhtme shihet vektor harta e një pjesë të bllokut urban të Ferizajt, ku janë të paraqitura të gjitha objektet sipas veçorive në pozitë (xy) dhe lartësi (h). Vektor harta përmban në 3D (X, Y, Z) të gjitha veçoritë si: ndërtesat, ballkonet, shtyllat, trotualet, vegjetacionin, pusetat etj. Gjithashtu për sipërfaqet e njëjta është krijuar edhe modeli 3D i ndërtesave të ilustruara në figurën e mëposhtme. Të dhënat vektor dhe 3D mund të përdoren me anë të aplikacioneve të ndryshme, si p.sh. në fotot e më poshtme Global_Mapper si dhe Atlas_CitiGenius.



FOTO: EKSTRAKT, MODEL 3D I NJË PJESE TË QYTETIT TË FERIZAJT

SAKTËSIA DHE BESUESHMËRIA E TË DHËNAVE

Të gjitha të dhënat e prodhuara dhe dorëzuara janë kontrolluar nga AKK si nga aspekti sasior (mbulueshmëria e tërë territorit) ashtu edhe nga aspekti teknik i kualitetit të tyre. Gjithashtu janë bërë edhe matje në terren për verifikimin e DSM-it, DEM-it, Vektor Hartës dhe Modelit 3D. Andaj mund të konkludohet se saktësia relative e tyre në (X,Y,Z) është rreth 20 cm në blloqet urbane, rreth 40 cm në blloqet rurale si dhe rreth 70 cm në blloqet malore.

SFIDAT E PROJEKTIT

Gjatë implementimit të projektit sfidë ka qenë prodhimi i DSM dhe DTM për një pjesë të territorit rreth kufirit me Serbinë, mbi të cilin territor nuk ka qenë e mundur të fluturohet dhe realizohet rilevimi aerofotogrametrik në vitin 2018. Andaj, për prodhimin e DSM dhe DTM për ato pjesë është përdorur metoda alternative duke shfrytëzuar imazhe satelitore dhe disa informacione tjera nga projektet paraprake të prodhimi të ortofotove.

4.5 KONVERTIMI DHE MIGRIMI I TË DHËNAVE KADASTRALE NË SIKTK-HK

Për shkak të volumit të madh të punëve në ZKK dhe për shkak të mospërdorimit të sistemeve zyrtare nga zyrtarët e ZKK-ve shumë aktivitete të realizuara në pjesën grafike kanë mbetur jashtë sistemeve zyrtare. Në këto raste pronarët e parcelave mund të pajisen me certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme po jo edhe me kopje të planit. Për të eliminuar këtë problem dhe lehtësuar punët e Zyrave Kadastrale Komunale njëherit për të mirën e pronarëve të parcelave AKK ka parë të nevojshëm projektin për mbledhjen, sistemimin, kontrollimin dhe migrimin në Hartën Kadastrale të këtyre të dhënave grafike. Kjo ka lehtësuar shfrytëzimin e të drejtave mbi pronën nga pronarët e këtyre parcelave. Agjencia Kadastrale e Kosovës, paraprakisht ka njoftuar të gjitha Zyrat Kadastrale Komunale në Republikën e Kosovës, për projektin e konvertimit dhe migrimit të të dhënave kadastrale në SIKTK-HK. Bazuar në njoftimin e realizuar, shumica nga ZKK-të që e kanë këtë problematikë kanë përcjellë dokumentacionin përkatës për parcela kadastrale të cilat duhet të konvertohen dhe migrohen në SIKTK-HK. Këto të dhëna të dorëzuara nga ZKK, u janë nënshtruar kontrollit të kualitetit nga ana e ekspertëve të AKK-së, ku pastaj janë dorëzuar tek Operatori Ekonomik për të ju nënshtruar procesit të konvertimit dhe migrimit në SIKTK-HK, gjithashtu është bërë edhe korrigjimi i gabimeve në topologji si dhe korrigjimi i numrave të njësive kadastrale.

METODOLOGJIA E PUNËS

Metodologjia e punës për konvertimin dhe migrimin e të dhënave të hartës kadastrale në bazën e të dhënave SIKTK-HK, gjatë projektit ka qenë e organizuar në dy formate: Në rastin kur numri i parcelave të cilat u janë nënshtruar ndryshimeve dhe korrigjimeve në një zonë kadastrale ka qenë i madh, atëherë ndryshimet janë bërë duke shfrytëzuar softuer CAD apo GIS, dhe të njëjtat janë konvertuar në formatin e pranueshëm të sistemit SIKTK-HK, pastaj të dhënat janë migruar në bazën e të dhënave SIKTK-HK përmes metodës së zëvendësimit të zonës kadastrale. Në rastin, kur brenda një zone kadastrale, numri i parcelave që janë subjekt i ndryshimeve ka qenë relativisht më i vogël atëherë ndryshimet janë realizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në SIKTK-HK, duke ndryshuar vetëm njësitë kadastrale individuale në kuadër të procesit të editimit të njësive kadastrale në SIKTK-HK, pra nuk është vepruar

si në rastin e parë me zëvendësim të zonës kadastrale në sistem.

Të dhëna të cilat u janë nënshtruar konvertimit dhe migrimit, janë konsideruar të gjitha të dhënat të cilat kanë pësuar ndryshime përmes proceseve të njohura kadastrale si bashkimi dhe ndarja e parcelave bazë në SIKTK-HK, pastaj editimi i kufijve të tyre, identifikimi i parcelave nga hartat kadastrale etj.

Përveç editimit, parcelimit dhe bashkimit të parcelave, janë korrigjuar edhe numrat e njësive kadastrale.

Në SIKTK-HK janë azhurnuar dhe korrigjuar këto njësi:

Korrigjimi i topologjisë së parcelave në zona kadastrale	Krijimi i njësive të reja (parcels)	Korrigjimi i numrave të njësive kadastrale
268 Zona Kadastrale	4064	13351



4.6 MIGRIMI I ELABORATIT TË VITEVE 70-TA NË SIKTK PËR RRUGËN MAGJISTRALË SKENDERAJ - DRENAS

Në vitin 2019 AKK pas kërkesës nga komuna e Skenderajt për futjen në SIKTK-HK të vijës së shpronësimit për rrugën magjistrale Skenderaj – Drenas, në bashkëpunim me qeverinë Norvegjeze ka kontraktuar një kompani e cila ka bërë zyrtarizimi e të dhënave në SIKTK. Të dhënat e shpronësimit janë dorëzuar në AKK nga ZKK Skenderaj, të njëjtat janë kontrolluar dhe janë transformuar në Kosovaref01, pastaj i janë dorëzuar OE për të filluar punën në futjen e tyre në SIKTK. Traseja e rrugës ka përfshi këto zona kadastrale: Klinë e Poshtme, Skenderaj, Novosellë, Polac, Polac i ri dhe Marinë. Të dhënat e shpronësimit janë nga elaborati i shpronësimit i viteve `70. Në tabelën më poshtë janë të paraqitur numri i parcelave të cilat janë futur në SIKTK:

Nr.	Zona Kadastrale	Numri i parcelave të reja
1	Klinë e poshtme	88
2	Skenderaj	107
3	Novosellë	57
4	Polac	95
5	Polac i Ri	130
6	Kryshefc	66

Në mungesë të komplet elaboratit të shpronësimit, parcelave të reja të krijuara nuk i është ndërruar pronësia. Kjo do të bëhet nga ZKK pasi të gjenden vendimet e shpronësimit të asaj kohe. Në disa raste për shkak të mungesës së të dhënave në pjesën grafike, ka qenë e pamundur të bëhet ndarja dhe regjistrimi në SIKTK-Tekstuale.

Nr.	Zona Kadastrale	Numri i parcelave që mungojnë në pjesën grafike
1	Klinë e poshtme	26
2	Skenderaj	55
3	Novosellë	7
4	Polac	3
5	Polac i Ri	22

Gjatë punës është bërë identifikimi i disa parcelave të cilat kanë munguar në pjesën grafike, identifikimi është bërë në ZK Skenderaj 52 parcela dhe në ZK Novosellë 9 parcela, ku janë shfrytëzuar harta kadastrale 7F-16C-6 Nr.43 (1:2500). Realizmi i këtij projekti i ka hapë rrugë komunës së Skenderajt dhe Ministrisë së Infrastrukturës, që të përgatis elaboratin e shpronësimit për zgjerimin e rrugës i cili është realizuar në vitet 2018-2019.



Foto: Gjendja para dhe pas migrimit

4.7 SKANIMI DHE DIGJITALIZIMI I DOKUMENTEVE ARKIVORE

AKK ka zhvilluar projektin për digjitalizimin e dokumenteve të arkivuara. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është përmirësimin e shërbimeve të Zyrave Kadastrale Komunale ndaj palëve të interesit në lidhje me informatat e një prone të caktuar, duke bërë digjitalizimin e lëndëve të ndryshme si dhe qasjen dhe gjetjen e tyre në kohën më të shpejtë. Në vitin 2019 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka nënshkruar kontratë dy vjeçare për skanimin dhe indeksimin e dokumenteve arkivore për komunat Ferizaj, Kaçanik, Junik, Kamenicë, Shtime, Klinë, Rahovec, Ranillug, Klllokot, Viti, Gjakovë, Deçan, Dragash, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Shtërrpcë, si dhe në listën e pritjes Prishtinë, Podujevë si dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës. Pas nënshkrimit të kontratës OE ka vazhduar me instalimit e pajisjeve në ZKK-të përkatëse dhe avancimet në aplikacionin "Massive Scanning", ku është integruar kontrolli i kualitetit në kuadër të aplikacionit. Paraprakisht janë njoftuar drejtoritë nëpër komuna për arritjen e marrëveshjes në mes AKK-së dhe Operatorit Ekonomik ku gjithashtu janë informuar në lidhje me vendosjen e pajisjeve për fillimin e procesit të skanimit. Nga ZKK-të është kërkuar që për procesin e skanimit të plotësojë kërkesat respektivisht të sigurojë hapësirë të mjaftueshme për punë, tavolinë pune, karrige, qasje në internet, dhe një zyrtar komunal për të ndihmuar në gjetjen e lëndëve.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura të gjitha llojet e dokumentacioneve të cilat janë evidentuar nëpër Zyrat Kadastrale Komunale:

Lloji i dokumentacionit
Dokumentacioni i sektorit të pronës
Fleta Poseduese
Fletore Takeometrike
FOTO SKICAT
Hipoteka (Lëndët)
Hipoteka (Lëndët)/RDPP (Lëndët)
Kadastru Përshkrues
Kontrata të ndryshme
Kontrata të shitblerjes prej 1955-1999
Koordinatat e Rrjetës së Rendit I, II, III
Lista e Regjistrimit
Pasqyra ABC e shfrytëzuesëve
Pasqyra sipas Kulturave dhe Klasave
Pasqyra Sumare e Fletëve Poseduese
RDPP (Lëndët)
RDPP (Librat)
RDPP për Hipoteka (Librat)
Regjistri ABC i Pronarëve
Regjistri ABC i Shfrytëzuesëve
Regjistri i Fletëparaqitjeve
Regjistri i Fletëparaqitjeve (A3)
Regjistri i llogaritjeve të sipërfaqeve



Regjistri i Ndërrimeve
Regjistri i Ndërrimeve(Libra)
Regjistri i Parcelave
Servitut
Skicat e Detajit
Tokë Bujqësore

Lloji i dokumentacionit për skanim

Skanimi ka filluar me datë 08.07.2019 dhe deri me datë 19.12.2019 janë skanuar dhe indeksuar 2092899 faqe, ndërsa më poshtë janë të paraqitur numrat e faqeve sipas komunave:

Komuna	Numri i faqeve
Ferizaj	622720
Kaçanik	134700
Junik	67914
Kamenicë	138152
Shtime	99643
Klinë	114477
Rahovec	124073
Ranillug	19473
Klllokot	21918
Viti	243333
Gjakovë	5830
Deçan	295713
Dragash	40742
Mamushë	9526
Novoberd	47590
Parteshë	14485
Shtërpc	92610
Total:	2092899

Në vitin 2020 pritet të përfundohen komunat Junik, Gjakovë, Prishtinë, Podujevë si dhe arkiva e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.



KONTROLLI I KUALITETIT

Është kryer kontrolli i kualitetit duke pasur parasysh atributet për çdo lloj të dokumentacionit të skanuar nëpër zyrat kadastrale të komunave, indeksimin e çdo llojë lënde dhe rezolucionin e tyre. Kontrollimi i lëndëve është bërë drejtpërdrejtë në softuer ku paraprakisht u është krijuar qasja disa zyrtarëve, dhe të gjitha lëndët janë adresuar për përmirësime përmes rrugës zyrtare tek operatori ekonomik. Po ashtu janë realizuar vizita në zyrat kadastrale për të parë nga afër procesin e skanimit.

Pas avancimit në aplikacionin nga OE, vërejtjet nga kontrolli i kualitetit janë dhënë direkt në sistem. Kjo ka lehtësuar shumë punën e kontrollit të kualitetit të të dhënave.

Kontrolli i kualitetit të dokumentit të skanuar është bërë në dy hapa, fillimisht duke kontrolluar se a është vendosur rezolucioni i kërkuar për dokumentin përkatës e pastaj me kontrollin e kualitetit të dokumentit dhe indeksimit, pasi që është arkivuar në softuer.

Rezultatet dhe përfitimet që janë arritur në këtë projekt janë të mëdha sepse janë futur të dhënat në aplikacionin e skanimit masiv dhe këto dokumente janë lidhur me SIKTK, gjë që mundëson qasjen më të lehtë e në kohë më të shpejtë në këto lëndë, është reduktuar koha e gjatë që kanë pas zyrtarët e ZKK-së dhe AKK-së në kërkimin e lëndëve dhe dokumentet e arkivuara, është rritur siguria dhe kualiteti i të dhënave kadastrale, është rritur transparenca, etj.



Foto: Monitorimi i skanimit në Ferizaj

4.8 ZGJERIMI I QENDRËS SË TË DHËNAVE (HW-SW)

Meqenëse shumë projekte janë duke u zhvilluar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, qofshin ato që rezultojnë me sisteme elektronike të informacionit (aplikacione) apo ato që rezultojnë me sasi të mëdha të të dhënave, kërkojnë resurse të mëdha harduerike dhe softuerike. Për këtë arsye ishte e domosdoshme që infrastruktura aktuale të ketë mirëmbajtje të vazhdueshme në mënyrë që AKK të mos ballafaqohet me ndërprerje të shërbimeve apo "downtime" të sistemit. Nga analiza e infrastrukturës aktuale të TI-së në raport me projektet që po zhvillohen dhe do të zhvillohen, ka rezultuar që kapaciteti i infrastrukturës duhet zgjeruar dhe avancuar për dy arsye, respektivisht për të ofruar resurset e nevojshme që këto projekte kërkojnë dhe se pajisjet ekzistuese kanë tejkaluar periudhën 3 vjeçare të garancisë.

Për këto arsye ishte i nevojshëm avancimi i qendrës së të dhënave me "Blade Infrastrukturë" dhe "Storage" të ri ku janë vendosur shërbimet kritike me qëllim të rritjes së sigurisë së tyre. Andaj në këtë vit janë prokuruar si vijon:

1. 1xBlade Encloser Chassis me dy Blade Serverë dhe katër licensa VMware vSphere Enterprise Plus 6.7 për virtualizim, ku garancia, për mirëmbajtje dhe përkrahja teknike nga prodhuesit do të jetë 3 vjeçare për secilin produkt. Gjithashtu trajnimi në VMware vSphere Enterprise Plus 6.7 është paraparë për 3 persona, administratorë të infrastrukturës.
2. Hapësirë magazinuese (STORAGE SOLUTION) me hapësirë të formatuar 36TB ku periudha e garancisë, mirëmbajtja dhe përkrahja teknike nga prodhuesi do të jetë 3 vjeçare dhe
3. 15 copë Backup Tapes, për Backup Tape Librarinë e re.

Për nevoja të aktiviteteve operationale të AKK-së janë specifikuar edhe 2 kompjuter, 6 monitor, 1 televizor dhe një pajisje e cila do të përdoret për takime\konferenca grupore në distancë (online). Rezultatet kryesore nga "Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW dhe SW)" janë siguria në ofrimin e shërbimeve dhe operimeve në mënyrë të pandërprerë apo me ndërprerje minimale për punonjës, qytetarë, sektorin privat si dhe institucionet qeveritare. Gjithashtu kjo do të mundësojë implementimin në tërësi të projekteve të cilat janë të parapara të zhvillohen në AKK. Me realizimin e këtij projekti do të ulët ndjeshëm rrezikshmëria e humbjes së të dhënave pasi që pajisjet e reja do të jenë në garancinë dhe mirëmbajtjen e ofruar nga prodhuesi në periudhë 3 vjeçare dhe strategjia e kopjeve rezervë do të jetë edhe më produktive me përdorimin e TAPE-ve të ri.



4.9 MIREMBAJTJA DHE ZHVILLIMET E SISTEMIT TË INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKËS NË KOSOVË (SIKTK)

Agjencia Kadastrale e Kosovës duke tentuar të zgjerojë vargun e shërbimeve që ofron si dhe duke aspiruar ndjekjen e trendëve zhvillimore teknologjike ka avancuar Sistemin e SIKTK-së në parimet e Arkitekturës së Orientuar në Shërbime (SOA).

Këto avancime bazohen në parimet si vijon:

1. Secili nënsistem funksionon në mënyrë të pavarur nga modulet e tjera të sistemit,
2. Çdo nënsistem kontrollon në mënyrë të plotë të dhënat për të cilat është përgjegjës,
3. Nën sistemi komunikon me njëri-tjetrin dhe me klientë të ndryshëm nëpërmjet shërbimeve të ndërveprimit.

Agjencia Kadastrale e Kosovës në Maj 2019, ka nënshkruar kontratën trevjeçare të mirëmbajtjes së të gjitha aplikacioneve si vijojnë:

Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë - Tekstuale,
 Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë – Online,
 Moduli i Menaxhimit të Dokumenteve (DOC),
 Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë - Harta kadastrale,
 Sistemi i Regjistrimit të Adresave (ARIS),
 Gjeoportali Shtetërorë,
 Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë - Grafike,
 Sistemi i Unifikuar i Ueb Shërbimeve Kadastrale (SUUSHK),
 Skanimin Masiv dhe
 Sistemi për RIK.

Përveç mirëmbajtjes së zakonshme për mirëfunksionimin e sistemeve gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe kërkesa për zhvillime të reja në disa prej sistemeve që ofrojnë mundësi më të mëdha për nxjerrjen e statistikave të ndryshme, ndërlidhjen e Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokës në Kosovë me sistemet e jashtme (Regjistrin Civil, Regjistrin e Bizneseve dhe Regjistrin e OJQ-ve) përmes platformës qeveritare të Interoperabilitetit. Kufizime shtesë në funksionalitet të aplikacioneve me qëllim ngritjen e cilësisë së punës dhe shkurtimin e kohës për azhurnime. Janë gjithsej 13 kërkesa të reja që janë zhvilluar gjatë 5 muajve të parë të mirëmbajtjes, por janë planifikuar edhe 65 kërkesa tjera për zhvillime në këtë periudhë 3 vjeçare, zhvillime këto të cilat do të rrisin performancën dhe shpejtësinë e punës së sistemeve. Numri i kërkesave nuk është i limituar dhe ato do të varen nga situatat që do të paraqiten gjatë kohës së mirëmbajtjes.

4.10 VENDOSJA E TABELAVE TË ADRESAVE NË KOMUNAT PEJË, KLINË, GJILAN DHE KAMENICË

Përmes Statens Kartverk, Qeveria e Norvegjisë për shumë vite ka përkrahur Agjencinë Kadastrale të Kosovës për zhvillimin e Administrimit të Tokës në Republikën e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe projektin për vendosjen e tabelave të adresave në komunat Pejë, Klinë, Gjilan dhe Kamenicë.

FAZAT E REALIZIMIT TË PROJEKTIT GJATË VITIT 2019

1. Piketimi në terren

Pas përfundimit të proceduarve përgatitore ka filluar realizimi i punimeve në terren. Me të njëjtin intensitet dhe të njëjtat veprime është punuar në të katër komunat. Punimet kanë filluar në gjysmën e dytë të vitit 2018, ndërsa zhvillimi i tyre ka vazhduar edhe në gjysmën e parë të vitit 2019. Zyrtarët e komunave, bashkërisht me stafin e kompanisë implementuese, të mbështetur nga zyrtarët e njësisë së adresave në AKK kanë bërë piketimet (shenjëzimet) e vendeve për vendosjen e shtyllave të tabelave të emrave të rrugëve. Këto piketime shenjëzime janë bërë sipas hartave dhe të dhënave të gjeneruara nga Sistemi i Informacioneve për Regjistrin e Adresave (ARIS), të përgatitura nga zyrtarët e AKK-së.

2. Betonimi dhe vendosja e shtyllave

Hapja e gropave është bërë sipas specifikave teknike (50x50x50cm) të përcaktuara në UA për adresat, të cilat janë mbushur me beton dhe është bërë instalimi i shtyllave në pozicion të drejtë vertikal.



Foto: Shembull i shtyllës me emër rruge

3. Instalimi i tabelave

Projekti ka paraparë për vendosje dy lloje të tabelave: tabela dyfaqësore në shtyllë dhe njëfaqësore në mure. Fillimisht, është bërë vendosja/instalimi i tabelave në shtyllë. Ndërsa në fund janë vendosur tabelat e murit. Vendosja dhe drejtimi i tyre sipas rrugëve përkatëse është bërë në bazë të hartave që ka përgatitur AKK, gjithnjë me prezencën e zyrtarëve komunal dhe mbikëqyrjen e zyrtarëve të njësisë së adresave në AKK të cilët kanë bërë kontrolle të kualitetit.

4. Kontrolli i kualitetit

Zyrtarët e AKK-së kanë bërë kontrolle sistematike të kualitetit të secilës fazë të punimeve të zhvilluara. Kjo është bërë përmes inspektimeve dhe matjeve të realizuara në terren. Punimet janë realizuar brenda parametrave të përcaktuar në UA për Adresa. Në këto kontrolle zyrtarët e njësisë së adresave në AKK kanë përgatitur raporte të rregullta të dëshmuara me fotografi në bazë të të cilave janë dhënë edhe vërejtjet e nevojshme për përmirësim. Në këto raste OE-së i është kërkuar që të përmirësohen para se të pranohen si punë të kryera. Bazuar në raportet përfundimtare është arritur që në fund të projektit të vendosen 2879 tabela të emrave të rrugëve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Gjilan	Kamenicë	Klinë	Pejë
986 rrugë	556 rrugë	392 rrugë	945 rrugë

Pas përfundimit të projektit të Adresave në të gjitha komunat është bërë inaugurimi i projektit ku ishin prezentë ambasadori norvegjez, Kryeshefi i AKK-së, përfaqësuesit e Statens Kartverk dhe kryetarët e komunave përkatëse. Nga ky projekt përfitojnë qytetarët, drejtoritë komunal dhe të gjitha institucionet të cilat i shfrytëzojnë rrugët si referencë dhe orientim.



Foto: Inaugurimi i adresave në Klinë

4.11 RENOVIMI I ZYRËS KADASTRALE KOMUNALE NË VUSHTRRI

Si rezultat i bashkëpunimit mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Komunës së Vushtrrisë dhe Autoritetit Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Statens Kartverk", respektivisht Qeverisë së Norvegjisë, me datë 18 qershor 2019, është bërë inaugurimi i Zyrave Kadastrale të reja në këtë Komunë. Investimi për këtë projekt, i cili arrin vlerën e 65,000 eurove do të ndikojnë në avancimin e kushteve të punës për personelin e komunës, do të ndikojnë në avancimin e kushteve për qytetarët të cilët i drejtohen zyrave kadastrale komunale, do të rris transparencën gjatë kryerjes së punëve, do të ndikojnë më minimizimin e secilës mundësi për korrupsion, do të fuqizojnë llogaridhënien dhe në fund të do rris edhe kualitetin e shërbimeve dhe produkteve kadastrale dhe pronësore të cilat u ofrohen qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. E rëndësishme për tu potencuar është se këto investime në zyrat e reja, në inventar, në rrjetin e energjisë elektrike, në ventilimin dhe në pajisje dhe hapësira tjera nuk kanë për qëllim vetëm rinovimin e hapësirave fizike, por kanë për qëllim edhe ndërrimin e vet mënyrës së punës në tërësi gjatë ofrimit të shërbimeve kadastrale dhe pronësor-juridike, përmes funksionalizimit të zyrave pritëse dhe zyrave për procesim të lëndëve. Kjo nënkupton se qytetarët nuk do të kenë nevojë të shkojnë zyre pas zyrës, njeri pas njeriut, por kërkesat e tyre do të dorëzohen në një adresë të vetme, te zyra pritëse ku kushtet janë dinjitoze. Rrjedhimisht zyrtarët që procesojnë lëndët, nuk do të kenë nevojë që të pranojnë palë nëpër zyrat e punës ku procedohen lëndët. Me rastin e ceremonisë inauguruese të këtij projekti, morën pjesë përfaqësues të autoritetit norvegjez për kadastër "Statens Kartverk", respektivisht z. Helge Onsrud dhe z. Tor Laugen, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, dhe nikoqiri, Kryetari i Komunës z. Xhafer Tahiri.



Foto: Inaugurimi i zyrave të rinovuara në Vushtri

5.KOORDINIMI INSTITUCIONAL I ADMINISTRIMIT TË TOKËS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës me qëllim të koordinimit sa më të mirë institucional, organizon dhe merr pjesë në iniciativave të ndryshme institucionale në të cilat avokon dhe projektin aktivitete bashkëpunuese me palë të interesit publik e privat, si brenda shtetit po ashtu edhe jashtë. Aktualisht, si mekanizma të fuqishëm për koordinim institucional janë Komiteti Ndërmënyor për Administrimin e Tokës dhe për Infrastrukturën Kombëtare të të Dhënave Hapësinore, Komiteti për të Drejta Pronësore dhe Komiteti për Koordinimin e Donatorëve.

5.1 KOMITETI PËR ADMINISTRIMIN E TOKËS DHE INFRASTRUKTURËN KOMBËTARE



Foto: Takimi i Komitetit Ndërmënyor

TË TË DHËNAVE HAPËSINORE

Komiteti Ndërmënyor për Administrimin e Tokës është themeluar në vitin 2009 me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Komiteti përbëhet nga AKK, AKKPV, MMPH, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të tjera. Përbërja e këtij Komiteti është dinamike dhe përfshinë agjenci dhe ministri sipas nevojës për të përmirësuar përpjekjet e koordinimit sidomos

atje ku nevojiten më shumë. Temat e këtij Komitetit përfshijnë diskutime strategjike mbi administrimin e tokës, regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe çështje tjera lidhur me të dhënat gjeohapësinore në Kosovë etj. Takimi fundit i Komitetit për Administrimin e Tokës dhe IKIH është organizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me datë 11 Prill dhe është udhëhequr nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Z. Fatmir Matoshi. Në këtë takim është diskutuar për të arriturat dhe sfidat që ka Agjencia Kadastrale e Kosovës si dhe janë shpalosur rekomandimet e donatorëve për këtë Agjenci. Ministri Matoshi në këtë takim ka mbrojtur qëndrimin se Qeveria e Republikës së Kosovës e njeh peshën e administrimit të tokës si nga aspekti i zhvillimit ekonomik po ashtu edhe nga aspekti i mirëqenies sociale për secilin qytetar të Republikës së Kosovës pa dallim gjinie, gjuhe apo etnie. Gjithashtu ai ofroi mbështetje Agjencisë Kadastrale të Kosovës duke siguruar që çdo rekomandim i AKK-së dhe i donatorëve ndihmon dhe lehtëson politik-bërjen dhe vendimmarrjen. Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti ka nënvizuar se bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të akterëve, është një strategji e qartë dhe e nevojshme gjatë zhvillimit të administrimit të tokës në Republikën e Kosovës. Pjesë e takimit të Komitetit Ndërmënisht për Administrimin e Tokës ishin edhe Ministri i Ministrisë së Administratës Publike z. Mahir Jagcilar, Zv.Ministri i Ministrisë së Drejtësisë z.Fadil Nura, Zv. Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Mevludin Krasniqi, Zv. Ministri i Ministrisë së Financave z. Hyzer Gashi, Zv. Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal z. Beqir Fejzullahu si dhe donatorët si Banka Botërore, Statens Kartverk (Norvegji), USAID, JICA, GIZ, UN HABITAT, Zyra e BE-së në Kosovë, etj, të cilët vlerësuan se Draft Ligji për Kadastër duhet të miratohet si i tillë për shkak se parasheh transparencë në të dhëna. Po ashtu, ata vlerësuan se është e domosdoshme që Kosova, në një të ardhme të afërt, të ketë sistemin adresave nëpër gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Ishte hera e parë që në takim të Komitetit morrën pjesë strukturat më të larta të institucioneve që ndërlidhen me administrimin e tokës në Republikën e Kosovës si dhe përfaqësues më të lartë të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës.



Foto: Takimi i Komitetit Ndërmënisht

5.2 KOMITETIT DREJTUES PËR TË DREJTA PRONËSORE

Nën organizimin e Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë z. Abelard Tahiri dhe me synim shpalosjen e të arriturave të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për të Drejta Pronësore, respektivisht për prioritizimin e masave për zbatim gjatë vitit 2019 nga perspektiva e ndërlidhjes së të drejtave pronësore me Programin e Reformave Ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 25 prill në Prishtinë është mbajtur takimi i Komitetit Drejtues për të Drejta Pronësore. Ministri Tahiri në takim ka shpalosur sukseset e arritura në sektorin e të drejtave pronësore, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm në këtë Ministri z. Qemajl Marmullakaj ka prezantuar në detaje masat e dala nga plani i veprimit dhe zbatimin e këtyre masave. Është diskutuar gjithashtu rreth reformave që duhet ndërmarrë me qëllim të avancimit të fushës së të drejtave pronësore në Republikën e Kosovës. Në takim ku morën pjesë palë të interesit në fushën e të drejta pronësore, u përfaqësua dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës, nga Drejtori Ekzekutiv z. Avni Ahmeti. Z. Ahmeti ka ngritur dy çështje të rëndësishme në këtë takim, shtimin e kompetencave ligjore Komisionit për Rindërtim të Informacioneve Kadastrale me qëllim të formalizimit të transaksioneve joformale dhe kërkoj përkrahje në shtyrjen para të ligjit të ri për kadastrë. Dy çështjet e ngritura nga z. Ahmeti si dhe shtyrja para e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dolën edhe si rekomandime nga takimi i këtij Komiteti Drejtues.

5.3 KOMITETI KOORDINUES ME DONATORËT

Qëllimi i Komitetit Koordinues me Donatorët është të koordinojë aktivitetet e donatorëve dhe përdorimin e fondeve për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Biznesit të AKK-së dhe të mbështesë zbatimin e aktiviteteve duke mbajtur donatorët të informuar për situatën në lidhje me sektorin kadastral në Kosovë dhe aktivitetet mbështetëse. Gjithashtu ky Komitet ofron mbështetje dhe këshilla për Komitetin Ndërmintor të Administrimit të Tokës. Ofron mbështetje këshilluese për AKK-në në përgjegjësitë e saja për zbatimin e Planit të Biznesit dhe përkrahjen e planit të veprimit dhe koordinimin e tij me projektet e tjera të ndërlidhura. Komiteti Koordinues me Donatorët mban takime dy herë në vit. Takimi i fundit i këtij Komiteti u mbajt me datë 10 prill 2019 në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Qëllimi i këtij takimi është koordinimi i aktiviteteve të ndryshme të donatorëve dhe përkrahësve të AKK-së me qëllim të ngritjes së shkallës së transparencës, shmangien e mundësive për duplikimin të projekteve, diskutim mbi rezultatet e arritura si dhe diskutim rreth sfidave me të cilat ballafaqohet administrimi i tokës. Në këtë takim janë prezantuar në detaje të arriturat e AKK-së ndërsa fokusi i veçantë iu kushtua projekteve të ardhshme të AKK-së të parapara për tu realizuar si përmes financimit të buxhetit të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe përmes financimit nga projekti REGIP i Bankës Botërore dhe donatorëve nga autoriteti norvegjez për kadastrë dhe hartografi "Statens Kartverk" dhe nga JICA japoneze. Ndërsa si sfida që duhen tejkaluar me qëllim të realizimit të suksesshëm të projekteve u ngrit nevoja për shtim të numrit të punëtorëve profesional në AKK dhe shtyrja para e ligjit të ri për kadastrë i cili do të ristrukturonte sistemin kadastral në Kosovë. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Bankës Botërore, JICA-s japoneze, "Statens Kartverk" norvegjez, GLZ-it gjerman dhe projekti për të drejta pronësore i mbështetur nga USAID.

6.KOORDINIMI I PROJEKTEVE, BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës është funksionale edhe Njësia për Implementimin e Projekteve, e cila si pasuese e Zyrës për Koordinimin e Projekteve, siguron që të gjitha aktivitetet e projekteve të jenë në përputhje me ligjet vendore dhe kërkesat, procedurat dhe rregullat e vetë donatorëve apo përkrahësve si Banka Botërore, SIDA, Autoriteti Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi Kartevker, etj. Ndërsa sa i përket projekteve kryesore të cilat zhvillohen me përkrahjen e organizmave ndërkombëtare janë Projekti për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP) dhe projekti IMPULS.

6.1 PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME DHE INFRASTRUKTURËS GJEO-HAPËSINORE (REGIP)

Projekti për regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe infrastrukturës gjeohapësinore (REGIP) është i mbështetur nga Banka Botërore në formë kredie në vlerë prej 14.600.000 Euro. Projekti do të implementohet në periudhën 2019 - 2023 dhe përbëhet nga këto komponentë:

Komponenti A. Politikat, Mbështetja Ligjore dhe Institucionale: Qëllimi i Komponentit A është të ofrojë mbështetje politike, ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Kjo komponentë do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) zhvillimin e një strategjie të përditësuar të AKK-së dhe planit të biznesit për të informuar dhe udhëzuar zhvillimin e ardhshëm të të dhënave dhe shërbimeve kadastrale dhe gjeohapësinore në Kosovë; dhe (b) zhvillimin e mëtejshëm të Ligjit të ri të Kadastrit.

Komponenti B. Modernizimi i Kadastrit : Objektivi i këtij komponenti është vazhdimi i modernizimit të kadastrit në Kosovë, e cila filloi në kuadër të projektit paraprak për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër (RECAP). Ky komponent do të financojë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) rindërtimin e informacioneve kadastrale në 140 Zona Kadastrale; (b) përmirësimi i cilësisë së të dhënave kadastrale; (c) zhvillimin e kadastrit të përçojave; (d) zhvillimin e regjistrit të ndërtesave; dhe (e) renovimin dhe ri-inzhinjerimin e Zyrave Kadastrale Komunale.

Komponenti C. Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore: Objektivi i këtij komponenti është të bëjë investime në sistemet e IT-së dhe investime për të dhënat gjeohapësinore për tregun e tokës dhe pronës në Republikën e Kosovës dhe do të mbështesë zbatimin e strategjive të AKK-së për IT dhe Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH). Ky komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) përmirësimin e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë në drejtim të Arkitekturës së Orientuar në Shërbime (SIKTK-SOA); (b) Arkivin digjital të AKK-së; (c) Zbatimin e strategjisë së IT-së për AKK-në; (d) investimet në IKIH (ang.NSDI); dhe (e) Zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjetit shtetëror gjeodezik të GPS-it, KOPOS.

Komponenti D. Menaxhimi i Projektit, Ndërtimi i Kapaciteteve, Informimi Publik dhe Monitorimi dhe Vlerësimi : Qëllimi i këtij komponenti është të sigurojë zbatimin e plotë në afat kohor të Projektit. Ky Komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) njësinë e zbatimit të projektit (PIU) dhe koordinimin e donatorëve; (b) monitorimin dhe vlerësimin; (c) anketat e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet kadastrale, (d) Informimi i publikut dhe mekanizmi i dëmshpërblimit (GRM); (e) ngritja e kapaciteteve për AKK dhe Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

(AKKVP); dhe (f) Grupi i përbashkët i punës ndërmjet AKK dhe AKKVP-së.



Foto: Nënshkrimi i marrëveshjes financiare për REGIP

6.2 PROJEKTI IMUPLS

Projekti IMPULS konsiston me harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore të shteteve të Ballkanit perëndimor konform atyre të shteteve anëtare të BE, respektivisht në përputhje me Direktivën Evropiane 2007/2 INSPIRE. Përfitues të këtij projekti janë 8 Autoritete për Kadastër, Gjeodezi dhe Hartografi (AKGJH) të 6 shteteve rajonale në Ballkanin Perëndimor (Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina). Projekti IMPULS financohet nga SIDA Suedeze, dhe implementohet nga Autoriteti për Kadastër dhe Hartografi i Suedisë Lantmateriet dhe Autoriteti Shtetëror për Gjeodezi i Republikës së Kroacisë. Arsyeja e implementimit të projektit është të përshpejtojë zhvillimin e shërbimeve inovative të INSPIRE për një politikë më të mirë të hartimit të politikave mjedisore, transparencës në regjistrimin e pronës, kadastrin, sigurinë e pronësisë për investimet e huaja në vend dhe për arritjen e ndërveprueshmërisë së grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve, si dhe përmirësimin e legjislacionit. Rezultati i projektit ndihmon në marrjen e veprimeve që çojnë në krijimin e komuniteteve të qytetarëve të fuqizuar nga sistemet e hapura, të jenë në gjendje të kenë qasje në informacione gjeohapësinore që kanë të bëjnë me mjedisin e tyre dhe të kontribuojnë në debatet shoqërore, duke përfshirë kontributet që gjenerohen nga përdoruesit, si dhe veprime që nxisin zbatimin praktik të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në sektorin publik dhe të vet Direktivës së EU-së, INSPIRE. Projekti ka filluar me implementim në Qershor të vitit 2014 dhe pritet të përfundojë në Qershor të vitit 2019. Është i ndarë në 6 komponenta:

- Komponenti 1: Menaxhimi i projektit dhe ngritja e kapaciteteve,
- Komponenti 2: Politikat dhe rregullat e shkëmbimit të të dhënave,
- Komponenti 3: Harmonizimi i të dhënave,

Komponenti 4: Meta të dhënat dhe kualiteti i të dhënave,
 Komponenti 5: Shpërndarja e të dhënave, shërbimet dhe gjeoportalet,
 Komponenti 6: Benefitet e projektit, Implementimi i rasteve të përdorimit.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit IMPULS për vitin 2019 janë si vijon:

- AKK ka marrë pjesë në 1 takim të Komitetit Drejtues të projektit, me 12 prill, 2019 në Shkup,
- Janë mbajtur 2 takime të koordinatorëve shtetëror të projektit IMPULS për të koordinuar të gjitha aktivitetet dhe për të implementuar Planin e Punës së projektit për vitin 2019,
- Projekti IMPULS ka përkrahur organizimin e Konferencës së 12 Regjionale për kadastrë dhe infrastrukturë të të dhënave gjeohapësinore e mbajtur me 4-6 shtator, në Neum, B&H. Në këtë konferencë është nënshkruar Marrëveshja për bashkëpunim regjional në fushën e kadastrit, gjeodezisë, hartografisë dhe infrastrukturës së të dhënave gjeohapësinore midis shteteve të Ballkanit perëndimor,
- Me përkrahje të ekspertëve të IMPULS, më 02 tetor 2019, AKK-ja ka mbajtur punëtorinë për rritjen e njohurive të AKK-së për hartimin e Udhëzimeve Administrative për zbatimin e Ligjit për IKIH, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të departamentit ligjor të AKK-së dhe MMPH-së. Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie ka qenë të mësohet nga përvoja suedeze lidhur me hapat për krijimin dhe zbatimin e IKIH në vend, si dhe hartimi dhe zbatimi udhëzime teknike dhe ligjore dhe kornizat për zbatimin e IKIH sipas Direktivës INSPIRE,
- Agjencia Kadastrale e Kosovës ka marrë pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit IMPULS në Banjallukë, B&H me datë 13 nëntor 2019, ku ka prezantuar të gjitha arritjet dhe benefitet me mbështetje të këtij projekti,
- Është bërë përkrahje e AKK-së me 3 ekspert vendor për të mbështetur aktivitetet e projektit IMPULS. Kjo përkrahje do të përfundojë në fund të vitit 2019,
- Ka vazhduar bashkëpunimi në mes të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe AKK-së, me përditësimin e të dhënave minerare dhe gjeologjike dhe këto të dhëna janë paraqitur në Gjeoportal-in shtetëror.
- Janë pranuar të dhëna me qëllim të paraqitjes në gjeoportal nga:

Ministria e Infrastrukturës

Rrjeti hekurudhor
 Rrjeti i autoudhëve
 Rrjeti i rrugëve nacionale
 Rrjeti i rrugëve rajonale

Policia e Kosovës

Stacionet policore-kufitare dhe lokale

Agjencia e Menaxhimit Emergjent

Stacionet policore-kufitare dhe lokale
 Stacionet e zjarrfikësve
 Shkollat
 Qendrat shëndetësore

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Perimetri i asetit

Zona e mbrojtur e asetit

Termokos (termopërçojat)

Gypi furnizues

Gypi kthyes

Pusetat

KOSTT (në proces)

Linjat me atribut e nivelit të tensionit, 400kV, 220kV dhe 110kV

Shtyllat

Nënstacionet

6.3 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË NORVEGJEZE

Përmes Statens Kartverk, Qeveria e Norvegjisë për shumë vite ka përkrahur Agjencinë Kadastrale të Kosovës për zhvillimin e kadastrit dhe administrimit të tokës në Republikën e Kosovës. Duke iu përgjigjur kërkesave të vazhdueshme, Statens Kartverk në vitin 2017 paraqiti një propozim në Ministrinë Norvegjeze të Punëve të Jashtme, i cili është aprovuar në fund të vitit 2017. Marrëveshja e Grantit në fjalë quhet RER-17/0008 - Statens Kartverk për shtetet e Ballkanit Perëndimor 2017-2020. Marrëveshja e këtij Granti me Agjencinë Kadastrale të Kosovës është nënshkruar me 7 Janar 2018 dhe përfundon me 30 Tetor 2020, me donacion prej 8.950.000 NOK. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të përcjellë, kompletojë, zgjerojë dhe përmirësojë aktivitetet nga projektet e mëparshme të Statens Kartverk me Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Aktivitetet kryesore të planifikuara në këtë projekt janë vendosja e tabelave të adresave në Komunitat Pejë, Klinë, Gjilan dhe Kamenicë, migrimi dhe konvertimi i të dhënave grafike në hartën kadastrale (cadastral map) në 7 ZKK, zgjerimi i regjistrit të pronës dhe regjistrit të adresave në tri komunitat në Veri të vendit (nëse është e mundur gjatë periudhës së Projektit), përmirësimi i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit të AKK-së, renovimi i Zyrave për ZKK-në Vushtrri etj.



Foto: Nga vizita e Ambasadorit Norvegjez në AKK

6.4 ADMINISTRIMI I TOKËS NË FAVOR TË POLITIKAVE TË GJELBRA - DITËT E INOVACIONIT TË GJELBËR NË REPUBLIKËN E KORESË SË JUGUT



Foto: Kryeshefi i AKK-së në panel profesional

Agjencia Kadastrale e Kosovës e udhëhequr nga Kryeshefi i saj Ekzekutiv z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorë nga fusha e kadastrës dhe teknologjisë së informacionit, ka qëndruar në vizitë pesëditore në Seul, Republika e Koresë së Jugut. Qëllimi i qëndrimit në Kore ishte participimi në konferencën ndërkombëtare kushtuar krijimit të politikave dhe ambienteve të gjelbra si pjesë e administrimit të tokës, “Korea Green Inovation Days” (Ditët e inovacionit të gjelbër në Kore). Në kuadër të aktiviteteve përveç atyre të ndërlidhura me konferencën, ekspertët e AKK-së kishin mundësi të mbajnë takime me prijës të institucioneve të interesit nga fusha e kadastrës, administrimit të tokës, infrastrukturës së të dhënave hapësinore, e-qeverisjes e ngjashëm. Në mesin e takimeve më të rëndësishme ishin ato me institucionin homolog në fushën e kadastrës, Agjencia për mirëmbajtjen e Regjistrave Pronësor dhe për Kadastër (LX), me Agjencinë Shtetërore për Informacione Hapësinore, Agjencinë Shtetërore për e-Qeverisje si dhe Agjencinë Shtetërore për Banim dhe Tokë. Ndërsa, si pjesë kryesore e aktiviteteve, respektivisht pjesëmarrja në konferencën për politika të gjelbra, e mbajtur me datat 26 dhe 27 shtator, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti ishte panelist në sesionin kushtuar transformimit të shteteve në zhvillim dhe orientimi i tyre kah përkrahja e politikave të gjelbra. Përndryshe në konferencën e organizuara nga Banka Botërore, morën pjesë përfaqësues nga dhjetëra institucione nga e tërë bota, me mbi 200 pjesëmarrës. Të gjitha këto aktiviteteve u shfrytëzuan edhe për vendosjen e bazave për një bashkëpunim konkret në të ardhmen, përfitimet nga i cili bashkëpunim nuk do të ishin vetëm të përveçme për AKK-në, por të përgjithshme për shumicën e institucioneve në fushëveprimin e të cilëve bie mbrojtja e ambientit dhe krijimi i politikave të gjelbra.



Foto: Një nga tryezat e shumta të mbajtura në Kore të Jugut

7. MEMORANDUME BASHKËPUNIMI PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

7.1 MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE SHOQATËS SË GJEODETËVE TË KOSOVËS

Me qëllim të ngritjes së shkallës së bashkëpunimit në ngritjen e kapaciteteve profesionale, organizative dhe shkencore në fushën e Gjeodezisë, Kadastrës, Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Hartografisë dhe Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor, me datën 2 gusht 2019 në ambientet e AKK-së është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës.



Foto: Moment nga nënshkrimi i memorandumit me ShGjK

7.2 MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE AGJENCISË SHTETËRORE PËR KADASTËR E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Agjencia Kadastrale e Kosovës, respektivisht Kryeshefi Ekzekutiv i saj z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij ka mbajtur një takim pune me një delegacion gjithëpërfshirës nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës e Republikës së Shqipërisë (AShK), të prirë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Artan Lame po ashtu i shoqëruar nga bashkëpunëtor kadastral, ligjor dhe të teknologjisë së informacionit. Palët në takim kanë nënshkruar edhe Memorandumin e Bashkëpunimit për identifikimin dhe avancimin e fushave të interesit të përbashkët.



Foto: Moment nga nënshkrimi i memorandumit me ASHK

7.3 MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR BASHKËPUNIM REGJIONAL

Një delegacion i Agjencisë Kadastrale të Kosovës i prirë nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Avni Ahmeti ka marrë pjesë në Konferencën e 12 regjionale për kadastër dhe Infrastrukturë kombëtare për informacionet gjeohapësinore, e cila është mbajtur në Neum të Bosnje dhe Hercegovinës me 4, 5 dhe 6 shtator, 2019. Qëllimi kryesor i kësaj Konference ishte nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes institucioneve përgjegjëse për hartografi dhe kadastër nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, respektivisht nga Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina, Serbia, Sllovenia dhe Kroacia. Kjo marrëveshje ka për qëllim ngritjen e shkallës së bashkëpunimit mes institucioneve respektive në fushat e interesit të përbashkët, duke përfshirë avancimin e bashkëpunimit në kadastër, gjeodezi dhe hartografi, në zhvillimin dhe interoperabilitetin e GNSS sistemeve, në zhvillimin e rrjeteve gravimetrike dhe trigonometrike, në harmonizimin dhe hapjen e të dhënave hapësinore konform politikave dhe direktivave të BE-së e ngjashëm. Marrëveshja u përkrah edhe nga shtete dhe organizata të fuqishme si Qeveria Suedeze, Qeveria Norvegjeze, Qeveria Holandeze, Banka Botërore, JICA, të cilat ishin edhe promotorë të arritjes së kësaj marrëveshjeje.



Foto: Moment nga nënshkrimi i memorandumit për bashkëpunim regjional

7.4 MEMORANDUM MIRËKUPITIMI MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE TOMTOM

Në vazhden e bashkëpunimeve ndërkombëtare me kompani të mëdha dhe të rëndësishme në fushën e të dhënave gjeohapësinore dhe me qëllim që të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës të shfrytëzohen jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj, AKK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë TOMTOM rreth shfrytëzimit të të dhënave të adresave zyrtare të Republikës së Kosovës nga TOMTOM. Kjo marrëveshje është si rezultat i krijimit të një regjistri digjital, të avancuar dhe të saktë të adresave nga Republika e Kosovës dhe pas një analize nga ana e TOMTOM e cila ka konstatuar se të dhënat janë të sakta dhe të avancuara. Të dhënat zyrtare të adresave të Republikës së Kosovës do të shfrytëzohen për të azhurnuar hartat e Republikës së Kosovës në hartat e TOMTOM. Me këtë marrëveshje shteti i Kosovës do të jetë njëri nga shtetet e para në Ballkan, harta e së cilës do të azhurnohet me të dhëna zyrtare, unike dhe të sakta të adresave. Gjithashtu marrëveshja është një hap më tutje në informimin rreth të dhënave zyrtare të adresave dhe mundëson që adresat të shfrytëzohen edhe më shumë. TOMTOM është njëra nga kompanitë më të mëdha dhe më të rëndësishme ndërkombëtare për teknologji të navigacionit. TOMTOM është kompani Holandeze me seli në Amsterdam dhe është krijuar në vitin 1991. TOMTOM operon në mbi 150 shtete dhe ka me miliona klient.



Foto: Takim mes AKK dhe TomTom

7.5 MEMORANDUM MIRËKUPITIMI MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE OPEN STREET MAP

Agjencia Kadastrale e Kosovës si koordinatorë për infrastrukturën e të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Kosovës, është në proces të hapjes së të dhënave të saja dhe të avancimit të mënyrës së shkëmbimit të të dhënave mes institucioneve publike dhe private si brenda Republikës së Kosovës po ashtu edhe më gjerë. Në mesin e institucioneve me të cilat AKK parasheh shkëmbimin e të dhënave është edhe OJQ "Free Libre Open Source Kosova". për këtë arsye në një takim mes përfaqësuesve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, respektivisht Kryeshefit Ekzekutiv z. Avni Ahmeti dhe Drejtorit për Kadastër në AKK z. Korab Ahmetaj dhe përfaqësuesve të "Free Libre Open Source Kosova" përfaqësuar nga Kryetari i Bordit Ekzekutiv të kësaj OJQ z. Arianit Dobroshi, është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në fushën e shkëmbimit të të dhënave.

7.6 MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE "HERE WE GO MAPS"

Në vazhden e bashkëpunimeve ndërkombëtare me kompani të mëdha dhe të rëndësishme në fushën e të dhënave gjeohapësinore dhe me qëllim që të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës të shfrytëzohen jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj Agjencia Kadastrale e Kosovës, respektivisht Kryeshefi i saj Ekzekutiv z. Avni Ahmeti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Here WeGo Maps rreth shfrytëzimit të të dhënave të adresave zyrtare të Republikës së Kosovës nga "Here WeGo Maps". "Here WeGo Maps" është njëra nga kompanitë më të mëdha dhe më të rëndësishme ndërkombëtare për teknologji web mapping dhe të navigacionit. "Here WeGo Maps" është zhvilluar nga kompania Nokia si aplikacion softuerik hartografik i lëshuar për herë të parë në vitin 2013. "Here WeGo Maps" është në pronësi të një konsorciومي kompanish, përfshi Audi, BMW dhe Mercedes. "Here WeGo Maps" është e specializuar për krijimin e hartave dhe të dhënave gjeografike dhe njëri nga ofruesit kryesore të hartave dhe të dhënave gjeografike për shumicën e naviguesve të automjeteve në të gjithë botën. Kjo marrëveshje vjen si rezultat i krijimit të një regjistri digjital, të avancuar dhe të saktë të adresave nga Republika e Kosovës dhe pas një analize nga ana e Here WeGo Maps, e cila ka konstatuar se të dhënat e adresave janë të sakta dhe të avancuara. Të dhënat zyrtare të adresave të Republikës së Kosovës do të shfrytëzohen për të azhurnuar hartat e Republikës së Kosovës në platformën e "Here WeGo Maps". Me këtë marrëveshje Republika e Kosovës do të jetë njëra nga shtetet e para në Ballkan, harta e së cilës do të azhurnohet me të dhëna zyrtare, unike dhe të sakta të adresave në platformën "Here WeGo Maps". Gjithashtu marrëveshja është një hap më tutje në informimin rreth të dhënave zyrtare të adresave dhe mundëson që adresat të shfrytëzohen edhe më shumë.




Foto: Moment nga nënshkrimi i memorandumit me "Here We Go Maps"

7.7 MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE N.H. "IBËR LEPENCI"

Më qëllim të ofrimit të ndihmës teknike, praktikës këshillëdhënëse në fushën e gjeodezisë, kadastrit, pronës si dhe ofrimit të të dhënave gjeohapësinore nga ana e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Kryeshefi i AKK-së z. Avni Ahmeti ka mbajtur një takim me Kryeshefin e N.H "Ibër Lepenc" z. Berat Lushtaku, të cilët edhe nënshkruan një memorandum bashkëpunimi mes institucioneve që përfaqësojnë. Dispozitat e këtij memorandum janë në harmoni me kapacitetet profesionale dhe si i tillë i njëjti i rekomandon AKK dhe N.H "Ibër Lepenc" që në mënyrë të vullnetshme të zbatojnë këtë memorandum. Agjencia Kadastrale e Kosovës u zotua se i del në ndihmë në rrafshin profesional me të gjitha kapacitetet që i nevojiten N.H "Ibër Lepenc" në çështjet e pronës, gjeodezisë dhe kadastrit.



Foto: Moment nga nënshkrimi i memorandumit me N.H. "IBËR LEPENCI"

7.8 MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE DEPARTAMENTIT TË TATIMIT NË PRONË

Ky memorandum ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve nënshkruese, që ka të bëjë me ofrimin e të dhënave kadastrale për qëllim të tatimit në pronë. AKK do të sigurojë qasje për shikim dhe marrje të informatave në Regjistrin e të dhënave Kadastrale-SIKTK, pa pagesë për Departamentin e Tatimit në Pronë, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L221 Dhe Nr. 04/L-116, neni 16 i këtij ligji, përkatësisht nenit 32 të Ligjit bazik, i shtohet paragrafi 3, si citimi: "Pavarësisht nga paragrafi 1. i nenit 32 të ligjit bazik, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) do të ofrojë falas të gjitha të dhënat/informatat, në formatin elektronik dhe fizik, që kërkohen nga Ministria e Financave dhe çdo institucion tjetër shtetëror, që do të shfrytëzohen për tatimin në pronë, vlerësimin e pronës sipas zonave kadastrale dhe parcelave". Qasje të tillë do të ketë në të gjitha të dhënat kadastrale në formatin elektronik përmes ueb-shërbimeve, duke përfshirë shfrytëzimin e bazës elektronike të të dhënave tekstuale për tërë territorin e Kosovës që mbahen nga AKK-ja, me qëllim të zbatimit të marrëveshjes. Po ashtu, Dreitoria e Tatimit në Pronë zotohet se të dhënat e AKK-së do të përdoren vetëm për nevojat e cekura në Memorandum.

7.9 MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË MES AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS DHE AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

Me qëllim të ngritjes së shkallës së bashkëpunimit mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Kryeshefi ekzekutiv i AKK z. Avni Ahmeti ka nënshkruar Memorandum për Bashkëpunim mes AKK dhe AKKVP konform dispozitave ligjore e me theks të veçantë mbi ofrimin e qasjes së shpejtë dhe pa pagesë për AKKVP në regjistrat pronësor të cilat i administron AKK-ja, kjo për nevojat e krahasimit të pronave dhe ndryshimet eventuale që mund të afektohen nga kthimi i dokumenteve pronësore të cilat regjimi Serb i kishte marrë gjatë tërheqjes nga Kosova. Nga ana tjetër, marrëveshja rregullon edhe obligimet e AKKVP-së me theks të veçantë përcjelljen e vendimeve përfundimtare mbi pronat në AKK, që të njëjtat të regjistrohen në sistemin e informacioneve Kadastrale për tokën në Kosovës.

8.ADMINISTRIM DHE PËRKRAHJE TEKONLOGJIKE

8.1 ADMINISTRIMI INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI)

Drejtorati i TI-së në Agjencinë Kadastrale të Kosovës monitoron dhe administron qendrën primare dhe sekondare të të dhënave. Gjithashtu bënë dokumentimin detal të shfrytëzimit të resurseve me fokus të veçantë në RAM, CPU dhe DISK. Duke u bazuar në kërkesat për kapacitete harduerike, planifikon zgjerimin e qendrës së të dhënave me resurse shtesë për vitin pasues. Në tabelën e mëposhtme është nxjerr shfrytëzimi i resurseve harduerike (CPU, RAM dhe DISK) nga sistemet kadastrale dhe sistemet tjera ndihmëse në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

	2018			2019			Ndryshimi		
	vCPU	RAM\GB	DISK\GB	vCPU	RAM\GB	DISK\GB	vCPU	RAM\GB	DISK\GB
File Server	12	10,240	35,703,359	12	10,240	38,848,662	0	0	3,145,303
KOPOS	16	16,384	887,084	16	16,384	887,084	0	0	0
ARIS	16	73,728	5,951,697	16	73,728	5,982,010	0	0	30,313
Intranet	24	81,920	2,098,009	24	81,920	2,098,009	0	0	0
SIKTK-SOA	113	219,136	3,005,232	121	235,520	3,046,229	8	16,384	40,997
SIKTK-HK	44	139,264	1,154,825	44	139,264	1,696,529	0	0	541,704
Gjeoportali	26	86,016	4,633,844	80	155,648	7,490,782	54	69,632	2,856,938
WebSite	2	12,288	94,384	2	12,288	135,287	0	0	40,903
Sistemet e reja				51	135,168	2,486,059	51	135,168	2,486,059
Sistemet tjera	277	638084	22544411	259	616652	23872354	-18	-21,432	1,327,943
TOTAL	530	1,277,060	76,072,845	625	1,476,812	86,543,005	95	199,752	10,470,160

Në këtë tabelë është bërë krahasimi i shfrytëzimit të resurseve nga të gjitha sistemet \ serverët nga fundi i vitit 2018 deri në nëntor të vitit 2019. Në pjesën me të verdhë janë paraqitura ndryshimet (rritja apo zvogëlimi i resurseve) në mes vitit 2018 dhe 2019. Në tabelën kategorizimi i sistemeve është bërë vetëm për sistemet që janë në ambient real, ndërsa ambientet testuese janë nën kategorinë "Sisteme tjera". Nga analizimi i këtyre të dhënave del që rritje më të madhe në shfrytëzimin e diskut ka pas File Serveri, Gjeoportali dhe zhvillimi i sistemeve të reja që kanë ndodhë gjatë vitit 2019, ndërsa rritje të RAM-it kanë pas sistemet e reja, Geoportali dhe SIKTK-SOA, rritje në CPU (Processor) ka pas Geoportali dhe sistemet e reja. Në total deri në fund të vitit 2018 janë shfrytëzuar 530 virtual processor, 1277GB RAM memorie dhe rreth 76 TB të dhëna, ndërsa në vitin 2019 janë shfrytëzuar 625 virtual processor, 1476GB RAM memorie dhe rreth 86.5 TB të dhëna. Nga këto të dhëna del që kem rritje të shfrytëzimit të CPU për 95 vCPU, RAM për 199 GB dhe rritje të shfrytëzimit të diskut për rreth 10.5 TB. Kjo rritje vjen si pasojë e nevojës për ngritje të performancës të sistemeve Gjeoportali, SIKTK-SOA, Harta Kadastrale e po ashtu edhe nga zhvillimi i sistemeve të reja siç janë UCWSS, Sistemi për RIK dhe krijimi i ambienteve testuese për Gjeoportali, ARIS dhe Harta Kadastrale.

8.2 PËRKRAHJA E PËRDORUESVE TË SISTEMEVE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (SI/TI)

Agjencia Kadastrale e Kosovës përmes Drejtorisë për Teknologji të Informacionit gjatë tërë vitit ka ofruar përkrahje të vazhdueshme të gjithë përdoruesve të sistemeve dhe teknologjisë së informacioneve, të regjistruar në domenin kompjuterik qendror të AKK-së (Active Directory), ndërsa janë tri kategori të përdoruesve/llogarive të cilëve u është ofruar mbështetje konstante:

- Përdorues në AKK,
- Përdorues në ZKK dhe
- Përdorues të jashtëm.

Në nëntor të viti 2019 figurojnë të regjistruar në domenin kompjuterik të AKK-së (Active Directory) gjithsejtë 642 përdorues aktiv, prej tyre 115 përdorues/llogari të AKK, 510 të ZKK dhe 17 përdorues të tjerë.

Përkrahja e përdoruesve të SI/TI në ZKK

Gjatë vitit 2019 ZKK-të janë përkrahë në mënyrë të vazhdueshme nga ana e AKK-së duke përfshirë krijimin dhe deaktivizimin e shfrytëzuesve të ZKK-ve në Active Directory në OU të caktuara, formatimin e kompjuterëve dhe instalimin e drajverave dhe të gjitha programeve të nevojshme, regjistrimi dhe reregjistrimi në domain IPRR.KS, në Active Directory, ndërrimi dhe konfigurim i IP adresave në rast konflikti në mes kompjuterëve, etj. Në tabelën e mëposhtme është dhënë numri i përkrahjeve TI në total sipas ZKK-ve.

	ZKK	Përkrahjet TI		ZKK	Përkrahjet TI
1	DEÇAN	11	21	SKËNDERAJ	10
2	GJAKOVË	29	22	SHTIME	11
3	GLLOGOC	8	23	SHTËRPCE	7
4	GJILAN	17	24	SUHAREKË	7
5	DRAGASH	10	25	FERIZAJ	15
6	ISTOG	7	26	VITI	10
7	KAÇANIK	8	27	VUSHTERRI	13
8	KLINË	16	28	ZUBIN POTOK	0
9	FUSHË KOSOVË	7	29	ZVEÇAN	0
10	KAMENICË	9	30	MALISHEVË	12
11	MITROVICË	17	31	JUNIK	6
12	LEPOSAVIQ	0	32	MAMUSHË	7
13	LIPJAN	13	33	HANI I ELEZIT	7
14	NOVOBËRDË	8	34	GRAÇANICË	13
15	OBILIQ	11	35	RANILLUG	6
16	RAHOVEC	10	36	PARTESHË	5
17	PEJË	25	37	KLLOKOT	10
18	PODUJEVË	16	38	MITROVICË VERIORE	7
19	PRISHTINË	26	Totali 410		
20	PRIZREN	16			

8.3 RIMËBËKMBJA E TI-SË NË RAST FATKEQËSIE

Agjencia Kadastrale e Kosovës me qëllim ofrimin e shërbimeve kadastrale pa ndërprerje, minimizimin e humbjes së të dhënave në rast katastrofave qoftë natyrore, njerëzore apo edhe teknologjike, ka të implementuar qendrën e dytë/sekondare të të dhënave (qendrën e të dhënave në rast fatkeqësie, ang. DRC). Replikimi i të dhënave në mes qendrës primare me qendrën sekondare bazohet në teknologjinë e VMware, respektivisht VMware Site Recovery Manager së bashku me vSphere Replication (shih fig. 1). Site Recovery Manager ofron vazhdimësi të shërbimeve biznesore dhe rimëkëmbje të shërbimeve në rast fatkeqësie, po ashtu ndihmon të planifikohen, testohen dhe rikuperohen serverët virtual. Site Recovery Manager, menaxhon, replikon si dhe automatizon migrimin e serverëve virtual nga një vCenter Server në tjetrin.


Drejtorati i TI-së ka krijuar dokumentin “Procedurat për Rimëkëmbjen e TI-së në Rast Fatkeqësie”. Ky dokument përshkruan procedurat që duhet të ndjekin Administratorët e TI-së së AKK-së për rimëkëmbjen e sistemeve teknologjike në rast fatkeqësive. Përshkruan hapat që duhet ndjekur për testimin e një Plani të rimëkëmbjes, migrimin e planifikuar të serverëve virtual në qendrën sekondare (DRC) si dhe rimëkëmbjen e të gjitha sistemeve kritike nga qendra sekondare në rast të dështimit të qendrës primare. Plan i rimëkëmbjes në rast fatkeqësie (Disaster Recovery Plan/DRC) është një varg i “veprimeve që duhet të ndërmerren para, gjatë dhe pasi të ndodh një fatkeqësi”. Plani DRC krijohet për të ndihmuar dhe mbrojtur bizneset/organizatat në raste të tilla. Një plan i tillë krijohet për të minimizuar dëmet potenciale, rimëkëmbjen e shpejtë të shërbimeve si dhe, më kryesorja, parandalimin e fatkeqësive.

Duke pasur një plan të tillë sjell përfitime si:

- Minimizon kohën e rikuperimit të shërbimeve,
- Shmang vonesat e mundshme,
- Shmang gabimet e mundshme që mund të ndodhin gjatë vendimmarrjes së shpejt,
- Përcakton ekipin përgjegjës për rimëkëmbje etj.

Dokumenti “Procedurat për Rimëkëmbjen e TI-së në Rast Fatkeqësie”, shërben si udhëzues për stafin përgjegjës me njohuri në teknologjinë e virtualizimit, për të vepruar sipas skenarëve të përshkruara në dokument.

Dy herë në vit, DTI bënë testimin e funksionimit të Qendrës DRC si dhe bënë rishikimin dhe azhurnimin, në rast nevojë, të dokumentit “Procedurat për Rimëkëmbjen e TI-së në Rast Fatkeqësie”.



9.SHËRBIMET DHE OFRIMI I TË DHËNAVE

9.1 SHËRBIME JURIDIKE

Trajtimi i çështjeve të parashtruara nga palët në formë të kërkesës apo ankesës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, bëhet sipas parimit i pari nga koha i pari nga e drejta. Trajtimi i kërkesave bëhet sipas kohës së parashtrimit të tyre si dhe brenda afatit ligjor të parapar me ligjet në fuqi. Krahasuar me vitet e kaluara kemi një vetëdijesim më të madhë të palëve për të shfrytëzuar të drejtat e tyre përmes rrugës ligjore duke ushtruar ankesa në organet e shkallës së dytë ndaj vendimeve të organit të shkallës së parë që kanë të bëjnë me çështjet pronësore dhe kadastrale. Po ashtu kemi një rritje më të madhe edhe të kërkesave nga Zyrat Kadastrale Komunale për dhënenin e interpretimeve ligjore dhe rekomandimeve. Bazuar në kërkesat dhe ankesat e ushtruara nga palët është bërë identifikimi i problemeve me të cilat ballafaqohen pronarët në realizimin e të drejtave pronësore e të cilat trajtohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe për të njëjtat ofrohen zgjidhje ligjore në koordinim me Institucionet kompetente brenda mundësive ligjore. Gjatë ushtrimit të përgjegjësi si organ i shkallës së dytë janë identifikuar llojet e lëndëve (kërkesa, ankesa, mendime profesionale) me të cilat ballafaqohen palët gjatë realizimit të të drejtave:

- Kontrata të vërtetuara në Gjykatën jokompetente;
- Regjistrim i të drejtave pronësore në emër të të vdekurve;
- Akte juridike të lëshuara dhe të vërtetuara në Beograd;
- Korrigjim i të dhënave për pronar në regjistrin e të dhënave pronësore;
- Mospërputhje të aktit juridik me gjendjen e fundit kadastrale;
- Mospërputhje e pjesës tekstuale me atë grafike;
- Sqarime për regjistrim të pronës së paluajtshme;
- Ndërrim i të drejtave nga pronari në shfrytëzues;
- Ndërrimi i destinimit të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme;
- Regjistrimi i hipotekës dhe fshirja e saj;
- Marrëveshjet e Ndërmjetësimit;
- Krijimi i bashkëpronësisë;
- Autorizime jo valid;
- Mungesa e Aktit burimor;
- Mungesa e transaksionit bankar;
- Lëndë në procedurë gjyqësore;
- Prapësim të procedurës;
- Trajtimi i lëndëve të uzurpimit;
- Ankesa ndaj vendimeve të sektorit pronësor juridik
- Regjistrim të të drejtave pronësore për shtetas të huaj;
- të tjera.

Më shqetësues është fakti i pamundësisë së zyrtarizimit të akteve të vlefshme juridike si pasojë e mospërputhshmërisë së të dhënave në mes të aktit juridik dhe të dhënave në regjistrin e të dhënave kadastrale. Kjo gjendje vjen si pasojë e mos vetëdijesimit të palëve se e drejta e pronësisë fitohet nga momenti i zyrtarizimit të dokumentit të vlefshëm juridik në Regjistrin e të dhënave kadastrale. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre akteve juridike janë ruajtur nëpër sirtarë të palëve dhe nuk janë dorëzuar për zyrtarizim në Regjistrin e të dhënave kadastrale dhe si pasojë e kësaj ka ardhë deri te ndryshimi i të dhënave kadastrale për pronar ose për njësi kadastrale dhe si pasojë

e kësaj është pamundësuar zyrtarizimi i tyre. Në tabelën në vijim janë paraqitur të përblëdhura statistikat rreth shërbimeve juridike të ofruara nga AKK.


ANKESA SI SHKALLË E DYTË	SEANCA GJYQESORE	MENDIME PROFESIONALE	KERKESA SI SHKALLË E PARË	PERGJIGJE NË PADI	VLERESIM I LIGJSHMËRISE	TOTAL
477	67	39	78	82	25	768

9.2 SHËRBIMET E OFRUARA PËR QYTETARËT NGA ZYRAT KADASTRALE KOMUNALE DHE AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS


Agjencia Kadastrale e Kosovës menaxhon dhe mirëmban regjistrin mbi të drejtat e pronës së paluajtshme. Përmes Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokave në Kosovë-SIKTK, nga ZKK-të dhe AKK gjatë vitit 2019 janë aprovuar gjithsejtë 59,136 lëndë dhe janë lëshuar 136,211 certifikata, prej të cilave 6656 janë certifikata/vërtetim për mosposedim të pronës.

Disa nga këto statistika janë të paraqitura në vazhdim.


Në vitin 2019 nga SIKTK për gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë lëshuar gjithsej 129,555 Certifikata të pronësisë, ku prinë Prishtina me 15,317 certifikata të pronësisë të lëshuara, ndërsa e fundit është Zveçani me 71 certifikata të pronësisë të lëshuara.




Në nivel Republike janë aprovuar gjithsejtë 18,186 shitblerje, ku numri më i madh i tyre ka qenë në Prishtinë me 2548.



Gjithashtu Prishtina prinë edhe me hipoteka të aprovuara gjithsejtë 793 kundrejt numrit të përgjithshëm prej 3559 hipoteka. Intensiteti i kërkesave për regjistrim të hipotekave ka qenë më i madh gjatë muajit Mars, muaj në të cilin janë regjistruar 412 hipoteka, ndërsa numri më i vogël është gjatë muajit Janar me 248 hipoteka të regjistruara.



Gjatë vitit 2019 nga SIKTK për gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë krijuar gjithsej 2064 lëndë për bashkim të parcelave, ku prinë Peja me 196 lëndë. Intensiteti i kërkesave është më i madh gjatë muajit Tetor, muaj në të cilin janë aprovuar 251 kërkesa për bashkim të parcelave, ndërsa numri më i vogël ka qenë gjatë muajit Qershor me 113 aprovime për bashkim të parcelave. Lloj tjetër i lëndës i regjistruar në SIKTK gjatë vitit 2019 është edhe lënda për ndarjen e parcelave kadastrale. Gjatë vitit 2019 nga SIKTK për gjithë territorin e Republikës së Kosovës janë krijuar gjithsej 8087 lëndë për ndarje të parcelave, ku prinë Ferizaj me 879 lëndë. Intensiteti i kërkesave është më i madh gjatë muajit Gusht, muaj në të cilin janë aprovuar 838 kërkesa për ndarje të parcelave, ndërsa numri më i vogël është gjatë muajit Qershor me 439 aprovime për ndarje të parcelave.



9.3 SHËRBIMET E OFRUARA PËR INSTITUCIONET NGA AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

Institucione të ndryshme në Republikën e Kosovës për realizimin e detyrave dhe objektivave të tyre kanë nevojë për të dhënat kadastrale. Këto të dhëna kadastrale varësisht nga lloji i kërkesës përgatiten nga drejtorati i Kadastrit, Teknologjisë së Informacionit apo sektorë tjerë brenda AKK-së.

Gjatë 2019 janë parashtruar kërkesat nga institucionet e listuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Institucioni	Nr. i kërkesave
1	Administrata Tatimore e Kosovës	753
2	Policia e Kosovës	133
3	Njësia e Inteligjencës Financiare	50
4	Përmbarues privat	31
5	Departamenti i Shpronësimit – MMPH	31
6	Ambasadat	24
7	Departamenti i Ujërave - MMPH	24
8	Agjencia Kosovare e Privatizimit	20
9	Agjencia Kundër Korrupsion	18
10	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	17
11	Lëndë të azhurnimeve në komuna	10
12	Certifikata që nuk posedon pronë	10
13	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	6
14	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë	6
15	Gjykata Themelore Mitrovicë	3
16	Gjykata Themelore Prishtinë	3
17	Prokuroria Themelore Prishtinë	3
18	Këshilli Prokurorial i Kosovës	2
19	Prokuroria Speciale	2
20	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar	1
21	Agjencia Pyjore e Kosovës	1
22	Dogana e Kosovës	1
23	Feronikeli	1
24	Hekurudhat e Kosovës	1
25	Prokuroria Themelore Gjakovë	1
26	Prokuroria Themelore Pejë	1
27	Radio Televizioni i Prishtinës	1
28	Unioni Evropian	1
29	Ministria e Drejtësisë	1
30	Ministria e Infrastrukturës	1
31	Agjencia për Barazi Gjinore	1
32	Instituti për Vlerësime dhe Studime Pronësore (IVSP)	1
33	Banka Procredit	1

Agjencia Kadastrale e Kosovës me të dhënat që disponon por edhe përmes ekspertëve dhe burimeve njerëzore që posedon tenton të jetë përkrah institucioneve që kanë

nevojë për ekspertizën tonë. Vlen të ceket se që nga data 10.03.2017 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka marr përsipër që të bëj kontrollin e kualitetit në aspektin teknik për elaboratet e shpronësimit. Gjatë fillim vitit 2019 përkatësisht prej datës 21.01.2019 deri më 19.07.2019 AKK ka përkrahur Departamentin e Shpronësimit pranë MMPH-së me një ekspert kadastral, duke lehtësuar në masë punën e këtij departamenti. Gjithashtu si organ i shkallës së dytë AKK pranon kërkesa dhe ankesa nga persona fizik dhe juridik të cilët pretendojnë që ZKK-të kanë vendosur jo në mënyrë të duhur për lëndët e tyre apo janë të pakënaqur me shërbimet dhe përgjigjet që u janë ofruar. Gjatë vitit 2019 kemi pranuar gjithsejtë 190 kërkesa që kanë pasur të bëjnë edhe me aspektin grafik edhe me atë tekstual të të dhënave kadastrale.

9.4 SHËRBIMET NGA POZICIONIMI SATELITOR I KOSOVËS - KOPOS

Rrjeti permanent i pozicionimit në Republikën e Kosovës (KOPOS), mbulon tërë territorin e vendit në përcaktimin e pozitës me një saktësi centimetrike në rrafshin horizontal dhe vertikal bazuar në sistemin zyrtar referent KosovaRef01. Që nga funksionalizimi i këtij shërbimi deri më tani kemi të regjistruar 190 përdorues. Përdoruesit e regjistruar deri më tani janë të profileve dhe fushave të ndryshme, duke filluar nga personat fizik e deri te institucionet qeveritare. Vetëm në vitin 2019 janë regjistruar 10 përdorues të ri të shërbimeve të KOPOS-it. Llojet të shfrytëzuesve janë paraqitur në tabelën në vijim:

Lloji shfrytëzuesit	Numri i shfrytëzuesve
Persona fizik	67
Kompani private	77
Institucione Komunale	29
Ndërmarrje Publike	15
Institucione Qeveritare	2

Përdorimi mesatar ditor i shërbimeve të KOPOS-it është 90 orë, mesatarisht 3300 orë për një muaj dhe numrit mesatar i përdoruesve ditor është mbi 90. Brendet kryesore të cilat përdoren në Kosovë, apo që shfrytëzojnë rrjetën permanente KOPOS, si dhe numri i shfrytëzuesve sipas statusit janë të paraqitura në diagramin e mëposhtëm. nga i cili shihet që prinë "Leica", pas tyre "Topcon" etj. Në tabelën e mëposhtme janë disa statistika të shfrytëzimit të KOPOS-it gjatë vitit 2019. Ashtu si edhe viteve të mëparshme, aktivitetet më të mëdha të matjeve nga KOPOS-i janë zhvilluar në Komunën e Prishtinës.

Statistika nga përdorimi i KOPOS-it në vitin 2019			
Viti 2019	Kyqje të autorizuara	Koha totale e kyqjeve (orë)	Koha mesatare e kyqjeve (min)
Janar	3,487	692.25	11.9
Shkurt	12,213	2,322.39	11.4
Mars	19,632	4,482.94	13.7
Prill	17,922	4,110.33	13.8
Maj	16,741	4,012.62	14.4
Qershor	13,252	3,071.99	13.9
Korrik	15,632	3,848.29	14.8
Gusht	18,662	4,531.79	14.6

Shator	16,707	3,717.05	13.3
Tetor	23,596	4,484.12	11.4
Nëntor	15,900	3,260.41	12.3
Dhjetor	9,503	1,951.34	12.3
Gjithësej	183247	40485.52	13.5

9.5 SHËRBIMET NGA GJEOPORTALI SHTETËROR

Agjencia Kadastrale e Kosovës është koordinatore e Infrastrukturës së të dhënave hapësinore në Republikën e Kosovës, rrjedhimisht është edhe administratore e Gjeoportalit Shtetëror, ueb aplikacion ky për grumbullimin dhe prezantimin e të dhënave gjeohapësinore nga të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës. Geoportali Shtetërorë është i qasshëm për publikun në linkun geoportal.rks-gov.net. Gjatë vitit 2019 është vizituar nga 300.000 vizitorë unik, me mbi 1.500.000 vizita. Përveç AKK-së si ofrues më i madh i të dhënave përmes Gjeoportalit Shtetërorë, ka pasur një rritje të numrit të institucioneve tjera që ofrojnë të dhëna për shikim si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, Kompania publike "Termokos" etj. Në gjeoportal aktualisht janë 70 shtresa me të dhëna, prej të cilave gjatë vitit 2019 janë publikuar 13 shtresat si në vijim:

Nr.	Emri i shtresës	Institucioni përgjegjës
1.	Ortofoto2018Rural	Agjencia Kadastrale e Kosovës
2.	Ortofoto2018Urban	
3.	Minierat aktive	Shërbimi Gjeologjik i Kosovës
4.	Minierat joaktive	
5.	Vendburimet dhe shfaqjet e mineralizimeve	
6.	Autostradë	Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
7.	Rrugë Nacionale	
8.	Rrugë Rajonale	
9.	Perimetri i asetit	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë
10.	Zona e mbrojtur e asetit	
11.	Gypi furnizues	Kompania publike Termokos
12.	Gypi kthyes	
13.	Pusetat	

9.6 LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE

Një prej obligimeve dhe përgjegjësi ligjore të Agjencisë Kadastrale e Kosovës bazuar në Ligjin Nr. 04/-L-013 për Kadastër është edhe licencimi i gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara. Gjatë vitit 2019 në Republikën e Kosovës janë licencuar për veprimtari profesionale gjithsej 118 gjeodetë dhe 36 kompani gjeodete. Gjatë vitit 2019 janë licencuar për herë të parë gjithsej 9 gjeodetë të cilët kanë plotësuar kushtet për licencim dhe 3 kompani gjeodete. Në vitin raportues janë vazhduar licencat edhe

për 22 gjeodetë paraprakisht të licencuar dhe 13 kompani gjeodete të licencuara.

9.7 TRAJTIMI I OBJEKTEVE PA LEJE

Trajtimi i ndërtimeve pa leje. Ekspertët nga Drejtoria e Kadastrit në AKK, kanë qenë të përfshirë direkt si pjesë e grupit punues në ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe udhëzimet administrative që derivojnë nga ky ligj. Gjithashtu ekspertë nga Drejtoria e Kadastrit, kanë qenë pjesë e grupit punues edhe në hartimin e Udhëzuesit për Legalizim, ku është specifikuar qartësisht edhe pjesa e Gjeodezisë dhe Kadastrit me një shtojcë të veçantë, duke standardizuar matjet, formatin e punës, elaboratin për dorëzim në drejtori të Urbanizimit dhe Kadastrit etj. Kjo shtojcë dhe ky udhëzues ka ndihmuar në masë të madhe palët e interesit në trajtimin e ndërtimeve pa leje.

9.8 SHËRBIMET E OFRUARA PËRMES PLATFORMËS SË INTEROPERABILITETIT / GOVERNEMENT GATEWAY (PI/GG)

Platforma e interoperabilitetit/government gateway është një pjesë kyçe e strategjisë, me të cilën qeveria synon të krijojë lehtësi komunikimi midis departamenteve publike dhe qeveritare, duke përdorur një platformë të vetme. Kjo platformë mundëson integrimin e të gjitha ueb shërbimeve të të gjitha sistemeve të informacionit në institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe ndihmon në qasjen dhe sigurinë e këtyre ueb shërbimeve. Duhet potencuar se Agjencia Kadastrale e Kosovës nuk është implementuese e projektit "Government Gateway (GG)", por është pjesë e projektit dhe gjithashtu e shfrytëzon atë për arsye të shkëmbimit dhe ofrimit të të dhënave me institucionet dhe qytetarët e Kosovës. Linku i platformës për realë është <https://e-kosova.rks-gov.net>, ndërsa në të njëjtën deri më tani Agjencia Kadastrale e Kosovës ka integruar 4 ueb shërbime kadastrale, dhe ato janë:

- Get Cadstrale Object By Cadastral Number
- Kërkimi bëhet sipas njësisë kadastrale
- Get Cadstral Objects With All Details And Rights
- Kërkimi për njësi kadastrale sipas numrit të plotë kadastral
- Get All Cadastral Objects By Personal Number
- Kërkimi për të dhënat e personit dhe njësive që posedon në tërë Kosovën
- Get All Cadastral Objects With All Details And Rights
- Kërkimi i të dhënave për tatimin në prone. Te ky ueb shërbime kërkimi bëhet sipas IDs se komunës ose IDs se zonës kadastrale.
- Për Tatimin në Pronë e kemi krijuar edhe ueb shërbimin "Get All Cadastral Objects With All Details And Rights".

9.9 ZHVILLIMI I SISTEMIT TË UNIFIKUAR TË UEB SHËRBIMEVE KADASTRALE (SUUSHK)

Sistemi SUUSHK është i zhvilluar në platformën ASP.NET, MVC6, MS SQL 2016 e përgjigjen e kthen në formatin json. Sistemi SUUSHK që nga data 14.05.2019 ka qenë i gatshëm për shfrytëzim. Gjatë periudhës tre mujore të mirëmbajtjes ka lindë nevoja e zhvillimit të GUI shërbimeve për institucionet që nuk kanë sistem të zhvilluar për konsumim të ueb shërbimeve kadastrale. Në periudhën nga 01.08.2019 deri 25.08.2019 është bërë testimi i modulit të faturimit që është i zhvilluar në kuadër të SUUSHK. Testimet janë kryer nga grupi punues për SUUSHK si dhe nga zyrtari i financave për pagesa. Raporti që gjenerohet nga ky model është quajtur 'Raporti i konsumatorit për

pagesë'. Në këtë raport ruhen të gjitha kërkesat që janë bërë nga institucionet tjera në mënyrë detale, pastaj ky raport dorëzohet tek institucioni për të kryer pagesën për të dhënat që i ka konsumuar. AKK ka përgatitur edhe një dokument 'Memorandum Bashkëpunimi mes AKK dhe institucionit kërkuës'. Në memorandum përcaktohen përgjegjësitë e AKK, përgjegjësitë e ASHI, përgjegjësitë e institucioneve kërkuese si dhe detaje të tjera që kanë të bëjnë me konsumim të të dhënave. Institucionet që kanë qasje në ueb shërbimin tonë përmes GG nuk mund të konsumojnë shërbimet tona pa u bërë edhe një kontroll i nivelit të qasjes tek ne në sistemin SUUSHK. Deri më tani janë paraqitë disa institucione që kanë interes për të konsumuar shërbimet kadastrale si Drejtoria e Tatimit në pronë, Ministria e Punës e Mirëqenies Sociale, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra e kryeprokurorit.




Foto: Skema e sistemit të ndërlidhjes së SUUSHK me shfrytëzuesit

10.BUXHET DHE FINANCA

10.1 BUXHETI

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019 është aprovuar me 14.02.2019 përmes Ligjit të buxhetit Nr.06/L-133. Financimi i AKK-së për vitin 2019 ka qenë financim nga Granti i Qeverisë në vlerë prej 2 819 540.01€ i kategorizuar në katër kategori si: Paga dhe mëditje në vlerë prej 380 190.01€, mallra dhe shërbime në vlerë prej 110 000.00€, shërbime komunale në vlerë 950.00€ dhe pasuri jofinanciare 2 320 000.00€.

Krahasuar me vitet paraprake ky ka qenë buxheti më i madh i ndarë ndonjëherë për Agjencinë Kadastrale të Kosovës që nga themelimi i saj.

Desntimi	Buxheti i planifikuar	Buxheti i aprovuar	Buxheti i rirregulluar
Totali	2,990,459.30	2,819,510.01	2,819,540.01
Paga	392,959.30	380,190.01	380,190.01
Mallra e shërbime	110,000.00	110,000.00	268,000.00
Shërbime komunale	5,500.00	9,350.00	9,350.00
Kapitalet	2,482,000.00	2,320,000.00	2,162,000.00

Pasqyra e buxhetit, ndarja fillestare sipas kategorive

Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave me datë 15.11.2018 ka nënshkruar marrëveshjen Financiare me Bankën Botërore për projektin për regjistrimin e pronës dhe infrastrukturës gjeohapësinore (REGIP), ID P164555. Ky projekt do të implementohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës ndërsa vlera e mjeteve për financim është 500.000€, për të filluar me aktivitete përgatitore deri në aprovimin e projektit nga Parlamenti i Kosovës. Buxheti i Kosovës ka ndarë 388.000€ për fillimin e projektit i kategorizuar te "Projekti i kadastrit të patundshmërive dhe infrastruktura gjeohapësinore".

REALIZIMI I BUXHETIT

Në vitin 2019 AKK ka shpenzuar 2 513 627.68€ në total, apo rreth 98 % të ndarjes finale të buxhetit.

Desntimi	Buxheti	Alokimi	Shpenzimi	Shpenzimi/ Buxheti %
Totali	2,990,459.30	2,565,563.49	2,513,627.68	98
Paga	368,600.49	368,600.49	368,600.49	97
Mallra e shërbime	234,000.00	234,000.00	229,118.05	98
Shërbime komunale	9,350.00	9,350.00	3,310.34	35
Kapitalet	1,953,613.00	1,953,613.00	1,912,598.80	97

Ndarja finale e buxhetit dhe shpenzimi i buxhetit sipas kategorive

Numri i lëndëve të realizuara- pagesave të ekzekutuara në total është 480 prej të cilave Mallra dhe shërbime 442 lëndë dhe kapitale 38 lëndë, ndërsa për pjesën retroaktive 71 lëndë.

10.2 TË HYRAT

AKK përmes sektorit të produkteve realizon të hyra për buxhetin e Republikës së Kosovës. Planifikimi i të hyrave për vitin 2019 ka qenë në vlerën prej 70,000.00. Të hyrat e grumbulluara u përkasin dy kategorive, respektivisht licenca për kompani dhe gjeodet me shumën e inkasuar prej 10,200.00 euro dhe shitja e produkteve me shumën e inkasuar prej 111,267.00, që në total e arrijnë vlerën prej 121,467.00. Të hyrat e inkasuara derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga AKK.

10.3 PROKURIMI

AKK ka dorëzuar raportin vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike për aktivitetet e prokurimit publik të AKK-së për vitin fiskal 2019 në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në AKK, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë vitit 2019. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal 2018 ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) Planifikimin Final të Prokurimit, duke u bazuar në kërkesat e njësive kërkuese (departamentet tjera) të aprovuara nga personat përgjegjës për buxhet dhe Drejtorit Ekzekutiv (KE). Planifikimi i prokurimit ka qenë konform buxhetit të AKK-së për vitin fiskal në fjalë. Agjencia Kadastrale e Kosovës bazuar në planifikimin final të prokurimit për vitin fiskal 2019 ka realizuar 11 aktivitete të prokurimit. Secili proces i prokurimit në AKK është administruar përmes këtyre hapave: planifikimi i prokurimit, parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës, përcaktimi i procedurës së prokurimit, përgatitja e dosjes së tenderit, publikimi, hapja dhe vlerësimi i tenderëve, dhënia dhe nënshkrimi i kontratës, menaxhimi i kontratës. Duke u bazuar në Ligjin e prokurimit publik të Kosovës, AKK ka paraqitur të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale. Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të realizuara gjatë vitit 2019 në AKK.

Nr. ren	Përshkrimi i kontratës Mallra dhe shërbime
1.	Mirëmbajtje e sistemit TI (Aklimatizim dhe UPS, në dhomën e serverëve)
2.	Mirëmbajtje të pajisjeve (kamerave montuese) në AKK
3.	Shtypja dhe përkthimi i Raportit Vjetor të vitit 2019 dhe Planit të Punës për Vitin 2020
Nr. ren	Përshkrimi i kontratës Kapitalet
1.	Migrimi i të dhënave në SIKTK-HK
2.	Skanimi i dokumenteve arkivore për Zyrat Kadastrale Komunale Projekt 2 vjeçar
3.	Mirëmbajtja e Sistemeve të Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës (SIKTK) Projekt 3 vjeçar
4.	Instrument i ri gjeodezik "Total Station
5.	Ndarja në hapësira më të vogla të zyrës së GIS-it
6.	Matje relative gravimetrike (Rrjeti Shtetëror Gravimetrik në Republikën e Kosovës) Projekt 2 vjeçar

8.	Krijimi i modelit digjital të terrenit (DTM), modelit digjital të sipërfaqes (DSM), objektet 3D dhe vektorizimi i objekteve
10.	Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW+SW)

10.4 AUDITIMI

Gjatë vitit 2019, Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA) ka kryer auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2018. Auditimi është fokusuar në pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak. AKK ka të ndarë sistemin e pagesave dhe çdo vit përgatit pasqyrat financiare, të cilat konsolidohen në Pasqyrën financiare të MMPH-së. Raporti i ZKA është përgatitur për MMPH duke e përfshirë edhe AKK-në si njësi buxhetore në kuadër të buxhetit të MMPH-së. Sipas vlerësimeve të auditorit, pasqyrat financiare vjetore për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Nga të gjeturat e ZKA ku përfshihet edhe AKK është mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë për zyrtarët e angazhuar sipas marrëveshjes së Brukselit. Qeveria e Republikës së Kosovës, me datën 22.07.2015, ka nxjerr vendimin me nr.06/39, në bazë të të cilit obligohen ministritë dhe agjencitë për integrimin e ish pjesëtarëve të "Mbrojtjes Civile". Për arsye politike këta punëtorë nuk janë të sistemuar dhe si pasojë nuk kemi evidenca për vijueshmërinë e tyre në punë. MMPH në bashkëpunim me AKK-në ka përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve që dalin nga ZKA. Njësia e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2019 ka realizuar auditime, ku objekt auditimi kanë qenë sektorët e Drejtorisë për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (personeli, buxheti, logjistika).

11. PJESËMARRJE NË KONFERENCA, PUNËTORI DHE VIZITA STUDIMORE

AKK i kushton rëndësi të veçantë edhe ngritjes profesionale të zyrtarëve të saj, ndërsa disa prej aktiviteteve përmes të cilave ia arrin që të përcjellë trendet zhvillimore në fushën e administrimit të tokës, kadastrës, gjeodezisë, teknologjisë së informacionit është përmes pjesëmarrjes në konferenca, punëtori, tryeza të ndryshme diskutimi e ngjashëm. Në vijim janë të përmendura disa nga këto aktivitete:

“CISCO CONNECT”

Tre administratorët e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit kanë marrë pjesë në konferencën vjetore “CISCO CONNECT” të organizuar nga prodhuesi CISCO. Kjo konferencë ishte një nga konferencat më të rëndësishme të TI-së në regjion, që bashkon ekspertë relevantë në industrinë e TI-së. Tema e kësaj konference ishte “Vizioni Global, Njohuria Lokale” ku u prezantuan teknologjitë e fundit digjitale të CISCO-s dhe trendet multidisiplinare.



“OPEN DATA”

Dy përfaqësues nga AKK, një nga Drejtoria e TI-së dhe një nga Zyra e Informimit, participuan në punëtorinë “Hapja e të Dhënave në Kosovë për Qeverisje të Hapur dhe Transparente” e organizuar nga Open Data Kosovo. Punëtorja kishte për fokus aktivitetet në institucionet publike rreth rëndësisë së hapjes së të dhënave dhe përfitimi nga ato të dhëna.

“HITACHI CUSTOMER EVENT”

Kompania VIRTUO në Prishtinë, ka organizuar konferencën profesionale me emër “Hitachi Customer Event” ku janë prezantuar produktet e fundit, HCP dhe Pentaho, nga prodhuesi Hitachi. Këto dhe produktet tjera që ky prodhues ofron janë zgjidhje e unifikuar për qendra e të dhënave të madhësive të ndryshme. Në këtë konferencë nga AKK prezent ishin tre administratorët e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

“VERTIV BALKAN TOUR”

Dy ekspertë nga Drejtoria e TI-së, sektori i administrimit të infrastrukturës së TI-së, kanë marrë pjesë në konferencën “Vertiv Balkan Tour” të organizuar nga PROMP në Prishtinë. Në këtë konferencë u prezantuan produktet e fundit të aklimatizimit dhe UPS për qendrat e të dhënave nga prodhuesi Vertiv.

MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI

Ekspertë të AKK-së morën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga OSCE ku u diskutua për progresin dhe sfidat në zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi. Që nga miratimi i këtij ligji në vitin 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur mandat për të hetuar rastet e diskriminimit në të gjitha fushat duke përfshirë edhe diskriminim gjinor që bëhet në shqyrtimin e rasteve për pronë dhe trashëgimi në gjykatat e Kosovës. Kodi i ri penal i Kosovës penalizon format e ndryshme të diskriminimit. Pos AKK-së në tryezë morën pjesë edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, prokurorët, gjyqtarët, shoqëria civile dhe përfaqësuesit e viktimave ku u diskutua për efektivitetin, progresin dhe sfidat e legjislacionit ekzistues si dhe praktikën e deritashme.

FUQIZIMI I TË DREJTAVE TË BARABARTA PRONËSORE TË GRAVE NË KOSOVË



Qëllimi i konferencës ishte të fuqizojë të drejtat pronësore të grave dhe ngritjen e vetëdijes të aspektit ligjor tek komunitetet e ndryshme. Në këtë mënyrë, Qendra Kosovare për Studime Gjinore kishte për qëllim të krijojë një bazë për zhvillimin dhe promovimin e pronës dhe trashëgimisë së grave në Kosovë. Gjatë konferencës u diskutua se si të avancohet efikasiteti i legjislacionit aktual dhe ndërlihdjen në mes të drejtave pronësore dhe fuqizimit ekonomik të grave.

16 DITË TË AKTIVIZMIT

Pjesëmarrja në hapjen e fushatës zyrtare të 16 ditëve të aktivizmit të organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit, me qëllim të shënimit të 25 Nëntori - Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas. Me këtë rast Agjencia për Barazi Gjinore prezantoi "Manualin për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor" i realizuar nga Konsorciumi Niras CPM International përmes projektit të SIDA's për ABGJ, si dhe "Raportin mbi nivelin e zbatimit të procedurave standarde të veprimit".

FUQIZIMI I AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE

Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore me temën "Fuqizimi i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave institucional për barazi gjinore në Kosovë". Trajnimi kishte për qëllim fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve për barazi gjinore.

FUQIZIMI I TË DREJTAVE PRONËSORE

Pjesëmarrja në prezantimin e të arriturave në fuqizimin e të drejtave pronësore në Kosovë të prezantuara nga Ministri i Drejtësisë, z. Abelard Tahiri. Sipas ministrit Tahiri, ndryshimi kryesor i bërë në 5 vitet e zbatimit të kësaj Strategjie është përmirësimi i trashëgimisë së pronës nga ana e grave në Kosovë.

TRAJTIMI INSTITUCIONAL I RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Konferenca kishte për synim të ofrojë një mundësi për shpalosjen e përkushtimit institucional për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Qëllimi i konferencës është shkëmbimi i përvojave mes palëve kyçe për të arritur deri te identifikimi i mundësive për ofrimin e një mbrojtjeje efikase institucionale dhe formulimin e rekomandimeve për të ardhmen. Kjo konferencë njëherit mundësoi komunikimin mes institucioneve kyçe dhe shoqërisë civile me qëllim të krijimit të një bashkëpunimi frytdhënës për adresimin e kësaj çështjeje.

FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS



Agjencia Kadastrale e Kosovës si organ kompetent për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë është e përfshirë në iniciativë të ndryshme në fushën e avancimit të të drejtave të grupeve potencialisht të marginalizuara në shfrytëzim të të drejtave pronësore, përfshirë edhe gratë. Për këtë arsye, ekspertë ligjorë të AKK-së, respektivisht Zyrtari i Lartë Ligjor z. Nadir Shyqeriu, ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga GLZ-i gjerman në kuadër të projektit "Fuqizimi Ekonomik i Gruas", i cili është mbajtur në Tiranë, Republika e Shqipërisë.

METODOLOGJIA RAJONALE PËR HARTIMIN E STREHIMIT TË ROMËVE

Projekti për Integrimin i Romëve që financohet nga Komisioni Evropian dhe implementohet në bashkëpunim me Këshillin Rajonal për Bashkëpunim në koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit, në bashkëorganizim me homologët e shteteve të regjionit kanë mbajtur konferencën rajonale "Metodologjia Rajonale për Hartimin e Strehimit të Romëve" në të cilën morën pjesë rreth 60 zyrtarë të pushtetit qendror dhe lokal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare nga rajoni i zgjerimit të BE, në mesin e të cilëve edhe përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.



AKK, VIZITË NË AREC



Një delegacion gjithëpërfshirës i Agjencisë Kadastrale të Kosovës i prirë nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Avni Ahmeti, i shoqëruar nga ekspertë kadastral, ekspertë të GIS-it e të TI-së, kanë qëndruar në një vizitë njëditore në Agjencinë për Kadastër dhe Patundshmëri të Republikës së Maqedonisë (AREC). Atje delegacioni i AKK-së u prit nga një delegacion i lartë i AREC-ut në përbërje të Kryeshefit Ekzekutiv z. Boris Tunxhev dhe Zëvendës Kryeshefi z. Musa Ibrahimime me bashkëpunëtorë. Një vizitë e tillë u realizua me kërkesë të

ekspertëve të AKK-së, ndërsa qëllimi ishte shkëmbimi i përvojave rreth projekteve dhe produkteve kadastrale në përgjithësi dhe projekteve specifike si Gravimetria dhe Pozicionimi Satelitor i Kosovës, respektivisht Maqedonisë në veçanti.

12. TRAJNIMET E OFRUARA

Po ashtu, Agjencia Kadastrale e Kosovës pos si konsumuese e trajnimeve për kuadrot e saja, është edhe ofruese e trajnimeve për palë të ndryshme të interesit. Në vijim është edhe një përmbledhje e trajnimeve që ka ofruar Agjencia Kadastrale e Kosovës:

REFORMAT NË KADASTËR, TAKIM MES AKK DHE ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE

Agjencia Kadastrale e Kosovës në kuadër të reformave në fushën e kadastrës, pas ndryshimit të akteve nënligjore, respektivisht hyrjen në fuqi të gjashtë Udhëzimeve Administrative në fushën e kadastrës dhe regjistrimit të pronës, ka mbajtur takim me Zyrat Kadastrale Komunale të përfaqësuara nga Drejtorët e Zyrave Kadastrale. Në takimet ka prezantuar ndryshimet që rrjedhin nga këto Udhëzime Administrative, me theks të veçantë ato pjesë që afektojnë punën e zyrtarëve nëpër Zyrat Kadastrale Komunale dhe Gjeodetët e licencuar, si standardizimi i çmimeve për produkte dhe shërbime kadastrale dhe pronëso-ro-juridike, eliminimi i pengesave për ndarjen dhe bashkimin e parcelave në zonat urbane, ndalesa e punëve në terren për bashkim dhe për ndarje të parcelave për zyrtarët e Zyrave Kadastrale Komunale, krijimi i bazës ligjore për ofrimin e produkteve kadastrale online, thjeshtimi i procedurave për krijimin e bashkëpronësisë dhe krijimi i bazës ligjore për ndarjen e bashkëpronësisë në rastet kur qytetarët janë obliguar të hyjnë në bashkëpronësi. Përndryshe, diskutimet interaktive rezultuan me një pajtueshmëri në masë të madhe mes zyrtarëve të AKK-së dhe ZKK-ve në lidhje me reformat, ndërsa disa çështje teknike mbet të zgjidhen përmes bashkëpunimit teknik e profesional mes institucioneve respektive. Konkretisht Udhëzimet e reja, të nënshkruara nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë z. Fatmir Matoshi janë Udhëzimi Administrativ për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve, Udhëzimi Administrativ për matjet kadastrale për regjistrim në kadastrë, Udhëzimi Administrativ për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, Udhëzim Administrativ për ndarjen e zonave kadastrale, Udhëzimi Administrativ për tarifat e produkteve dhe shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Udhëzimi Administrativ për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës.

REFORMAT NË KADASTËR, TAKIM MES AKK DHE SHOQATËS SË GJEODETËVE TË KOSOVËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës, në kuadër të reformave në fushën e kadastrës ka ndërmarrë disa iniciativa ligjore të cilat kanë rezultuar me ndryshimin e akteve nënligjore, respektivisht hyrjen në fuqi të gjashtë Udhëzimeve Administrative në fushën e kadastrës dhe regjistrimit të pronës, të cilat do të ndikojnë edhe në kryerjen e punëve të përditshme nga Kompanitë e licencuara gjeodete, gjeodetët e licencuar dhe Zyrat Kadastrale Komunale. Ndërsa me qëllim të prezantimit të Udhëzimeve Administrative, si dhe trajtimit të çështjeve tjera të interesit të përbashkët, është mbajtur një takim i përbashkët mes ekzekutivit të AKK-së të prirë nga Kryeshefi z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga ekspertë kadastral dhe ligjor dhe Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës të prira nga Kryetari i kësaj shoqate z. Murat Hoxha dhe rreth 120 gjeodetë të licencuar. Në takim u prezantuan ndryshimet që rrjedhin nga këto Udhëzime Administrative, me theks të veçantë ato pjesë që afektojnë punën e Kompanive të licencuara gjeodete dhe të gjeodetëve të licencuar si standardizimi i çmimeve për produkte dhe shërbime kadastrale dhe pronëso-ro-juridike, eliminimi i pengesave për ndarjen dhe bashkimin e parcelave në zonat urbane, ndalesa e punëve në terren për bashkim dhe për ndarje të

parcelave për zyrtarët e Zyrave Kadastrale Komunale, që rrjedhimisht do të ngarkojnë me më shumë punë dhe përgjegjësi Kompanitë e licencuara gjeodete dhe gjeodetët e licencuar, krijimi i bazës ligjore për ofrimin e produkteve kadastrale online, thjeshtimi i procedurave për krijimin e bashkëpronësisë dhe krijimi i bazës ligjore për ndarjen e bashkëpronësisë në rastet kur qytetarët janë obliguar të hyjnë në bashkëpronësi. Po ashtu, një pjesë e madhe e diskutimeve u fokusuan edhe rreth licencimit të Kompanive të licencuara gjeodete dhe gjeodetëve të licencuar, respektivisht ngritja e kriterëve për licencim në pajtueshmëri edhe me përgjegjësitë të shtuara që gjeodetët do të kenë, pastaj trajnimi i gjeodetëve konform zhvillimeve dinamike në fushën e kadastrës, teknologjisë e ngjashëm, monitorimi i punëve të gjeodetëve dhe marrja e masave në rastet kur do të evidentohen shkelje ose gabime të përsëritura. Për krejt këto u tha se kanë për qëllim ngritjen e kualitetit të shërbimeve që ofrojnë gjeodetët e licencuar. Përndryshe, diskutimet interaktive rezultuan me një pajtueshmëri në masë të madhe mes zyrtarëve të AKK-së dhe Shoqatës së Gjeodetëve rreth detyrave e obligimeve që rrjedhin nga këto Udhëzime Administrative, ndërsa kishte një pajtueshmëri rreth faktit se me këto ndryshime fuqizohet roli i gjeodetit në shoqëri. Folësit nga Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës gjatë paraqitjeve të tyre vlerësuan angazhimin e ekzekutivit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe e falënderuan të njëjtin për marrjen në konsideratë dhe përfshirjen e komenteve që kjo shoqatë kishte dhënë gjatë fazave të ndryshme të draftimit të Udhëzimeve Administrative. Konkretisht Udhëzimet e reja, të nënshkruara nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë z. Fatmir Matoshi janë Udhëzimi Administrativ për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve, Udhëzimi Administrativ për matjet kadastrale për regjistrim në kadastrë, Udhëzimi Administrativ për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, Udhëzim Administrativ për ndarjen e zonave kadastrale, Udhëzimi Administrativ për tarifat e produkteve dhe shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Udhëzimi Administrativ për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës. Përndryshe, në fund të takimeve Kryeshefi i AKK-së z. Avni Ahmeti bëri edhe një përmbledhje të diskutimeve dhe prezantoi konkludimet si respektimi i çmimoreve që rregullon tarifat për shërbimet e ofruara nga Gjeodetët e licencuar dhe Kompanitë të licencuara gjeodete, monitorimin e rregullt të punëve që kryhen nga Kompanitë e licencuara gjeodete dhe gjeodetët e licencuar si dhe adresimi i ankesave eventuale për ZKK-të në AKK.

TRAJNIM PROKURORËVE DHE GJYJATËSVE TË RINJ

Agjencia Kadastrale e Kosovës me datë 01.02.2019. organizoi një trajnim për prokurorët e rinj, si palë e fuqishme e interesit në fushën e të drejtave pronësore. Prokurorët në trajnim u pritën nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti dhe ekspertë ligjor dhe kadastral të Agjencisë. Në trajnim u bë një përmbledhje e shkurtë rreth punëve, aktiviteteve si dhe ligjeve dhe sistemeve që përdor Agjencia Kadastrale e Kosovës për administrimin e regjistrave pronësorë, me theks të veçantë pjesën tekstuale dhe grafike të të dhënave pronësore. Agjencia Kadastrale e Kosovës, pos prezantimit të sistemeve, informoi prokurorët edhe mbi mandatin e saj si certifikuese për të gjithë zyrtarët e Zyrave Kadastrale në të gjithë Kosovën dhe institucioneve të tjera publike të cilët kanë edhe qasje në këto sisteme. Në mesin e fushave të interesit, prokurorët u informuan mbi bazën ligjore për ndryshimet dhe mirëmbajtjen e sistemit kadastral. Prokurorët shpalosën ankesa dhe kërkesa, dhe prezantuan sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë trajtimit të lëndëve. Po ashtu, prokurorët dhe ekspertët e AKK-së trajtuan edhe mundësinë e ngritjes së shkallës së bashkëpunimit sa i përket shpërndarjes së informacioneve të sakta dhe kualitative. Agjencia po ashtu ofroi mbështetje të vazhdueshme gjithmonë

në të mire të institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në këto trajnime kanë marrë pjesë rreth 50 gjyqtarë e prokurorë të rinj.

TRAJNIM PËR SIKTK SOA ME OPERATORËT E 35 ZYRAVE KADASTRALE

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka avancuar Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK) kah arkitektura e orientuar në shërbime. Me qëllim të ngritjes së nivelit të administrimit të regjistrave pronësorë, si nga pikëpamja e sigurisë, kualitetit e mënyrës së shpërndarjes së të dhënave, si rezultat SIKTK është avancuar me module shtesë të cilat kanë avancuar edhe vetë mënyrën e kryerjes së punëve nga operatorët nëpër Zyrat Kadastrale. Trajnimet kanë qenë interaktive, ku përpos prezantimit të moduleve, në kohë reale janë prezantuar edhe modulet shtesë dhe administrimi i tyre.

TRAJNIM - SISTEMI PËR RIK

Aktivitetet e Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale menaxhohen nga AKK-ja , e cila hyn në marrëdhënie kontraktuale me kompani private të licencuara për kryerjen e punëve të këtij projekti. RIK-u është proces, i cili kërkon ndryshime në të dy bazat e të dhënave, atë tekstuale dhe atë grafike. Për shkak se këto procese bëjnë ndryshim në shumë të dhëna njëherësh, atëherë ka qenë e nevojshme të krijohet një sistem, i cili ka funksionalitete të njëjta me funksionet dhe kufizimet e SIKTK -T dhe mundëson mbështetjen e proceseve të RIK-ut. Sikur edhe për çdo zhvillim tjetër në sisteme digjitale, AKK-ja para implementimit zhvillon trajnime për stafin që e shfrytëzon sistemin. Në këtë rast në trajnim janë ftuar përdoruesit e Operatorit Ekonomik që po realizon projektin e RIK-ut. Gjatë kësaj periudhe trajnuese këta përdorues (15 gjithsej) kanë pasur mundësi që përveç prezantimit të zhvillimeve në sistem të mund të kyçen direkt në versionin test të Sistemit për RIK për të parë nga afër funksionalitetin dhe mënyrën e përdorimit të Sistemit. Me këtë zhvillim mundësohet që të azhurnohen të gjitha të dhënat nga projekti i RIK-ut, me kualitet të lartë, fleksibilitet dhe shpejtësi. Është shumë e rëndësishme që në momentin e përdorimit të Sistemit për RIK përdoruesi shih gjendjen e fundit të njësive kadastrale të cilat janë azhurnuar nga ZKK-të. Përveç Sistemit për RIK, trajnimi është realizuar edhe për pjesën grafike në Hartën Kadastrale.

PUNËTORI PËR TRAJTIMIN E OBJEKTEVE PA LEJE

Agjencia Kadastrale e Kosovës si organ kompetent për punë gjeodezike në Republikën e Kosovës, jep kontributin e saj profesional për nevojat e proceseve të interesit publik zhvilluar nga institucione tjera publike në Republikën e Kosovës. Për këtë arsye, dy ekspertë të AKK-së respektivisht Esat Xani, Ekspert i GIS-it dhe z. Nadir Shyqeriu, Ekspert Ligjor janë duke marrë pjesë në një takim të organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Ndërtimit, e i mbështetur nga OSCE, e që ka të bëjë me trajtimin e objekteve pa leje. Konkretisht, qëllimi i këtij takimi është përfundimi i Udhëzuesit për legalizimin e objekteve të kategorisë I dhe II, ku ekspertët e AKK-së prezantuan dokumentin për përgatitjen e dokumentacionit gjeodezik dhe kadastral për ndërtesat dhe pjesët e ndërtesave në procesin e legalizimit të objekteve pa leje. Përndryshe, kjo punëtori është treditore dhe e njëjta mbahet në Shkup, Maqedonia e Veriut.

13. MARRËDHËNIE ME PUBLIK DHE GJITHËPËRFSHIRJE

UEB FAQJA ZYRTARE

Faqja zyrtare e Agjencisë Kadastrale të Kosovës www.kca-ks.org është një nga kanalet kryesore të komunikimit në mes të AKK dhe qytetarëve, me rreth 27.000 vizitorë unikë, dhe me rreth 180.000 shikime përgjatë vitit 2019. Në faqen e internetit janë publikuar të gjitha aktivitetet, projektet, produktet dhe shërbimet e ofruara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, legjislacioni që mbulon fushën e kadastrës dhe administrimin e tokës, aktivitetet e sektorit publik, ndërsa përditësohet në baza ditore. Gjatë vitit 2019 në faqen e AKK-së janë publikuar rreth 150 lajme nga aktivitete të ndryshme.

FACEBOOK

Agjencia Kadastrale e Kosovës po ashtu ka edhe faqen e saj zyrtare në rrjetin social Facebook ku plason informacione të rëndësishme rreth aktiviteteve të saja. Sikurse edhe në faqen zyrtare, edhe në facebook gjatë vitit janë postuar rreth 150 lajme. Përndryshe faqja është pëlqyer dhe përcillet nga 4,039 me trendin e pëlqimeve në rritje:

GAZETA PERIODIKE "KADASTRA"

Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2019 ka filluar edhe shtypin dhe publikimin e gazetës periodike të saj "Kadastra", që ka për qëllim informimin e palëve të ndryshme të interesit mbi aktivitetet, produktet, shërbimet dhe projektet e saja. Gjatë vitit janë shtypur 10 edicione të gazetës "Kadastra" dhe secili numër i është shpërndarë mbi 100 institucioneve publike në Republikën e Kosovës.

BARAZIA GJINORE

Sipas Ligjit nr. 05/l -020 për barazi gjinore, Neni 6, pika 2.1. (për kuotën për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve), Agjencia Kadastrale e Kosovës në pozita udhëheqëse ka përmbushur obligimin ligjor. Ndërsa si aktivitet kryesor këtë vit është edhe vazhdimi i Udhëzimit administrativ për (QRK) Nr.02/2019 për Masa të veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve nga i cili deri me tani kanë përfituar 4854 bashkëshortë. Vlen të ceket që para hyrjes në fuqi të UA kanë qenë gjithsej 104 raste që kanë regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve ndërsa tani kemi 4958 raste.

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Agjencia Kadastrale e Kosovës vlen si institucion transparent. Ajo ka të emëruar zyrtarin për qasje në dokumente publike, kontakti i të cilit është i publikuar në uebfaqen e Agjencisë. Këtë vit nga dhjetëra kërkesa për qasje në dokumente, që kryesisht vijnë nga mediat, OJQ-të dhe qytetarët, asnjë nuk është refuzuar.

IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE GJUHËSORE

Agjencia Kadastrale e Kosovë implementon politikat gjuhësore duke garantuar që secili përfaqësues i institucioneve dhe secili qytetarë i Republikës së Kosovës shërbehet në gjuhë të cilën e kupton. Gjatë vitit 2019 nuk pa pasur ankesa qoftë nga institucionet qoftë nga palët të mos jenë shërbyer në gjuhë të kuptueshme për ta. Sfidë mbetet përkthimi i publikimeve në uebfaqe, për shkak të vëllimit të madh të punëve, ndërsa AKK ka vetëm një zyrtar për përkthim.

Nr.	Lloji i dokumenteve të përkthyera	Numri i dokumenteve	Numri i faqeve
1.	Aktvendime	83	151
2.	Aktgjykime	26	39
3.	Ankesa	22	29
4.	Autorizime	14	23
5.	Kontrata / shitblerjeje, ndarje fizike, bashkim parcelash, bashkim mjetesh në ndërtim, etj.	31	52
6.	Konkluzione të ndryshme	21	22
7.	Rekomandime	14	14
8.	Formularë për shërbime në AKK-serbisht	5	6
9.	Plotësim të lëndëve	22	22
10.	Deklarata nën betim	5	5
11.	Mendime profesionale	11	11
12.	Përgjigje në ankesë – për gjykatat	6	19
13.	ToR Prokurim – rinovim i zyrave në AKK	4	19
14.	Urgjenca	7	11
15.	Përmirësime me ndërhyrje në 5 Projekt-Ligje	5	51
16.	Ligji mbi Kadastrën – vetëm ndryshimet	1	46
17.	Akt noterial	14	26
18.	UA – licencimi i gjeodetëve dhe kompanive të licencuara	1	29
19.	Kundërshtim & Vërejtje	5	9
20.	Specifikimi teknik për TI-në	2	7
21.	Kërkesë për verifikim në arkivin e gjykatës së Mitrovicës Veriore	9	9
22.	Heshtje e administratës	5	7
23.	Kërkesa për mendim profesional nga ZKK-të	21	23
24.	Pezullim i lëndës	3	5
24.	Konkurse (të ndryshme)	4	7
	Totali	341	642

15.KALENDARI ME NGJARJE TË RËNDËSISHME

14 Janar

BANKA BOTËRORE, TAKIM ME AKK

Një ekip i Agjencisë Kadastrale të Kosovës priti në takim një delegacion të Bankës Botërore dhe FAO-s. Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti me bashkëpunëtorët ofruan mbështetje për çdo projekt që Banka Botërore ka në Kosovë, gjithashtu edhe ndihmë teknike në fushën e gjeodezisë, kadastrit, pronës dhe ofrimit të dhënave të sakta gjeohapsinore.



15 Janar

POLICIA E KOSOVËS, BASHKËPUNIM ME AKK

Me qëllim të identifikimit të fushave të interesit publik dhe intensifikimit të bashkëpunimit mes institucioneve përkatëse, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti priti në një takim pune përfaqësues të Policisë së Kosovës nga Regjioni i Mitrovicës, respektivisht Rreshter Ismet Koca dhe Rreshter Zekirija Jonuzi. Tema kryesore e takimit ishte trajtimi i mënyrave më të shpejta për shkëmbimin e produkteve hartografike për nevoja të Policisë së Kosovës.



21 Janar

SIGMA, TAKIM NË AKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës, si organ kompetent për ofrimin e shërbimeve kadastrale dhe pronëso-ro-juridike për institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës është identifikuar si palë e interesit nga programi për mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim – SIGMA. Për këtë arsye është mbajtur një takim mes përfaqësuesve të institucioneve respektive, me qëllim të informimit të ndërsjellë rreth aktiviteteve të tyre dhe identifikimit të fushave të interesit të përbashkët.



24 Janar

TAKIM ME KRYETARIN E ODËS SË NOTERËVE

Duke e konsideruar bashkëpunimin mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Odës së Noterëve si thelbësor për avancimin e shërbimeve pronëso-ro-juridike për institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti priti në një takim pune Kryetarin e Odës së Noterëve z. Aliriza Beshi me të cilin o pajtuan rreth hapave që duhen ndërmarrë, krejt me qëllim të ofrimit të shërbimeve kualitative për qytetarët.



4 Janar

PËRFAQËSUES TË "STATENS KARTVERK" NË AKK

Qysh nga themelimi i saj, AKK ka pasur përkrahjen e donatorëve të fuqishëm ndërkombëtarë, ndërsa në mesin e atyre është edhe përkrahja e Qeverisë së Mbretërisë Norvegjeze përmes Autoritetit Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Statens Kartverk". Takimet me përfaqësues të Statens Kartverk kanë qenë të shpeshta dhe kanë rezultuar me implementim të suksesshëm të projekteve kapitale.



25 Janar

TRASHËGIMIA KULTURORE, TAKIM MES AKK E KKTK



Agjencia Kadastrale e Kosovës është duke fuqizuar dhe zgjeruar rrjetin e bashkëpunimit me institucione publike, krejt me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve kadastrale, pronëso- juridike dhe gjeohapësinore. Për këtë qëllim, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti organizoi një takim pune me Udhëheqësin Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor z. Isuf Kocin. Në takim u prezantuan aktivitetet e institucioneve respektive, ndërsa u diskutua edhe avancimi i bashkëpunimit në fushën e shpërndarjes së të dhënave gjeohapësinore përmes Gjeoportalit Shtetërorë.

25 Janar

AKK, VIZITË PUNE NË TURQI



Një delegacion gjithëpërfshirës i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, i përbërë nga ekspertët kadastral z. Korab Ahmetaj u.d Drejtor i Drejtorisë për Kadastër, z. Esat Xani ekspert i GIS-it, z. Avni Rustemi ekspert i hartografisë, z. Amir Reçica ekspert i GIS-it, z. Reshat Murati ekspert i GIS-it, kanë qëndruar në një vizitë disaditore në Turqi, respektivisht në Agjencinë Turke për Kadastër dhe Hartografi me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe njohurive nga fusha e hartografisë.

1 Shkurt

PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019



Nën organizimin e Ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Fatmir Matoshi dhe me mbështetjen bashkëfinanciare nga partneri GIZ, me 31 Janar 2019 - 02 Shkurt 2019 Tiranë, Shqipëri është mbajtur Punëtorja "Plani Vjetor i Punës për vitin 2019, zbatimi i prioriteteve dhe politikave të Ministrisë dhe harmonizimin e tij me Planin e Qeverisë dhe koordinimi me Donator". Në mesin e pjesëmarrësve në këtë punëtori ishte Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, i shoqëruar edhe nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj.

7 Shkurt

AMBASADORI NORVEGJEZ VIZITON AKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës, qysh nga themelimi i saj, pos përkrahjes financiare të Qeverisë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, ka pasur edhe përkrahjen e donatorëve të fuqishëm ndërkombëtar, në mesin e të cilëve edhe Autoriteti Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Statens Kartverk". Me këtë përkrahje janë realizuar projekte të rëndësishme përfituese nga të cilët kanë qenë si qytetarët po ashtu edhe institucionet e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë ngritja edhe avancimi i Sistemit të Informacioneve Kadastrale të Tokës në Kosovë, Sistemi i Unifikuar i Adresave, Gjeoportali Shtetërorë, Ueb shërbime për shkëmbim të të dhënave të ngjashëm. Ndërsa për prezantim të rezultateve të arritura nga përkrahja e qeverisë Norvegjeze, me datë 7 shkurt në AKK ka qëndruar Ambasadori Norvegjez z. Per Strand Sjaastad i cili vlerësoi bashkëpunimin me AKK dhe u zotua në vazhdim të të njëjtit.

8 Shkurt

AKK, TAKIM ME AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës, si institucion përgjegjës për koordinimin e infrastrukturës kombëtare për informacione hapësinore, ka qenë në vazhdimësi e interesuar për të thelluar bashkëpunimin me institucione publike që prodhojnë, mirëmbajnë dhe shfrytëzojnë të dhëna hapësinore. Për këtë arsye, me datë 11 Shkurt 2019, në ambientet

e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur takim pune mes kreut të AKK-së z. Avni Ahmeti me bashkëpunëtor dhe z. Eset Berisha, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AACK), po ashtu me bashkëpunëtor.



13 Shkurt

AKK, TAKIM ME AKADEMINË E DREJTËSISË

Pas trajnimit që u ka ofruar Prokurorëve dhe Gjyqtarëve të rinj, Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti i shoqëruar me Drejtorin e zyrës ligjore z. Ismet Kryeziu dhe z. Bashkim Shaqiri pritën në takim Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë z. Valon Kurtaj me bashkëpunëtor me që cilin diskutuan rreth fushave të interesit të përbashkët dhe thellimit të bashkëpunimit mes tyre.



20 Shkurt

AKK, TAKIM ME DREJTORËT E ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE

Me qëllim të ngritjes së shkallës së bashkëpunimit mes institucioneve të nivelit qendror dhe atyre të nivelit lokal në fushën e kadastrës dhe regjistrave pronësorë në veçanti dhe administrimit të tokës në përgjithësi, me datë 20 Shkurt 2019 në Prishtinë është mbajtur takim pune mes ekspertëve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Drejtorëve të Zyrave Kadastrale

Komunale.



28 Shkurt

GRAVIMETRIA, VIZITË NË OSLO

Duke e marrë parasysh se viteve të kaluara, me përkrahje të autoritetit norvegjez për kadastër dhe hartografi "Kartveket", janë zhvilluar matje relative gravimetrike të pjesshme të rrjeteve të rendeve të ndryshme, kreu i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti i shoqëruar edhe nga u.d Drejtor i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe Eksperti i GIS z. Reshat Murati, kanë qëndruar në Oslo, me ftesë të përfaqësuesve të "Statens Kartverk". Qëllimi i kësaj vizite është grumbullimi i sa më shumë informacioneve profesionale në lëminë e gravimetrisë, shkëmbimi i informacioneve mes ekspertëve, prezantimi i sfidave eventuale dhe identifikimi i mjeteve për tejkalimin e këtyre fushave.



4 Mars

NSDI, PUNËTORI MES INSTITUCIONEVE PUBLIKE E AKADEMIKE

Nën organizimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në kuadër të Programit Mjedisor për Kosovën-KEP 2016, komponenti "Forcimi i kapaciteteve të AMMK-së, për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor", është mbajtur punëtorja "Të dhënat gjeo-hapësinore dhe roli i tyre në hartimin e politikave zhvillimore dhe vendimmarrjes-Gjendja aktuale, sfidat dhe prioritetet për të ardhmen".



12 Mars

PUNËTORI PËR PROJEKTIN SPATIAL

Një delegacion i Agjencisë Kadastrale të Kosovës ka marrë pjesë në një takim të organizuar nga projekti regjional "SPATIAL" i cili konsiston me zhvillimin dhe harmonizimin e infrastrukturës së të dhënave hapësinore të shteteve të regjionit të Ballkanit perëndimorë me atë të shteteve anëtare të BE-së.



15 Mars

AKK, TAKIM PUNE ME UN-HABITAT

Agjencia Kadastrale e Kosovës në vargun e zgjerimit të rrjetit të bashkëpunëtorëve, si me institucione publike po ashtu edhe me organizata ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës, ka mbajtur takim me përfaqësues të Zyrës së UN HABITAT në Republikën e Kosovës, respektivisht me z-njën Gwendoline Mennetrier dhe bashkëpunëtorin e saj në këtë zyre, z. Visar Salii. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i aktiviteteve nga dyja institucionet në fushën e administrimit të tokës, si dhe identifikimi i interesave të përbashkëta ku ky bashkëpunim do të mund të thellohej. Po ashtu si rrjedhojë e fillimit të bashkëpunimit mes AKK dhe UN HABITAT, është arritur që të organizohen disa takime mes udhëheqësve të AKK-së me udhëheqësit e drejtorive përgjegjëse

për kadastrë të Komunave Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan. E gjithë kjo me qëllim të funksionalizimit të atyre zyrave konform legjislacionit të Republikës së Kosovës.



19 Mars

AKK, TAKIM ME AKP



Në mesin e institucioneve të cilët në baza të rregullta furnizohen me produkte dhe shërbime nga AKK është edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), ndërsa me qëllim të ngritjes së shkallës së bashkëpunimit mes tyre, kreu i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti i shoqëruar edhe nga u.d Drejtor i Drejtorisë për Kadastrë z. Korab Ahmetaj, pritën në një takim pune Drejtorin Menaxhues të AKP-së z. Valon Tolaj i shoqëruar nga një grup gjithëpërfshirës bashkëpunëtorësh.

21 Mars

AKK, TAKIM ME AGJENCINË PËR BARAZI GJINORE




Me qëllim të lehtësimit të qasjes së grave në të drejta pronësore, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka implementuar një varg projektsh e fushatash për

inkurajimin e grave për regjistrim të të drejtave pronësore. Po ashtu, Agjencia Kadastrale e Kosovës është pjesë e nismave të ndryshme vendore e regjionale për avancim të të drejtave pronësore për grupet potencialisht të marginalizuara duke përfshirë edhe gratë, ndërsa një prej bashkëpunëtorëve më të fuqishëm në këtë fushë është edhe Agjencia për Barazi Gjinore. Për këtë arsye, me datë 21 Mars në ambientet e Agjencisë është mbajtur një takim pune mes ekspertëve të AKK, respektivisht kreu të AKK z. Avni Ahmeti, ekspertëve ligjorë z. Bashkim Shaqiri dhe z-nja Edona Kutlllovci, zyrtarja për barazi gjinore në AKK z-nja Ibadete Rexhepi, me Kryeshefen e Agjencisë për Barazi Gjinore z- njën Edi Gusia edhe ekspertin për barazi gjinore z-njën Leonora Sylejmani.

26 Mars

REGJISTRIMI U POPULLSISË, TAKIM ME AGJENCINË E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Me datë 26 mars, në ambientet e AKK-së është mbajtur takim mes kreu të AKK-së z. Avni Ahmetit, u.d Drejtorit të Drejtorisë për Kadastrë z. Korab Ahmetaj dhe ekspertes ligjore në AKK z-njës Edona Kutlllovci dhe z. Avni Kastrati, Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale dhe Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit të MTI-së pranë ASK-së. Qëllimi i takimit ishte informimi më në detaje rreth sistemit të unifikuar të adresave, mundësive më të sigurt dhe sakta për shpërndarjen e adresave përmes ueb shërbimeve dhe rreth produkteve tjera kadastrale, pronësore dhe hartografike që do të mund të ndihmonin procesin e regjistrimit të popullsisë të cilin Agjencia e Statistikave e Kosovës parasheh ta implementojë gjatë vitit 2021.



17 Maj

HIDROSISTEMI KIKË-KREMENATË, DISKUTIM PUBLIK

Nën organizimin e Kryetarit të Komunës së Kamenicës z. Qendron Kastrati, me pjesëmarrjen e Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Fatmir Matoshi, përfaqësuesve të Bankës Botërore, Kryeshefit të AKK-së z. Avni Ahmeti, prijësve të institucioneve publike të interesit dhe me pjesëmarrjen e qytetarëve të Komunës së Kamenicës, me datë 16 maj 2019, në ambientet e Kuvendit Komunal Kamenicës është mbajtur diskutimi publik rreth projektit "Hidrosistemi Kikë-Kremenatë".



25 Maj

ADRESAT, TAKIMI NË KOMUNËN E MITROVICËS

Një delegacion i Agjencisë Kadastrale të Kosovës i përbërë nga u.d Drejtor i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj, dhe eksperti nga Njësia e Adresave në Agjenci z. Amir Sogojeva kanë vizituar Komunën e Mitrovicës, ku janë pritur nga z. Besnik Beka, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe nga z. Erdoan Jashari, Zyrtar i Adresave. Në takim është diskutuar rreth mundësisë që ky projekt të realizohet përmes bashkëfinancimit në komunën e Mitrovicës.



13 Qershor

MINISTRI MATOSHI PRET NË TAKIM Z. AHMETIN


Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Fatmir Matoshi priti në takim Drejtorin e Përgjithshëm të sapo zgjedhur të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti. Qëllimi i takimit ishte informimi i përgjithshëm rreth aktiviteteve të përbashkëta, identifikimi i fushave prioritare për bashkëpunim, sidomos ato ku interesi i qytetarëve të Republikës së Kosovës është i menjëhershëm, informimi rreth sfidave e ngjashëm.



20 Qershor

PËRURROHEN TABELAT ME EMRA RRUGËSH NË GJILAN DHE KAMENICË

Në dy ceremoni të ndara solemne, një në Komunën e Gjilanit dhe një në Komunën e Kamenicës, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Komunës së Gjilanit z. Lutfi Haziri dhe Kryetarit të Komunës së Kamenicës z. Qendron Kastrati, Zëvendës Ministrit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë z. Gjergj Beka, Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, përfaqësuesve të autoritetit norvegjez për kadastër „Statens Kartverk” z. Helge Onsrud dhe z. Tor Laugen është bërë inaugurimi i projektit për vendosjen e tabelave me emra të rrugëve në këto dy komuna.



21 Qershor

PËRURROHEN TABELAT ME EMRA RRUGËSH NË PEJË DHE KLINË



Në dy ceremoni të ndara solemne, një në Komunën e Pejës dhe një në Komunën e Klinës, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri dhe Kryetarit të Komunës së Klinës z. Zenun Elezaj, Ambasadorit Norvegjez në Republikën e Kosovës z. Per Strand Sjaastad, Zëvendës Ministrit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë z. Gjergj Beka, Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, përfaqësuesve të autoritetit norvegjez për kadastër „Statens Kartverk“ z. Helge Onsrud dhe z. Tor Laugen është bërë inaugurimi i projektit për vendosjen e tabelave me emra të rrugëve në këto dy komuna.

18 Korrik

TAKIMI ME ZYRTAR TË UN - HABITAT DHE DREJTORIN E URBANIZMIT TË KOMUNËS SË LEPOSAVIQIT



Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorët nga Drejtoria e Kadastrit dhe ai Ligjor, ka pritur në takim znj. Arieta Himaduna nga UN - Habitat dhe z. Goran Luzoviç – Drejtor i Urbanizmit të Komunës së Leposaviqit. Qëllim i takimit ishte diskutimi rreth mundësive të implementimit të SIKTK në këtë Komunë, me qëllim të ofrimit të

shërbimeve pronësore për qytetarët e kësaj komune.

26 Korrik

TAKIM ME DREJTORIN E KADASTRËS TË MITROVICËS SË VERIUT

Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti së bashku me bashkëpunëtor priti në takim Drejtorin e Kadastrës të Mitrovicës së Veriut z. Dejan Krsmanovic dhe z. Hamit Mripa Zyrtar i Lartë Ligjorë i Zyrës Kadastrale të Mitrovicës. Qëllimi i takimit ishte trajtimi i mundësive për funksionalizimin e SIKTK-së në këtë Komunë.



30 Korrik

AKK, TAKIM ME KRYETARIN E KOMUNËS SË OBILIQIT

Me qëllim të prezantimit të aktiviteteve të Komunës së Obiliq dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës si dhe me qëllim të identifikimit të fushave të interesit të përbashkët në të cilat bashkëpunimi do të mund të avancohej në të ardhmen, me datë 30 korrik në ambientet e Komunës së Obiliqit është mbajtur një takim pune mes Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe z. Xhafer Gashi dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, të shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët.



1 Gusht

**AKK, BASHKËPUNIM PËR RREZIQET
NGA VËRSHIMET**

Nën organizimin të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve publike të Republikës së Kosovës, në mesin e të cilëve edhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, respektivisht nga Drejtoria për Teknologji të Informacioneve, është mbajtur takimi parapërgatitor për projektin e vlerësimit të rreziqeve nga vërshimet e pellgjeve të lumenjve Drini i Bardhë, Lepenc dhe Sitnicë.



6 Gusht

AKK, VIZITË NË AME

Një ekip i Agjencisë Kadastrale të Kosovës mbajti një takim pune me përfaqësues të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, që kishte për qëllim trajtimin e kornizës ligjore dhe aspektin teknik që rregullon fushën e shpërndarjes së të dhënave gjeohapsinore mes institucioneve publike në Republikën e Kosovës.



8 Gusht

**TAKIM BASHKËPUNIMI NË MES TË AKK-
SË, DHE KOSTT**

Përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), më datë 08.08.2019 mbajtën takim pune me përfaqësues nga Operatori

i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT), me qëllim të shkëmbimit të të dhënave gjeohapësinore që mirëmban KOSTT për prezantim në gjeoportalin shtetëror në kuadër të temës "Shërbimet publike komunale dhe qeveritare" nga direktiva "INSPIRE".



16 Gusht

AKK, TAKIM ME KRU "GJAKOVA"

Zyrtarë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës përkatësisht stafi nga projekti IMPULS, kanë mbajtur një takim me zyrtarë të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Gjakova" SH.A. Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i të dhënave Gjeohapësinore të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, që i përkasin temës " Shërbimet Publike Komunale Qeveritare" nga direktiva "INSPIRE", për prezantim në Gjeoportalin Shtetëror.



29 Gusht

AKK, BASHKËPUNIM ME IKAP

Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti, i shoqëruar nga drejtoresha e Drejtorisë për Financa dhe Administratë znj. Fazile Hamiti, priten në takim pune Kryeshefen e Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP) znj. Refike Sulçevsi. Qëllimi i takimit ishte identifikimi i nevojave të AKK-së për avancim të stafit të saj.



18 Shtator

DELEGACION I BANKËS BOTËRORE NË AKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës është përfutuese dhe implementuese e projektit për regjistrimin e pronës në kadastër dhe infrastrukturës së të dhënave hapësinore (REGIP), projekt që po implementohet me huamarrje nga Banka Botërore. Ndërsa me qëllim të analizimit të aktiviteteve të cilat pritet të implementohen në kuadër të projektit REGIP, një delegacion i Bankës Botërore i prirë nga Udhëheqësja e Projektit REGIP njëherësh eksperte në fushën e administrimit të tokës, z-nja Aanchal Anand e shoqëruar nga bashkëpunëtorë të saj, ka qëndruar në një vizitë disaditore në AKK.



2 Tetor

AKK, PUNËTORI PËR DIREKTIVËN INSPIRE

Nën organizimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe me pjesëmarrje të ekspertëve në fushën e krijimit, mirëmbajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave gjeohapësinore dhe ekspertëve ligjor nga vetë Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, në Prishtinë është mbajtur punëtorja për prezantim të kornizës ligjore për implementimin e Direktivës së BE-së 2007/2 INSPIRE, e cila përcakton rregullat e shkëmbimit të të dhënave gjeohapësinore mes shteteve anëtare të BE-së.

24 Tetor

FONDACIONI I MILENIUMIT TË KOSOVËS, TAKIM NË AKK



Agjencia Kadastrale e Kosovës si organ kompetent për koordinimin e aktiviteteve në fushën e infrastrukturës shtetërore për të dhëna gjeohapësinore, është duke ndihmuar projekte të shumta që janë duke u implementuar në Republikën e Kosovës, e që kanë nevojë për të dhëna gjeohapësinore. Për këtë arsye, me datë 24 tetor në ambientet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës është mbajtur një takim pune mes përfaqësuesve të AKK-së, respektivisht Kryeshefit ekzekutiv z. Avni Ahmeti dhe u.d Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër z Korab Ahmetaj, me përfaqësues të Fondacionit të Mileniumit të Kosovës dhe kompanisë "NIRAS" të cilët janë duke implementuar projekt për cilësinë e ajrit në Kosovë.

23 Nëntor

50 VJETORI I SHKOLLËS SË PARË TË GJEODEZISË NË KOSOVË

Me rastin e shënimit të jubileut pesëdhjetëvjeçar të hapjes së Shkollës së Parë të Gjeodezisë në Kosovë, nën organizimin e Shoqatës së Gjeodetëve të Kosovës dhe me pjesëmarrjen e një numri të madh gjeodetësh, në Gjakovë është mbajtur një manifestim solemnt për shënimin e këtij jubileu.



15. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2020 - REFORMAT DHE PROJEKTET

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e saja, AKK ka identifikuar sfidat me të cilat është ballafaquar gjatë vitit 2019, dhe rrjedhimisht ka hartuar edhe reforma të cilat do të ndihmonin në tejkalimin e këtyre sfidave, e të cilat mbështetet në katër aspekte kryesore, si aspekti ligjor, aspekti organizativ, aspekti i teknologjisë së informacionit dhe aspekti i gjithëpërfshirjes shoqërore, të cilat më në detaje gjenden të elaboruara më poshtë.

15.1 REFORMAT NË KADASTËR

Në bazë të ligjeve të Republikë së Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës është institucion përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrit të pronave të paluajtshme, për kadastrë, gjeodezi, hartografi, sistemin e adresa si dhe për Infrastrukturën Kombëtare të informacioneve Hapësinore (NSDI). Agjencia Kadastrale e Kosovës mund të cilësohet një ndër institucionet më të rëndësishme shtetërore. Zhvillimet në fushën e administrimit të tokës dhe kërkesat gjithnjë në rritje nga palët e ndryshme për të dhëna të sakta, të sigurta, të hapura, qasje të shpejt në të dhëna, janë duke imponuar ndryshime dhe avancime ligjore, avancime në teknologjinë informative edhe në vendin tonë. Sidoqoftë, edhe pse sfiduese, kjo nuk është e paarritshme. Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka të qartë vizionin dhe i ka të qarta reformat që duhet ndërmarrë me qëllim të avancimit të administrimit të tokës në një vijë me shtetet e zhvilluara dhe në pajtueshmëri me kërkesat e komunitetit të shteteve anëtare të BE-së, me një ekzekutiv të ri për nga mosha e të avancuar për nga profesionalizmi, me një përkrahje politike, mund të ia del që kadastrën e Kosovës ta rreshtojë përkrah institucioneve homologe të shteteve të zhvilluara.

Reforma e shpesh përmendur e kadastrës, duhet të fokusohet në katër aspekte si vijon:

- a. ligjore,
- b. organizative,
- c. teknologjia informative,
- d. gjithëpërfshirja shoqërore.

Në përgjithësi, këto aspekte do të ndikojnë në fuqizimin e administrimit të tokës, do të ndikojnë në shmangien e duplikimit të projekteve e që do të rezultojë me kursim të buxhetit, kohës, resurseve njerëzore e ngjashëm, do të ndikojnë në përmirësimin e efikasitetit, ballafaqim produktiv me kërkesat e ndryshme e gjithnjë në rritje e gjithnjë e më specifike, do të rrisin transparencë dhe llogaridhënie, do të koordinojnë dhe konsolidojnë prodhimin e të dhënave dhe qasjen në to, do të thjeshtojnë procedurat dhe do të shkurtojnë procedurat administrative për regjistrim të pronës, etj.

ASPEKTI LIGJOR

Ligji për kadastrë

Agjencia Kadastrale e Kosovës është në proces të avancimit të kornizës së saj ligjore, ndërsa reforma kryesore dhe qenësore, pa të cilën nuk mund të ketë as zhvillim të

mirëfilltë, është Ligji i ri për kadastrë. Ky ligj parasheh vertikalizimin e administrimit të sistemit kadastral, respektivisht sistemimin e zyrave kadastrale komunale nën ombrellën e Agjencisë Kadastrale Kosovës. Për të sqaruar, vertikalizimi nuk parasheh centralizimin e shërbimeve, për më shumë, ato do të jenë edhe më afër qytetarëve falë aplikacioneve të reja që AKK ka planifikuar ti zhvillojë. Për më shumë, vertikalizimi i administrimit të kadastrës do të ndikonte në ngritjen e kualitetit dhe sigurisë të të drejtave pronësore dhe do të ndikonte në ngritjen e profesionalizimit të ofruesve të shërbimeve. Aktualisht, pasi që pozita e drejtorit në ZKK bëhet përmes emërimit politik, kemi raste që Zyrat Kadastrale Komunale udhëhiqen nga poetë e filozofë, e kjo nuk do të duhej të ndodhte. Ligji i ri do të obligonte që me këto dikastere të udhëheqin profesionistët. Po ashtu vertikalizimi do të ndikonte në eliminimin e mundësive për korrupsion. Aktualisht, ekziston një përshtypje që nëpër zyra kadastrale komunale ka pagesa joformale për shërbime, të raportuara nga qytetarët. Ligji i ri, respektivisht vertikalizimi i administrimit të kadastrës e ndalon një gjë të tillë, pasi që me vertikalizim do të avancohet llogaridhënia. Dhe për fund, vertikalizimi do të lehtësonte krijimin e politikave të avancuara në administrimin e tokës dhe do të lehtësonte vendimmarrjen. Futja e Zyrave Kadastrale Komunale nën ombrellën e AKK-së do të unifikonte mënyrën e ofrimit të shërbimeve nëpër Zyrat Kadastrale Komunale. Sot, mënyra e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve nëpër zyra kadastrale komunale dallon. Madje, edhe çmimet për të regjistruar pronën dallojnë. Për shembull, Komuna e Prishtinës implementon një lloj pagese për blerje të pronës, që nuk është rast në Komunat tjera. Një organizim i tillë i kadastrit aplikohet në të gjitha vendet e regjionit si dhe në shumicën e vendeve të BE-së.

Ligji për IKIH (Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave Hapësinore)

Agjencia Kadastrale e Kosovës bazuar në ligjin për kadastrë në fuqi është koordinatore për koordinimin e aktiviteteve për **IKIH**. Për më shumë, mbështetur në këto kompetenca ligjore, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar strategjinë për IKIH, gjatë draftimit të së cilës janë identifikuar institucionet që prodhojnë, administrojnë dhe mirëmbajnë të dhëna gjeohapësinore. Një numër i vogël i këtyre dhënave janë në Gjeoportalin Shtetërorë, andaj të dhënat tjera që nuk janë të publikuara në gjeoportalin shtetëror nuk janë të qasshme për institucionet e publikun. Jashtë vullnetit të AKK-së për ti hapur të dhënat, kompetencat që burojnë nga ligji në fuqi për kadastrë nuk janë të mjaftueshme për të krijuar një infrastrukturë gjeohapësinore sikurse e kërkon Direktiva Evropiane INSPIRE, për këtë arsye Agjencia Kadastrale e Kosovës ka draftuar edhe Ligjin për IKIH. I njëjti ka kaluar në lexim të dytë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky Ligj rregullon mënyrën e grumbullimit dhe shpërndarjes së të dhënave gjeohapësinore të prodhuara nga institucione publike, konform Direktivës Evropiane INSPIRE 2007/2, direktivë kjo obligative për shtetet anëtare të BE-së dhe ato që aspirojnë anëtarësimin në BE, përfshi edhe Republikën e Kosovës. Kalimi i këtij ligji, shpërndarjen e të dhënave të sakta, të harmonizuara e në kohë reale, do ta bëjë obligative. Përfitimi nga një proces i tillë do ishte i madh, pasi qasja në grupe të shumta të të dhënave, prodhuar nga institucione të ndryshme, do të bëhej përmes një adrese të vetme, atë të gjeoportalit shtetëror.

ASPEKTI ORGANIZATIV

Agjencia Kadastrale e Kosovës brenda strukturës së saj organizative ka Zyrën Ekzekutive, pesë Drejtorë dhe një numër ekspertësh që varijon varësisht nga përkrahja e donatorëve, po ashtu edhe nga projekti i Bankës Botërore REGIP në kuadër të

Njesisë për Implementimin e Projekteve. Në total, AKK ka 54 zyrtarë, prej të cilëve vetëm 13 janë nga fusha e kadastrës dhe gjeodezisë. Ndërsa, implementimi i një vargu të madh projektesh nga një numër i vogël ekspertësh paraqet sfidë të madhe, e sidomos kur të merret parasysh fakti që ekspertët e angazhuar nga donatorë dhe nga Banka Botërore janë me periudhë të caktuar kohore. Prandaj, reformat organizative janë të varura nga reforma e sipër përmendur ligjore. Në rast të aprovimit të ligjit të ri për kadastrë, Agjencisë Kadastrale të Kosovës i hapet rruga për riorganizimin e drejtorive të brendshme, respektivisht për shtimin e numrit të ekspertëve të fushës dhe shmangien e procedurave burokratike. Një aspekt tjetër që ka të bëjë me reformën organizative ka të bëjë edhe me fushën e administrimit të të dhënave gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka më se të nevojshme ngritjen e njesisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore, pasi që Agjencia Kadastrale e Kosovës është administratore dhe koordinatore për IKIH në Republikën e Kosovës, dhe si e tillë e ka patjetër që të krijojë njësinë e sipër përmendur.

ASPEKETI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Zhvillimet në teknologjinë informative në administrimin e tokës, kërkesa në rritje për të dhëna të sakta dhe të shpejta, hapja e të dhënave, krijimi i ueb shërbimeve dhe e-shërbimeve, janë duke e shpërfaqur nevojën për reforma në teknologjinë informative në AKK, e jo vetëm. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka krijuar një varg aplikacionesh për administrimin, mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave hapësinore si Gjeoportali Shtetëror, Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK pjesën tekstuale dhe grafike), Aplikacionin për Informacione të Sistemit të Adresave (ARIS), Aplikacionin për Administrimin dhe Indeksimin e Dokumenteve të Skanuara Kadastrale, dhe për shumicën e produkteve të saja ka krijuar ueb shërbime. Sot AKK ofron rreth 70 lloje të të dhënave gjeohapësinore për shikim online, pa pagesë. Sidoqoftë, sfidë paraqet mungesa e nënshkrimit elektronikë dhe vulës elektronike. Implementimi i tyre nuk është nën kompetenca të AKK-së. Me krijimin e këtyre dy produkteve, nënshkrimit dhe vulës elektronike, AKK do të jetë e gatshme të krijojë e-shërbime, po ashtu edhe të krijojë një "ONE STOP SHOP", pra pajisjen me të gjitha produktet pronësore dhe kadastrale në ueb.

ASPEKTI I GJITHËPËRFSHIRJES SHOQËRORE

Gruaja dhe prona

Agjencia Kadastrale e Kosovës parasheh përfshirjen sa më të madhe dhe sa më aktive të qytetarëve gjatë implementimit të projekteve të saja, me qëllim që të njëjtit të jenë pjesëmarrës në tregun e pronave dhe përfitues nga zhvillimi i tij. Kjo për shkak se të drejtat pronësore luajnë një rol të madh edhe në avancimin e mirëqenies së qytetarëve si përmes shitblerjes së pronave po ashtu edhe përmes hipotekimit për nevoja të kredi marrjes. Po ashtu, Agjencia Kadastrale e Kosovës rëndësi të veçantë u kushton përfshirjes së grupeve potencialisht të marginalizuara në të drejta pronësore, me theks të veçantë gratë, komunitetet pakicë dhe personat me nevoja të veçanta. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka implementuar projekte të ndryshme për avancimin e të drejtës së gruas në pronë, kryesisht pilotime, dhe rezultatet nga këto pilot projekte kanë qenë të kënaqshme. Por, për të pasur gjithëpërfshirje në shfrytëzim të të drejtave pronësore, nuk mjafton vetëm kornizë ligjore në fuqi, por duhet edhe investime në

aktivitete përcjellëse, shpërndarje të informacioneve, në prezantim të procedurave dhe masave ekzistuese lehtësuese për regjistrim të pronës në emër të dy bashkëshortëve, duhet targetuar edhe ndryshimin e qëndrimit në përgjithësi rezistues në opinion për trajtimin e gruas dhe të drejtës së saj në pronë.

Komunitetet pakicë dhe prona

Agjencia Kadastrale e Kosovës trajton me kujdes të shtuar edhe specifikat që kanë të bëjnë me qasjen në të drejta pronësore për komunitetet pakicë, me theks të veçantë komunitetin serb. Agjencia Kadastrale e Kosovës respekton përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës dhe kujdeset që secilin qytetar ta shërbejë në gjuhën e kuptueshme për të. Shumicën e aplikacioneve që Agjencia ka krijuar, kanë edhe gjuhën serbe (dhe jo vetëm serbe) si pjesë përbërëse të tyre, përfshi Gjeoportali, Ueb Faqja, Aplikacioni për Sistemin e Adresave, Harta Kadastrale etj. Po ashtu, secili produkt i Agjencisë, qoftë Certifikatë pronësie, Kopje plani e tjera, ofrohet edhe në gjuhën serbe. Mirëpo, sfiduese është që në tre Komunat veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan, nuk funksionojnë Zyrat Kadastrale Komunale. Rrjedhimisht, qytetarët e atyre Komunave nuk po mund të pajisen me dokumente zyrtare pronësore të Republikës së Kosovës. Për të shmangur një gjë të tillë, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka marrë përsipër pajisjen e këtyre qytetarëve me dokumente pronësore të Republikës së Kosovës. Por kjo ka qenë një zgjidhje e përkohshme, pasi që Ekzekutivi i AKK-së është duke bërë përpjekje për funksionalizimin e zyrave kadastrale komunale në këto Komuna. Për këtë, ka identifikuar disa palë të interesit si UN HABITAT që janë duke ndihmuar. AKK kërkon përkrahje politike për funksionalizimin e këtyre zyrave, që pos praktike, do të ishte edhe një fitore politike karshi strukturave paralele atje.

Realizimi i këtyre reformave në këto 4 shtylla kryesore dhe jo vetëm, do të sillte benefite direkte për të gjitha palët e interesit veçanërisht për qytetarët pasi që do të ulej në minimum burokracia, do të respektohej rregulli i aplikimit "i pari që aplikon, i pari shërbehet", do të ofroreshin shërbime online të cilat do të kursenin kohën për qytetarët, duke u monitoruar dhe shtuar konkurrenca e tregut tek gjeodetët dhe kompanitë gjeodete të licensuara qytetarëve do të ofrohen më shumë mundësi zgjedhjesh, e që si çdo ekonomi e lirë e tregut por e monitoruar do të nënkuptonte ofrim të shërbimeve më të mira, më të sakta dhe më të shpejta për qytetarët. Gjithashtu përmes këtyre reformave do të luftohej informaliteti që sot ekziston në tregun e punës së gjeodetëve pastaj do të eliminohej mundësia e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsioni pasi që zyrtarët në zyra kadastrale nuk do të kenë nevojë në asnjë hap të procedurës të kenë kontakt me palët e interesit që janë kryesisht qytetarët, por do të jenë më të fokusuar kontrollimin, aprovimin dhe regjistrimin e të dhënave kadastrale.

15.2 OBJEKTIVAT DHE PROJEKTET E PARAPARA PËR VITIN 2020

Agjencia Kadastrale e Kosovës, në përputhmëri me nevojat e institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, dhe në pajtueshmëri me vizionin e saj, aktivitetet e saja për vitin 2020 i ka të ndara në objektiva, ndërsa për realizimin e këtyre objektivave është paraparë edhe realizimi i projekteve kapitale si nga buxheti i Republikës së Kosovës, po ashtu edhe nga huamarrja nga Banka Botërore. Në tabelat në vijim mund të gjeni informacione mbi objektivat dhe projektet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës:

Objektivat:

Nr.	Koordinimi institucional i administrimit të tokës në Republikën e Kosovës
1	Zhvillimi dhe harmonizimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore mbi pronën e paluajtshme
2	Zhvillimi institucional i AKK-së si bartës kryesor i zhvillimit të Kadastrit dhe Administrimit të tokave në Kosovë
3	Zhvillimi i resurseve njerëzore dhe trajnimi i stafit të AKK
4	Zhvillimi i mëtutjeshëm i Sistemit Informativ Kadastral të Tokës në Kosovë (SIKTK)
5	Regjistrimi sistematik i pronave të paluajtshme
6	Zhvillimi i infrastrukturës kombëtare të të dhënve hapësinore -IKIH (ang. NSDI)
7	Krijimi i Sistemit të Arkivimit Digjital
8	Zgjerimi i Infrastrukturës së Teknologjisë Informative
9	Projekti i regjistrimit të pronës në Kadastër dhe Infrastruktura Gjeohapësinore REGIP (Projekt i Bankës Botërore)

Projektet nga huamarrja

Nr.	Emri i Projekteve nga huamarrja
1	Kontrolli i Kualitetit i kontraktorëve për Rindërtim të Informacioneve Kadastrale
2	Implementimi i strategjisë dhe planit të veprimit për informim të publikut
3	Zhvillimi i softuerit për rritjen e cilësisë së të dhënave në SIKTK
4	Korrektimi i të dhënave në SIKTK
5	Zhvillimi i Gjeoportalit të ri shtetëror
6	Zhvillimi i modulit për gjeodetët dhe kompanitë e licencuara
7	Rindertimi I Informacioneve kadastrale
8	Skanimi I dokumenteve arkivore
9	Përmirësimi i sistemit të KOPOS-it (duke përfshirë- shtimi i stacioneve, softuerët, hardueret, licencat, pajisjet etj)


Projektet nga Buxheti i Kosovës

Nr.	Emri i Projekteve nga Buxheti i Kosovës
1	Rindërtimi i Informacioneve kadastrale
2	Mirmbajtja e sistemeve të informacioneve kadastrale të tokës në Kosovë

3	Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW-SW)
4	Zgjerimi i intranetit të AKK-së me module të reja
5	Skanimi i dokumenteve arkivore
6	Matjet relative gravimetrike
7	Projekti kadastrit të patundshmërive dhe infrastrukturës gjeohapësinore
8	Harmonizimi i të dhënave kadastrale në SIKTK
9	Rrjeti i nivelimit dhe sistemi referent i lartësive
10	Kompetimi dhe finalizimi I sistemit të adresave
11	Zhvillimet e reja në SIKTK
11	Blerja e veturave







RR: VËLLEZËRIT ASTRIT E ARBNOR DEHARI NR.25
PRISHTINË, 10000
REPUBLIKA E KOSOVËS
EMAIL: AKK@RKS-GOV.NET
TEL: +383512353